



**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR PËR PROJEKTIN
“MIRËMBAJTJE DHE SIGURI RRUGORE BAZUAR NË REZULTATE”**

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

**MBI PËRPUTHSHMËRINË
E PROJEKTIT
“MIRËMBAJTJE DHE SIGURI RRUGORE BAZUAR NË
REZULTATE”
NË
AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR**

MAJ 2023

Përmbajtja	faqe
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	3
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	10
II. HYRJA	12
1. Objekti i auditimit.....	12
2. Qëllimi i auditimit	12
3. Identifikimi i çështjes:	12
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:	12
5. Përgjegjësitë e audituesve.....	13
6. Kriteret e vlerësimit	13
7. Standardet e auditimit.....	13
8. Metodatat e auditimit.....	13
9. Dokumentimi i auditimit	14
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	15
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM	15
2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT	16
2.1 Marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimeve dhe raportimi i tyre.....	16
2.2 Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit.	26
2.3 Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimin e fondeve publike.....	34
2.4 Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.	46
2.5 Mbi lidhjen dhe zbatimin e kontratave të mallrave, shërbimeve dhe realizimin e punimeve civile.....	57
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....	89

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi në Autoritetin Rrugor Shqiptar, zyrën e PMU, Projektin “Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate” në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr.827/1 datë 18.01.2022, me afat auditimi nga data 10.10.2022 deri me datë 10.03.2023, për periudhën nga fillimi i Projektit deri më 31.03.2022. Konkretisht u audituan marrëveshjet financiare dhe ndryshimet e tyre, shkalla e arritjes së objektivave dhe komponentëve të Programit, menaxhimi financiar i Projektit, shkalla e realizimit të disbursimeve financiare kundrejt atyre të programuara dhe raportimi i tyre në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si dhe zbatimi i kontratave në drejtim të realizimit të punimeve. Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur 11 akte konstatimi të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit të auditimit brenda afatit të periudhës së auditimit datë 10.03.2023. Me shkresat e protokolluar në KLSH me nr.827/10 datë 31.03.2023, nr.827/11 datë 31.03.2023, nr.827/12 datë 31.03.2023, nr.827/13 datë 31.03.2023, nr.827/14 datë 03.04.2023, nga subjekti janë paraqitur observacionet e akteve të mbajtura. Me shkesën nr. 827/15 datë 13.04.2022 është dërguar Projektraporti i Auditimit dhe me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 827/16 prot. datë 12.05.2023 subjekti i auditimit ka paraqitur observacione për Projektraportin, ku pasi u lexuan me kujdes, paanshmëri dhe profesionalizim nga ana e grupit të auditimit të KLSH, u morën në konsideratë ato raste për të cilat kishin mbështetje ligjore me dokumentacion, ndërsa rastet e tjera të cilat nuk gjejnë argumentin e duhur ligjor, gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i dërgohet subjektit për marrjen e masave në përmirësimin e punës. Për sa i takon Takimit Përmbyllës, midis niveleve drejtuese të KLSH-së, grupit të auditimit dhe subjektit të audituar, është njoftuar me e-mail datë 16.05.2023 personi i kontaktit për projektin dhe nuk është kthyer përgjigje, pra ky takim nuk do të zhvillohet pasi nga ana e subjektit të atakuar nuk është vlerësuar e arsyeshme.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	Në kontratën me objekt shërbimi “Monitorim/Supervizionim i katër Kontratave, Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate” sipas amendimit nr. 7 me Nr.4765Prot. datë 16.05.2019 janë shtuar kontribute për një shofer 31 muaj dhe një përkthyes për 12 muaj. Në ofertën fillestare nuk janë parashikuar shofera, për makinat e vendosura në dispozicion nga kontraktori, pasi janë marrë parasysht si shpenzime të rimbursueshme me kosto zero, dhe janë të shpërndara në pagesat e stafit. Për përkthimin e dokumentave sipas kontratës fillestare mbulohen nga sekretare/përkthyes e përcaktuar në përshkrimin e punës si dhe referuar materialeve të përkthyer të vendosura në dispozicion rezultojnë se janë vetëm disa raporte për të cilat nuk kanë patur nevojë për kohë 12 muaj. Për sa më sipër vlera prej 35,600 Euro pa TVSH (24,800 Euro shoferi + 10,800 Euro përkthyes) është përfituar më tepër nga konsulenti dhe përben dëm ekonomik në	Faqe 57-87	E LARTË	ARRSH të marrë masa, për arkëtimin e shumës 35,600 Euro pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga BOE “I..... S.r.l & S.... S.p.a&S..... S.p.a” me të cilin është lidhur kontrata Nr. 9999Prot. datë 05.12.02016, për monitorimin dhe konsulencën e katër kontratave të mirëmbajtjes

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	buxhetin e projektit. Veprime në kundërshtim me kontratën e shërbimit të konsulencës nr. 9999 prot. datë 05.12.2016, Aneksi III, shtojca IV dhe D.			
2.	<p>Në kontratën me objekt shërbimi “Monitorim/Supervizionim i katër Kontratave, Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate” krahas kontributeve për stafin kryesor dhe jo kryesor është parashikuar dhe një shumë e rimbursueshme prej 100,000 Euro e cila do të përdoret për, raportin iRAP në vlerën 39,960 Euro, dy reflektometra në vlerën 30,000 Euro dhe për teste të pa varura që do ti duhen konsulentit në vlerën 30,000 Euro. Sipas faturave të vendosura në dispozicion rezultoi se 18,678.75 Euro janë shpenzuar për reflektometrat dhe 60,000 Euro për testet iRAP, në total 78,678.75 Euro. Në kontratën fillestare dhe sipas marrëveshjes financiare aktiviteti iRAP do të kryhej tre herë gjatë zbatimit të kontratave, në vitin e parë, të tretë dhe të pestë përpara 1 Nëntorit të këtyre viteve ku konsulenti ka ofruar shumën 39.960 Euro. Në amendamenti nr.7 datë Nr.4765Prot. datë 16.05.2019 është (pika viii) është dakortësuar që do të kryhen vetëm dy herë, dhe i dyti të kryhet në mesin e viti 2021. Ky ndryshim do të zvogëloj dhe koston për iRAP të cilën Konsulenti Monitorues duhet ta ndryshojë në përputhje me pikën 30 të kontratës. (viii) <i>In accordance with the discussions held during the Mid-Term Review of the RRMSF, the number of iRAP surveys to be carried out by the MC through an independent provider is reduced from three to two, with the second survey to be carried out in mid-2021. This shall reduce the overall cost for the iRAP surveys which the MC shall charge in accordance with para. 30 of the Contract.</i></p> <p>Derisa kostoja për tre testet iRAP ishte jo më shumë se 39,960 Euro, për dy duhet të jetë 26,640 Euro. Nga auditimi i dokumentacionit dhe raporteve të vendosura në dispozicion rezultoi se iRAP është kryer dy herë dhe sipas faturave të paraqitura secili ka një kosto prej 30,000 Euro dhe në total 60,000 Euro, jo vetëm që nuk është zvogëluar por ka kaluar edhe vlerën e parashikuar në kontratë. Për sa më lart vlera e dy testeve iRAP nuk duhet të kalonte vlerën 26,640 Euro e për rrjedhojë konsulenti ka përfituar më tepër vlerën 33,360 Euro pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit. Veprime në kundërshtim me kontratën e shërbimit të konsulencës nr. 9999 prot. datë 05.12.2016, dhe amendimi nr.7 datë 16.05.2019, pika (viii).</p>	Faqe 57-87	ELARTË	ARRSH të marri masa, për arkëtimin e shumës 33,360 Euro pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga BOE “I..... S.r.l & S.... S.p.a&S..... me të cilin është lidhur kontrata Nr. 9999Prot. datë 05.12.2016, për monitorimin dhe konsulencën e katër kontratave të mirëmbajtjes.
3.	Në kontratën me objekt shërbimi “Monitorim/Supervizionim i katër Kontratave, Mirëmbajtje			

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate” janë parashikuar, staf jo kryesor, 12 punonjës për kontrollin dhe monitorimin e punimeve rehabilituese dhe përmirësuese në 12 muajt e parë të kontratave të zbatimit. Referuar zbatimit të kontratave të punimeve civile rezulton se gjatë 12 muajve të parë deri në nënshkrimin e amendamentit nr.1 datë 16.03.2018, nuk janë realizuar punime rehabilituese dhe përmirësuese. Sipas kontratës çdo 6 muaj nga bërja efektive e kontratës së konsulentit, ARrSh dhe konsulenti duhet të rishikojnë kontributet (input) e stafit për 6 muajt e ardhshëm bazuar në dakortësinë e planifikimit të stafit e cila nuk është realizuar. Nga mosrealizimi i punimeve rehabilituese dhe përmirësuese në 12 muajt e parë të kontratave, kontributet e stafit lokal të parashikuara për kontrollin dhe monitorimin e këtyre punimeve janë përfituar nga konsulenti pa ofruar ndonjë shërbim sipas përshkrimit të punës (scope of work) të parashikuar në kontratë nga ky staf në vlerën prej 432,000 Euro pa TVSH. Gjithashtu nga mosrealizimi i punimeve rehabilituese dhe përmirësuese në vitin e parë janë shtuar dhe kontributet e Deputy Team Leader me 12 muaj në vlerën 162,000 Euro pa TVSH. Për sa më sipër vlera prej 594,000 Euro pa TVSH (432,000 stafi lokal + 162,000 Deputy Team Leader) konsiderohet shpenzim pa ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet i fondeve të projektit. Veprime në kundërshtim me kontratën e shërbimit të konsulencës nr. 9999 prot. datë 05.12.2016, informacion përmbledhës për stafin, pika b</p>	Faqe 57-87	E LARTË	ARRSH të marri masa, për projektet në proces dhe të reja, të monitoroj kontratat e konsulencës dhe shtimi i kontributeve të stafit të jetë sipas situatës në terren duke shmangur kështu ritjen e kostove të kontratave.
4.	<p>Termet e marrëveshjes në këtë Projekt përcaktojnë se komisioni i angazhimit i pagueshëm nga Huamarrësi për çdo vlerë e cila rezulton e pa tërhequr është i barabartë me një të katërtën e një për qind (0.25%) në vit të shumës së Huas gjendje. Nëse objektivat e Projektit do të ishin realizuar sipas afatëve të përcaktuara në marrëveshje komisioni i angazhimit do të paguhej në vlerën 263,518 Euro. Nga auditimi rezulton se vlera e paguar për këtë komision deri në datën 31 dhjetor 2022 është 453,393.82 Euro.</p> <p>Diferenca midis vlerës të parashikuar dhe asaj të paguar rezulton në vlerën 189,875.77 Euro dhe konsiderohet shpenzim pa ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet për buxhetin e shtetit. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 71, datë 02.07.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për</p>	Faqe 46-57	E LARTË	Nga Autoriteti Rrugor Shqiptar të merren masa që në Projektet e ardhshme të përmbushen në kohë të gjitha përcaktimet e marrëveshjeve financiare, në mënyrë që të shmangen të gjitha efektet e mundshme financiare që rrjedhin nga këto vonesa në afate.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	projektit “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” neni 2.5.			
5.	<p>Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion u konstatua janë larguar nga puna Menaxheri i Projektit dhe Specialistja e Menaxhimit Financiar. Në datën 28.02.2018 është pushuar nga puna Menaxheri i Projektit me motivacion performancë e dobët gjatë ushtrimit të detyrës, pasi me shkresën nr. 9168/2 prot, datë 06.12.2017 “Kërkesë zyrtare për dorëheqje” nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH, i është kërkuar Menaxherit të Projektit dorëheqja zyrtare. Pas Largimit nga detyra Menaxheri i Projektit ka hapur proces gjyqësor kundër ARRSH për pushim të padrejtë nga detyra. Me vendim nr. 6086, datë 05.07.2018 Gjykata e Shkallës së Parë të Tiranës ka vendosur pranimin e kërkesë-padisë dhe dëmshpërblimin e paditësit me dyzetë e dy paga (42*1.500=63.000 Euro). Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë me shkresë nr. 7109/1 prot, datë 24.08.2018, ku kjo gjykatë nuk ka dalë ende me një vendim.</p> <p>Në pozicionin e Specialistes së Menaxhimit Financiar është emëruar në datën 02.03.2018 znj.E... A....., e cila më pas është pushuar nga puna për performancë të dobët në detyrë, në datën 16.07.2019. Me vendim nr. 6086, datë 05.07.2018 Gjykata e Shkallës së Parë të Tiranës ka vendosur pranimin e kërkesë-padisë dhe dëmshpërblimin e paditësit me njëzetë e një paga (42*1.500=63.000 Euro).</p> <p>-Me Vendimin Nr. 3700, datë 31.05.2021, Gjykata e Shkallës të Parë, Tiranë vendosur pranimin e kërkesë-padisë dhe dëmshpërblimin e paditësit me dyzetë e dy paga ((21 paga * 1,400 = 29,400 Euro). Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë me shkresë nr. 9952 prot, datë 04.11.2021 dhe çështja nuk është shqyrtuar ende nga Gjykata e Apelit Tiranë.</p> <p>Largimet nga detyra janë berë në kundërshtim me MOP ku punëdhënësi nuk është bazuar në performancën e tyre apo në parashikimet e kontratave të lidhura e cila nuk justifikon veprimet e kryera. Sa më sipër vlera totale prej 92,400 Euro të fituara nga punonjësit e larguar nga puna, deri në këtë shkallë të gjykimit, konsiderohet shpenzim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet në buxhetin e shtetit e cila është në kundërshtim me Manualin e Operimit të Projektit (MOP), pika 30.</p>	Faqe 16-25	E LARTË	<p>Nga Autoriteti Rrugor Shqiptar të merren masa për vlerësimin e performancës së stafit të projekteve, duke shmangur shpenzimet e proceset gjyqësore që mund të rezultojnë në rastet e largimit të tyre nga puna e për rrjedhojë shmangien e përdorimit të fondeve pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet.</p>
6.	Nga auditimi i situacioneve ka rezultuar se ka raste të vonesave në përgatitjen e dokumentit të autorizimit të faturës dhe kërkesës së pagesës, dokument i cili konfirmohet nga menaxheri i			

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>projektit krahasuar me datën e faturës apo dhe datën e konfirmimit të situacionit nga menaxheri. Për Lotin 1, Kontrata A me operator JV “B..... A.T.E.V.E & G.....” shpk situacionet me vonesa janë: 1 – 17, 21 – 24, 26 - 33, dhe 35. Për Lotin 2, Kontrata B me operator JV “B..... A.T.E.V.E & G.....” shpk situacionet me vonesa janë: 1 – 17, dhe 23 – 32.</p> <p>Për shkak të vonesave lidhur me pagesat e këtyre situacioneve, midis ARRSH dhe operatorëve “B..... A.T.E.V.E” DHE “G..... LTD” kanë lindur mosmarrëveshje, për të cilat palët kanë dakordësuar t’i drejtohen International Centre for ADR, ku me shkresën e ARRSH nr. 7483 prot, datë 01.08.2019, kërkohet caktimi i një eksperti për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.</p> <p>Me shkresën nr.10732 prot, datë 22.11.2019 ARRSH i drejtohet z. C. A. M. ku konfirmohet përzgjedhja e tij si ekspert i zgjidhjes të mosmarrëveshjeve dhe kërkohet prej tij kosto e shërbimit dhe drafti i marrëveshjes mes palëve.</p> <p>Kontraktimi i këtij eksperti është konfirmuar pa komente nga Banka Botërore me shkresën nr. 1706 prot, datë 25.02.2020.</p> <p>-Me shkresën nr. 7620 prot, datë 12.10.2020 (Kontrata A), nr. 7621 prot, datë 12.10.2020 (Kontrata B), nr. 7622 prot, datë 12.10.2020 (Kontrata D), dhe nr. 76203prot, datë 12.10.2020 (Kontrata C), janë lidhur kontratat me ekspertin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve z. C. A.M.</p> <p>Pavarësisht bisedimeve mes palëve dhe ekspertit, me shkresën hyrëse në ARRSH nr. 5628 prot, datë 07.06.2021, nga “B..... A.T.E.V.E” DHE “G..... LTD” është shprehur mos dakordësimi lidhur me kontratën A dhe B.</p> <p>-Me shkresën nr. 1350/1 prot, datë 24.02.2022 nga Menaxheri i Projektit, drejtuar Drejtorisë Juridike dhe të Përputhshmërisë të Standardeve, vendosen në dijeni lidhur me vlerat e kërkuara nga operatorët, konkretisht:</p> <p>-pagesa shtesë për Urdhër Ndryshimin A06 të kontratës A, dhe Urdhër Ndryshimin B05 të kontratës b, në vlerat 206,000 Euro dhe 15,248 Euro.</p> <p>-interesa lidhur me vonesat për kontratat A dhe B respektivisht në vlerat 82,181.85 Euro dhe 145,946.24 Euro,</p> <p>-pagesa e kontraktorit për punimet e anuluar për kontratat A dhe B, në vlerat 56,366.01 Euro dhe 142,239.84 Euro.</p> <p>Sa më sipër, vlera 647,952 Euro, përbën një dëm ekonomik i mundshëm në disfavor të ARRSH. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr.</p>	<p>Faqe 46-57</p>	<p>E LARTË</p>	<p>Nga ana e Autoritetit Rrugor Shqiptar të merren masa që në Projektet e ardhshme të ndiqen me përgjegjësi të procedurat e pagesave të situacioneve, të zbatohen afatet e përcaktuara lidhur me pagesat, duke shmangur procedurat gjyqësore të cilat do të sillnin për pasojë humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.</p>

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	71/2015, (miratuar më 2.07.2015 dhe dekretuar me dekretin nr.9174, datë 14.07.2015, për projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” dhe kontratat A dhe B, klauzola 50 “Pagesat” pika 50.1.			
7.	<p>Me Amendamentin Nr.1 është dakortësuar që: i. Shtrirja dhe shkalla e Punëve të Rehabilitimit të përcaktuara për disa seksione rrugore në kontratë janë të pamjaftueshme për të arritur Nivelet e Shërbimit me të cilat kërkohet që Kontraktori të respektojë në ato seksione rrugore. ii. Teksti i Specifikimeve ka mungesë të qartësisë, përfshin kontradikta dhe përsëritje, si dhe dispozita joreale, duke rezultuar në vështirësi në zbatimin e kontratës. iii. Sqarimet e dhëna ofertuesve gjatë procesit të tenderimit përfshijnë deklarata të cilat janë në kundërshtim me njëra-tjetrën dhe me pjesë të tjera të kontratës.</p> <p>Referuar pikave ii) dhe iii), të dakortësuar në këtë amendament, konstatohet se: specifikimet teknike të hartuara dhe sqarimet e dhëna gjatë procesit të tenderimit nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe ekspertëve të BB nuk kanë qenë në përputhje me objektivat e kontratave si dhe mungesë qartësie të tyre. Për problematikat e hasura në specifikimet teknike, në pikën B të këtij amendamenti, është dakortësuar rishikimi i tyre të cilat do të zëvendësojnë ato origjinale të kontratës. Mospërshtatja e kushteve të kontratës dhe specifikimeve teknike është edhe si rezultat i mungesës së experiencës pasi kjo lloj kontrate implementohet për herë të parë dhe nga koha e hartimit të tyre ka kaluar një kohë relativisht e gjatë. Këto ndryshime kanë rezultuar në implementimin e kontratave sipas një metode hibride dhe jo sipas asaj të projektuar në DST. Gjithashtu janë përfshirë rrugë që kanë pasur nevojë për një rehabilitim total dhe referuar gjendjes së tyre gjatë procesit të mirëmbajtjes nuk mund të arrihej niveli i kërkuar i shërbimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me dokumentat standarte të tenderit, ToR dhe Specifikimet teknike</p>	Faqe 57-87	E LARTË	Strukturat drejtuese të ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që termat e referencës dhe specifikimet teknike për projektet me financim të huaj të jenë në përputhje me kushtet aktuale të gjendjes së rrugëve me qëllim ofrimin e shërbimit me cilësi dhe siguri.
8.	Në kontratat “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” për të patur rezultate sa më të mira në menaxhimin e tyre, në seksionin e specifikimeve pjesa 2 të cilat janë pjesë e DST, është seksioni 6.1 Masat e performancës menaxheriale (Management Performance Measures) MPM e cila pasqyron aftësinë e kontraktorit për të menaxhuar me sukses rezultatet e kontratës duke përfshirë cilësinë dhe efikasitetin e raportimit të tij të informacionit tek punëdhënësi.			

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>Për çdo raportim dhe pasqyrim të dhënash tek punëdhënësi nga kontraktori që nuk përputhen me afatet e kërkuara në kontratë janë vendosur penalitete për çdo ditë vonesë përtej këtyre afateve. Masa e Penaliteteve për MPM janë të pasqyruara në DST, për çdo çështje, (Aneksi VII Reduktim i Pagesave për MPM, OPM, RDPM) të specifikimeve pjesa 2 të hartuara nga konsulenti i BB dhe AK kanë qenë kriter mbi bazën e të cilit të gjithë operatorët ekonomik kanë dhënë ofertën e tyre ekonomike. Nga auditimi i dokumentacionit, të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, nuk gjenden gjurmë ku të sqarohet se mbi çfarë reference ose studimi janë bazuar vlerat e penaliteteve nga ana e ekspertit të marrë nga AK dhe BB për hartimin e tyre. Ndryshimi i specifikimeve teknike ka sjell si rezultat edhe rishikimin e penaliteteve, ku janë shtuar dhe hequr disa, duke i përshtatur me kushtet aktuale të kontratës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me dokumentat standarte të tenderit, ToR dhe Specifikimet teknike.</p>	Faqe 57-87	E LARTË	ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që për projektet me financim të huaj vlerat e penaliteteve të cilat do të aplikohen gjatë zbatimit të kontratave të jenë të argumentuara dhe në përputhje me kushtet aktuale të zbatimit të tyre.
9.	<p>Në amendimin nr.3 është ndryshuar Klauzola 51 e Kushteve të Veçanta të Kontratës e cila lidhet me penalitet e dëmeve ku është 10% dhe në raste të veçanta mund të bëhet 20% e vlerës së punimeve rehabilituese, përmirësuese dhe emergjente në rastet ku testet e kryera nuk plotësojnë kërkesat e kërkuara. Për plotësimin e ndryshimeve të kësaj klauzole është ndryshuar pika C 2.1, ku kontraktori duhet të kryej të gjitha testet e materialeve në përputhje me specifikimet teknike, ku rezultatet e tyre do të tregojnë cilësinë e punimeve dhe mbi to do të kryhen pagesat përkatëse ndaj kontraktorit. Gjithashtu në këtë pikë është shtuar se, pavarësisht se rezultatet e testeve nuk janë në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat, Konsulenti Monitorues mund t'i rekomandojë Menaxherit të Projektit pagesën e ndërmjetme si dhe të zgjatet perioda e garancisë së punimeve, si dhe mbajtja 20% e vlerës së tyre e cila kthehet me përfundimin garancisë. Pavarësisht kushteve të vendosura, likuidimi i punimeve të kryera pa u vërtetuar se janë kryer sipas specifikimeve teknike nuk japin garanci për jetëgjatësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre e për rrjedhojë risin koston e mirëmbajtjes së rrugëve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me dokumentat standarte të tenderit, ToR dhe Specifikimet teknike; KTZ, VKM Nr. 68 datë 15.02.2001“Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit” i ndryshuar; ligjin 8402</p>	Faqe 57-87	E LARTË	ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që për projektet me financim të huaj punimet e kryera të likuidohen pasi të jenë realizuar në përputhje me specifikimet teknike duke siguruar jetëgjatësinë e investimit dhe ulen e koston së mirëmbajtjes.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	datë 10.09.1998, i ndryshuar, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.			
10.	Në amendimin nr.3 është ndryshuar klauzola 12.1 ku shtohet se nënkontraktimi mund ta kalojë vlerën 40% të kontratës vetëm në rastet kur është pjesë e JV ku bashkimi i operatorëve ekonomik ka hyrë në tender me përqindje të caktuara sipas përvojës që kanë në menaxhimin dhe zbatimin e kontratave të bazuar në rezultate me performancë. Ky ndryshim bën të mundur që të kryhen punime nga ana e kontraktorëve që nuk kanë përvojën e nevojshme për kryerjen e tyre dhe këto punime nuk do të jenë në standarin e kërkuar. Gjithashtu AK do ti lëshojë nënkontraktorit një certifikatë që konfirmon llojin dhe vlerën e punimeve të kryera prej tij ku në momentin e ndryshimit ka kaluar më shumë se 50% e afatit kohor të zgjatjes së kontratës. Me këtë ndryshim duke lëshuar certifikatë konfirmimi për nënkontraktorët u jep atyre mundësinë të marrin pjesë, në procedura prokurimi, në kontrata të këtij lloji pa patur përvojën e menaxhimit të tyre pasi ata kryejnë vetëm punime faktike në terren të matura dhe punime të mirëmbajtjes rutinë dhe jo “Self control unit” pasi nuk është e lejuar të nënkontraktohet. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kontratat e punimeve civile, klauzola 12.1.	Faqe 57-87	E LARTË	ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që për projektet me financim të huaj lëshimi i certifikatave për nënkontraktorët të kryhet sipas punimeve të kryera nga ana e tyre duke shmangur pjesëmarrjen e tyre në financime të tjera pa pasur përvojën e kërkuar.
11.	Në kontratat “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” mirëmbajtja rutinë përcaktohet nga niveli i shërbimit të kërkuar sipas kategorisë dhe kushteve teknike të rrugës. Në amendimin nr.3 janë modifikuar kërkesa e nivelit të shërbimit për seksionet rrugore ku shtresat asfaltike ekzistuese nuk mund të mirëmbahen për shkak se punimet rehabilituese të përfshira në kontratë janë pezulluar ose anuluar nga Punëdhënësi. Ky ndryshim ka ulur nivelin e shërbimit por nuk është i shoqëruar me ulje të kostos së mirëmbajtjes rutinë pasi kontraktori kryen më pak punime nga ato të ofruara. Në DST nuk është kërkuar një analizë kostoje të çmimit/njësi, për zërat e punimeve të mirëmbajtjes rutinë, e cila do të bënte të mundur llogaritjen e uljes së kostos sipas nivelit të shërbimit të ofruar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kontratat e punimeve civile, dokumentat standarte të tenderit, ToR dhe Specifikimet teknike.	Faqe 57-87	E LARTË	ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që për kontrata të ngjashme niveli i shërbimit të kërkohej sipas kushteve të rrugëve dhe me një kosto të detajuar për punimet që kryhen ku do të bëjë të mundur uljen e kostos së projekteve në tërësi në rastet ku do të kërkohej një nivel shërbimi i reduktuar.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së projektit “*Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate*”, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky projekt realizon qëllimin e tij, (kriteret e

auditimit të përputhshmërisë), janë konstatuar disa mangësi dhe parregullsi. Gjatë auditimit në terren janë marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë¹

Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë², i mbështetur në ligjin nr.154/2012 miratuar në datën 27.11.2014 “Për organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, standardet INTOSAI dhe në manualët e auditimit të përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Autoriteti Rrugor Shqiptar për projektin “*Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate*”, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale dhe jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënie e ***një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë.***

Baza për opinionin e kualifikuar (ISSAI 4000³)

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikes së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

Nga evidencat e marra mbi veprimtarinë e projektit rezultoi se:

Autoritetin Rrugor Shqiptar ka të meta dhe mangësi në disa drejtime të veprimtarisë së tij që lidhen me menaxhimin e projektit. a. Largime nga puna të stafit ka kryer vlerësimin e performancës së tyre duke ndjekur rrugën ligjore për largimin e tyre me kosto 92,400 Euro deri në këtë fazë të procesit të gjykimit. b. Objektivat e përcaktuara në marrëveshjen e ratifikuar nuk janë realizuar plotësisht. c. Pagesa të komisionit të anagazhimit në vlerën 189,875.77 Euro mbi ato të parashikuara në marrveshje si rezultat i vonesave në realizimin e procedurave të prokurimit dhe zbatimit të projektit. d. Në 7 raste për kontratën A dhe 4 raste për kontratën B janë konstatuar vonesa në likuidimin e situacioneve të cilat mund të bëhen premisa nga ana e kontraktorit për kërkesë të vlerës së interesave nga vonesat referuar kushteve të kontratës. Në kontratën e konsulencës kemi një ritje prej 38% të vlerës së kontratës e cila ka ardhur si rezultat i shtimit të kontributeve të stafit nga mosrealizimi i punimeve rehabilituese dhe përmirësuese në vitin e parë duke sjell shpenzime pa efektivitet në vlerën 594,000 Euro pa TVSH. Gjithashtu nga realizimi i testeve iRAP konsulenti ka përfituar më tepër vlerën prej 33,360 Euro pa TVSH.

¹Mbështetur mbi ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”

²Një opinion i kualifikuar shprehet kur efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje nuk janë aq materiale sa të justifikojnë dhënien e opinionit të kundërt ose një refuzim të opinionit.

³ISSAI 4000 – Udhërrëfyesi i Auditimit të Përputhshmërisë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 827/1 Prot. datë 07.10.2022, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 10.10.2022 deri me datë 10.03.2023, në subjektin *Autoriteti Rrugor Shqiptar, Projekti “Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate”*, për periudhën nga fillimi i Projektit deri më 31.03.2023, u krye auditimi “Mbi zbatimin e përputhshmërisë” nga:

Grupi i auditimit me përbërje:

1. S.... H....., Përgjegjës Grupi
2. J..... H....., Auditues
3. I..... B....., Audituese

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti i auditimit

Objekti kryesor i grupit të auditimit të KLSH është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit që Autoriteti Rrugor Shqiptar me strukturat përkatëse ka bërë me fondet në dispozicion, në bazë të Marrëveshjeve Financiare si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullshmërinë, ligjshmërinë e transaksioneve si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të zbatimit të Projektit.

2. Qëllimi i auditimit

Auditimi ka për qëllim *promovimin e transparencës* duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar siç kërkohet si dhe nëse janë arritur apo jo objektivat e Projektit. Gjithashtu, projekti i auditimit ka për qëllim *promovimin e përgjegjshmërisë* ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre. *Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (sipas ISSAI 400, p 18).*

3. Identifikimi i çështjes:

Autoriteti Rrugor Shqiptar duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi për arritjen në cilësi të punimeve/shërbimeve të ofruara nga Projekti duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

Menaxhmenti është përgjegjës për kryerjen e transaksioneve financiare në pajtim me kornizën e aplikueshme ligjore dhe që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me Projektin, konkretisht; -ligjin nr. 71/2015, datë 02.07.2015 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate”, -VKM nr. 116, datë 24.02.1997, “Për kompetencat, procedurat, nënshkrimin, lëvrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe ndihmave të huaja që i jepen Qeverisë së Republikës së Shqipërisë”; -VKM nr. 452, datë 01.07.1998, “Për disa masa në përmirësimin e punës për financimin e projekteve që financohen nga donatorët e huaj”; Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 17.02.2003, “Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj”; -Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 20, datë 24.12.2003, “Për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të menaxhimit, zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë të huaj”; -Udhëzuesit përkatës të huadhënësit

dhe/ose bashkë financuesve të tjerë për prokurimet e fondeve të ndërtimit, makineri-pajisje, shërbimet e konsulencës, të projekt-preventivit, të supervizionit; -Dispozitat ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e Njësive të Menaxhimit të Projekteve, etj. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, me ndryshimet vijuese të tij.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit mbi çështjet nën auditimin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Janë respektuar kërkesat etike si dhe është planifikuar dhe kryer auditimi sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

6. Kriteret e vlerësimit

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) IFAC; Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Manualet e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH; Ligji nr. 71/2015, datë 02.07.2015 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate”.

7. Standardet e auditimit

-Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:

- ISSAI (100)** “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik” që përcakton parime themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI (400)** “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë” që përcakton parime themelore **ISSAI (100)** dhe zhvillon më tej ato, duke përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI (4000)** “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe **ISSAI (4200)**;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), Federata Ndërkombëtare kontabilisteve (IFAC);
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI^t,
- INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve;

8. Metodatat e auditimit

Për arritjen e objektivave, metoda e auditimit u bazua tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në kryerjen e auditimit janë përdorur metoda e bazuar në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, metoda e bazuar në procedurat bazë dhe në procedurat analitike. Pas testimit të kryer, për të kuptuar sesi funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm dhe pas marrjes së informacionit në mënyre të përgjithshme, në ushtrimin e auditimit për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar u bënë teste lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

□ Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm morëm dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ja nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve.

□ Po kështu nga ana jonë u përshkrua legjislacioni autorizues, rregullat e vendosura sipas legjislacionit autorizues, caktimi i përgjegjësisë dhe autoritetit, etj.

Teknikat e kontrollit të përdorura gjatë auditimit janë; kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi.

9. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH^{se} nr. 196, datë 29.12.2015 si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM

Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) është krijuar me Ligjin Nr. 10164, date 15/10/2009, “Për autoritetin rrugor shqiptar”. Qëllimi i Ligjit ishte krijimi i Autoritetit Rrugor Shqiptar me kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrat e tij. Ky ligj beri shndërrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve në Autoritetin Rrugor Shqiptar. Misioni i kësaj drejtorie ishte organizimi, zhvillimi, shfrytëzimi mirëmbajtja, ri-veshja dhe realizimi i programit të investimeve në rrjetin rrugor kombëtar.

Institucioni i ARRSH-së, ka pësuar ndryshime në strukturë sipas VKM nr. 276, datë 16.05.2018 “Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar”, sipas të cilit marrëdhëniet e punës së Drejtorit të Përgjithshëm, nëpunësve të tjerë dhe punonjësve të Autoritetit në nivel Qëndror dhe rajonal rregullohen në bazë të dispozitave të Ligjit 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punësi RSH”, i ndryshuar.

Misioni i kësaj strukture është organizimi, zhvillimi, shfrytëzimi mirëmbajtja, ri-veshja dhe realizimi i programit të investimeve në rrjetin rrugor kombëtar. ARRSH, si një institucion i akredituar për administrimin e fondeve nga Buxheti i Shtetit si dhe nga donatorë të huaj si: Banka Botërore, Banka Evropiane për Zhvillim dhe Ndërtim, Banka Evropiane e Investimeve, Qeveria Italiane, Qeveria Kuvajtiane, Banka Islamike etj, ka realizuar disa objekte të rëndësishme në rrjetin rrugor nacional.

Realizimi i projektit “Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate” financohet nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim në formën e huasë dhe kontributit financiar, me një kosto totale të parashikuar në vlerën 128.47 milionë Euro, ndër të cilat shuma e huasë është 65.9 milionë Euro ndërsa pjesa tjetër e mbetur 62.57 milion Euro financohet nga fondet Qeverisë Shqiptare. Huaja dhe kontributi financiar rregullohet me ligjin nr. 71/2015, datë 02.07.2015 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate”.

Për realizimin punëve civile të këtij projekti janë lidhur katër kontrata të ndara sipas rajoneve të vendit dhe konkretisht:

Kontrata A, Nr.511/1 datë 23.01.2017 me referencë RRMS/CW/2015/1 për rrugët bazuar në output dhe performancë (Loti 1) për Rajonin Shkodër –Kukës (Shqipëria Veriore) e lidhur midis Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSh) dhe BOE B..... A.T.E.V.E & G..... ltd me vlerë të kontratës 21,205,783.99 Euro me TVSH dhe me aplikim zbritje 2.5%.

Kontrata B, Nr.512/1 datë 23.01.2017 me referencë RRMS/CW/2015/2 për rrugët bazuar në output dhe performancë (Loti 2) për Rajonin Tiranë –Dibër (Shqipëria Qendrore/Veri Lindore) e lidhur midis Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSh) dhe BOE “B..... A.T.E.V.E & G..... ltd” me vlerë të kontratës 19,205,601.48 Euro me TVSH dhe me aplikim zbritje 2.5%.

Kontrata C, Nr.1475 datë 23.02.2017 me referencë RRMS/CW/2015/3 për rrugët bazuar në output dhe performancë (Loti 3) për Rajonin Fier-Elbasan Korçë (Shqipëria Qendrore/Jugore/Lindore) e lidhur midis Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSh) dhe OE “R..... Al-T..... C..... E.....” me vlerë të kontratës 13,531,838.01 Euro me TVSH dhe me aplikim zbritje 3%.

Kontrata D, Nr.549/1 datë 24.01.2017 me referencë RRMS/CW/2015/3 për rrugët bazuar në output dhe performancë (Loti 4) për Rajonin Vlorë-Gjirokastrë (Shqipëria Jugore) e lidhur midis Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSh) dhe BOE “El.....l C..... S..... A..... (E..... ATTE) & S..... sh.p.k” me vlerë të kontratës 16,543,350.20 Euro me TVSH.

Kontrata Monitorim-Konsulencë midis Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH) dhe BOE “L..... E..... S.r.l & S.. S.p.a & S..... S.p.a” me Nr.9999Prot. datë 05.12.2016 me vlerë 4,800,300 Euro pa TVSH për të katër kontratat e zbatimit të mirëmbajtjes.

2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

2.1 Marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimeve dhe raportimi i tyre.

Për marrëveshjen financiare u shqyrtua dokumentacion i vendosur në dipozicion dhe më poshtë paraqiten hapat e miratimit dhe ratifikimit të kësaj marrëveshje si dhe ndryshimet e saj:

-Me VKM nr. 161, datë 25.02.2015 është miratuar në parim marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për “Projekt i mirëmbajtjes dhe sigurisë rrugore bazuar në rezultate”.

-Me ligjin nr. 71, datë 02.07.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate”” është miratuar marrëveshja e huas me dekretin nr.9174, datë 14.07.2015 të Presidentit të Republikës të Shqipërisë.

-Me shkresën e dërguar në datën 25.09.2015 Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim ka njoftuar Ministrinë e Financave për hyrjen në fuqi të marrëveshjes, si dhe bërjen efektive të huasë për Projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate”. Me shkresën nr.376/16 prot, datë 01.10.2015 Ministria e Financave ka njoftuar Ministrinë e Transportit dhe të Infrastrukturës lidhur me njoftimin e Bankës për hyrjen në fuqi të marrëveshjes. Më tej me shkresën nr. 5038/1 prot, datë 06.10.2015 është njoftuar ARRSH lidhur me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

-Me shkresën nr. 8866 prot, datë 29.10.2015 “Projekti i mirëmbajtjes dhe sigurisë rrugore bazuar në rezultate. Mbi hapjen e numrave të llogarive si dhe personat e autorizuar për firmosjen e veprimeve financiare”, ARRSH i drejtohet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, duke i kërkuar çeljen e llogarive bankare, nga ana e Ministrisë së Financave, për kryerjen e veprimeve financiare të Projektit, emërimin e nëpunësit autorizues dhe atij zbatues, si dhe emërimin e personave të autorizuar për kryerjen e disbursimeve pranë Bankës Botërore.

-Me shkresën nr. 5515/11 prot, datë 18.12.2015 Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dërgon në ARRSH konfirmimin e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues, të cilët janë Nëpunës Autorizues D. Xh. dhe Nëpunës Zbatues Agron Tyli. Personat e autorizuar për kryerjen e disbursimeve pranë Bankës Botërore janë D. Xh. dhe A. Sh.

Shkresat për ndryshimet e mëtejshme në staf lidhur me nëpunësin zbatues dhe personat e autorizuar për kryerjen e disbursimeve pas ndryshimeve të drejtorëve të përgjithshëm të ARSSH nuk na janë vendosur në dispozicion.

Me shkresën nr. 6169/1 prot, datë 16.12.2015 Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dërgon në ARRSH konfirmimin e Bankës së Shqipërisë për hapjen e llogarisë speciale për Projektin.

-Me shkresën nr. 6623 prot, datë 31.12.2015 Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dërgon në ARRSH numrat e llogarive në monedhat Lekë dhe Euro.

-Në bazë të programit të marrëveshjes bazë të financimit agjencia e zbatimit të programit aktualisht ARRSH duhet ta përdorë huanë vetëm për të financuar punime mirëmbajtjeje e monitorimi, reforma institucionale, reformat në sektor, si dhe menaxhimi e auditimi i projektit.

-Referuar nenit 2 dhe seksionit IV të marrëveshjes disbursimi do të bëhet sipas përqindjes së përcaktuar për shpenzimet e pranueshme pasi të jenë përmbushur kushtet e Bankës, që janë dorëzimi i raportit të përgatitur nga ARRSH-ja për ekzekutimin e Projektit, raportet e ILD-ve për vitet përkatëse, si dhe do të paguhet komisioni i administrimit në vlerë 0.25% të shumës së huasë,

dhe komisioni i angazhimit në vlerën 0.25% të huasë. Në lidhje me sa më sipër, Banka mund të kufizojë tërheqjet nëse përcakton se bazuar në provat që i vendosen në dispozicion, objektivat nuk janë arritur apo janë arritur pjesërisht.

-Procedurat e ngritjes së strukturave për funksionimin e marrëveshjes së financimit janë përcaktuar në bazë të nenit 5, pjesa 2 seksioni I. A. 1/c të marrëveshjes, në të cilën përcaktohet se: *“Do të mbajë gjatë zbatimit të Projektit një ekip të menaxhimit të Projektit, si dhe punonjës kyçë në ARRSH, duke përfshirë këtu një specialist prokurimi, një specialist të menaxhimit financiar, të gjithë këta me funksione, përgjegjësi, kualifikime dhe përvojë të mjaftueshme për Bankën”*.

-Qëllimi i këtij Projekti është krijimi dhe mirëmbajtja e një sistemi për implementimin dhe menaxhimin, i cili duhet të përfshijë çështjet financiare, të prokurimit dhe të sigurisë. Ky manual reflekton dispozitat e marrëveshjes së kredisë midis Qeverisë Shqiptare dhe Bankës. Manuali është miratuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës me shkresën nr.4864 prot, datë 23.09.2015 dhe i është dërguar Bankës për aprovim.

-Me shkresën nr. 1501 prot, datë 04.03.2016 është ngritur, në ARRSH, struktura përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e Projektit sipas kuadrit ligjor të përcaktuar në Marrëveshjen e Kredisë, Manualin e Operimit dhe Funksionimin, si dhe Udhëzuesve të Bankës Botërore. Komponentët e parashikuar në këtë manual janë si më poshtë:

1. Komponenti 1 – Punimet e mirëmbajtjes dhe monitorimin (në total 114.67 milionë Euro, financimi i Bankës 56.39 Milionë Euro), që do të suportojë mirëmbajtjen periodike dhe rutinë të rrugëve të Projektit:

-Nën Komponenti 1. A – Mirëmbajtja e gjendjes së rrugëve. 1400 km rrugë primare nga rrugët primare-sekondare për t’u mirëmbajtur me kontratat hibride të bazuara në performancë.

-Nën Komponenti 2. B – Ky komponent do të financojë Shërbimet e Monitorimit të Konsulentit. Roli primar i konsulentit është të sigurojë që nivelet e shërbimit të përcaktuara në kontratat e mirëmbajtjes janë përmbushur. Konsulenti po ashtu do të sigurojë fillimin e auditit të sigurisë rrugore, të organizojë mbikëqyrjen iRap, si dhe të sigurohet që identifikohen pikat e zeza të sigurisë rrugore dhe zgjerimi i punës i kërkuar për këto pika bashkë me zhvillimin e Sistemit të Transparencës Sociale.

2. Komponenti 2 – Reformat institucionale (Totali 5.93 milionë Euro, financimi i Bankës 2.92 milionë Euro), duke synuar zgjerimin e kapaciteteve të sigurisë rrugore dhe menaxhimin e aseteve rrugore në nivel vendor:

-Nën Komponenti 2. A – Operacionalizimi i sigurisë rrugore në ARRSH, MIE dhe në Këshillin Ndër-Ministror të Sigurisë Rrugore, duke forcuar politikat dhe veprimet organizionale përmes kurseve për akreditimin e auditit të Sigurisë Rrugore, fushata mediatike mbështetëse, dhe zhvillimin e një baze të dhënash për zgjerimin e Sistemit të Informacionit të Aksidenteve.

-Nën Komponenti 2. B – Institucionalizimi i Sistemit të Menaxhimit të Aseteve Rrugore (SMAR), duke rritur kapacitetin e ARRSH për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave rrugore, mbikëqyrjen e gjendjes së rrugëve për të mbledhur të dhëna për SMAR, si dhe kryerja e trajnimeve me stafin e ARRSH për përdorimin e sistemit për planifikim buxheti për mirëmbajtje shumë-vjeçare dhe shpenzime investimesh.

3. Komponenti 3 – Reforma sektoriale (Totali 4.74 milionë Euro, financimi i Bankës 3.95 milionë Euro), që do të mbështesë reformat në sektorin e transportit. Ky komponent do të financojë reformat në sektorin e adresave, që do të përfshijë asistencën teknike dhe këshillimore ndaj Qeverisë Shqiptare për finalizimin e Strategjisë të Sektorit të Transportit i lidhur me planin e implementimit, si dhe mbështetje teknike dhe analitike për planifikimin afat-mesëm të buxhetit.

4. Komponenti 4 – Menaxhimi i Projektit dhe Auditit (Totali 2.97 milionë Euro, financimi i Bankës 2.47 milionë Euro):

-Nën komponenti 4. A – mbështetje e funksioneve të menaxhimit për ARRSH lidhur me Grupin e Menaxhimit të Projektit dhe mundësi të kostove operative.

-Nën Komponenti 4. B – aktivitetet e monitorimit përfshirë dhe impaktin të përfituesit, auditimet teknike dhe auditimet e DLI-ve.

Referuar këtij manuali, grupi i menaxhimit të Projektit do të përbëhet nga:

- Drejtor Projekti 1 (staf i ARRSH),
 - Menaxher Projekti 1 (konsulent individual),
 - Drejtor Projektsh 1 (stafi i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës),
 - Specialist Prokurimesh 1 (konsulent individual),
 - Specialist i Menaxhimit Financiar 1 (konsulent individual),
 - Shefi i Sektorit të Financës 1 (staf i ARRSH),
 - Roje 2 (staf i ARRSH),
 - Specialistë të sigurisë rrugore 2 (stafi i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe ARRSH),
 - Departamentet e Mirëmbajtjes Rajonale Rrugore 4
- Kontrata A – Shqipëria Veriore: Rajonet Shkodër dhe Kukës,
-Kontrata B – Shqipëria Qendrore /Veri-Lindore: Rajonet Tiranë dhe Dibër,
-Kontrata C – Shqipëria Qendrore/Jug-Lindore: Rajonet Fier, Elbasan dhe Korçë,
-Kontrata D – Shqipëria Jugore: Rajonet Vlorë dhe Gjirokastrë.
- Inspektorë/Inxhinierë të mirëmbajtjes rrugore 2 (konsulentë individualë),
 - Shoferë 2 (të punësuar).

Në Gusht të 2015 është hartuar “Manuali i Punëve të Projektit” (më poshtë referuar si POM), drejtimet e të cilit shprehen si më poshtë:

-Përshkrimi dhe dokumentet ligjore,

-Objektivat dhe përshkrimi i Projektit “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate”,

-Marrëveshjet institucionale dhe të menaxhimit të Projektit,

-Menaxhimi financiar,

-Prokurimi.

Ky manual ka ndryshuar dy herë: në Mars 2020 dhe në Shtator 2021. Ndryshimet paraqiten si më poshtë:

-Ndërsa synimi është që RAMS përfundimisht të operohet nga një njësi e specializuar RAMS brenda Strukturës organizative të ARRSH-së, Banka dhe ARRSH ranë dakord në prill 2021 që RAMS do të operohet përkohësisht si pjesë e Ekipit të Menaxhimit të Projektit (PMT) deri në atë moment kur Buxheti i ARRSH-së do kryejë alokimin e nevojshëm të fondeve për të paguar koston e plotë të njësisë RAMS (përfshirë stafin dhe koston të tjera operative). Më tej u dakordësua, që për të vënë në funksion RAMS, ARRSH do të transferojë tre nga stafi ekzistues në EMP për të plotësuar pozicionet e specialistit RAMS, specialistit të GIS dhe specialistit të IT-së. Përveç kësaj, EMP do të punësojë dhe tre punonjës të tjerë për të plotësuar pozicionet e mbetura të RAMS ekipi. I gjithë personeli i njësisë RAMS do të jetë nën kontratat e konsulentit.

-Banka dhe ARRSH kanë rënë dakord që në vitin 2021, si një marrëveshje e përkohshme, në ARRSH do të krijohet Njësia e re e Sistemit të Menaxhimit të Aseteve Rrugore (RAMS), brenda EMP-së, deri në këtë rast koha kur buxheti i rregullt vjetor i ARRSH-së përfshin burimet e nevojshme për pagimin e kostove dhe shpenzimet e njësisë RAMS.

- PMM (Plani i Menaxhimit të Mjedisit) do të operojë gjithashtu Sistemin e Menaxhimit të Aseteve Rrugore të ARRSH-së, si pjesë e një marrëveshje e përkohshme.

Në strukturë ndryshimet konsistojnë si më poshtë:

Koordinator i RAMS (Konsulent Individual)

Specialist i RAMS (Konsulent Individual)

Specialist i IT (Konsulent Individual)

Specialist i GIS (Konsulent Individual)

Specialist i HDM – 4 (Konsulent Individual)

Menaxher Sistemi (Konsulent Individual)

Specialist

- Personeli i lidhur me RAMS (përfshi dhe rekrutimin e pozicioneve të konsulencës) janë nën kontrollin e Menaxherit të Projektit.

-Menaxhimi i përgjithshëm dhe koordinimi me personelin e ARRSH-së të Asetit Rrugor. Njësia e Sistemit të Menaxhimit (RAMS), do të jetë nëpërmjet Drejtorisë së Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes (struktura aktuale), pasi kjo drejtori është përgjegjëse për funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve nën juridiksionin e ARRSH.

-Referuar e-mail-ëve të vëna në dispozicion nga ARRSH, konstatohet se në datën 12.03.2018 i është dërguar Bankës kërkesa për të bërë ndryshime në strukturë. Fillimisht është bërë kërkesë për të shtuar një sekretare e cila do të merrej me shkresat dhe përkthimet e dokumentacionit të Projektit. Po ashtu në strukturë janë shtuar dhe dy inxhinierë (konsulentë individualë). Shtesat në staf parashikohet të përballohen nga Kostot Operacionale të Projektit. Pas kërkesës së Bankës është vënë në dispozicion dokumenti me amendimet për t'u marrë në konsideratë. Lidhur me amendimet e propozuara Banka ka dhënë miratimin e saj sa i takon shtesave në staf, konfirmuar me email-in e datës 21.05.2018.

-Me shkresën dërguar pranë MIE nr. 5058 prot, datë 06.08.2018, ARRSH ka kërkuar po ashtu miratim për ndryshimet në strukturën e Projektit.

-Me shkresën nr. 8441/2 prot, datë 27.07.2018 MIE ka dërguar miratimin e këtyre ndryshimeve. Në gusht 2018 është ndryshuar Manuali i Punëve të Projektit. Referuar këtij manuali, struktura e Projektit është ndryshuar duke pakësuar dy shoferët, dhe duke shtuar në strukturën e Projektit një specialist administrate (konsulent individual) si dhe një specialist logjistike (konsulent individual).

-Referuar faktit struktura e Projektit është si më poshtë:

- Menaxher Projekti,
- Specialist i menaxhimit financiar,
- Specialist prokurimesh,
- Inspektor i mirëmbajtjes rrugore/Inxhinier A-B,
- Inspektor i mirëmbajtjes rrugore/Inxhinier C-D,
- Inspektor i mirëmbajtjes rrugore/Inxhinier B,
- Inspektor i mirëmbajtjes rrugore/Inxhinier C,
- Inspektor i mirëmbajtjes rrugore/Inxhinier D,
- Specialist administrate,
- Specialist logjistike.

Sa i takon ndryshimeve në strukturën e Projektit rezulton se me shkresën nr. 9168/2 prot, datë 06.12.2017 “Kërkesë zyrtare për dorëheqje” nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH z. A.... Q....., i është kërkuar Menaxherit të Projektit z. E..... N..... dorëheqja zyrtare me motivacionin si më poshtë:

“... 1. Implementim i ngadaltë i progresit të punës lidhur me aktivitetet e projektit, nivel i ulët i disbursimeve që është përgjegjësi kryesore e menaxherit të projektit,
2. Mungesë bashkëpunimi me ARRSH, me kolegët përkatës të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe institucione të tjera të rëndësishme,
3. Krijimi i një klime jo favorizuese dhe sjellja konfliktuale kundrejt grupit të konsulentëve monitorues dhe koordinatorëve të Projektit, që ka çuar në dëmtim të gjetjes së zgjidhjeve dhe adresimit të çështjeve dhe problemeve, dhe ka rezultuar në mosmarrëveshje dhe diskutime mes palëve të prekura...”

Me shkresën nr. 1358 prot, datë 19.02.2018 “Kërkesë për informacion mbi njoftimin e publikuar në web-in zyrtar të ARRSH-së më datë 15.02.2018 për shpalljen e vendit të lirë punës për pozicionin e Menaxherit të Projektit RRMSF” rezulton se z.E..... N..... kërkon informacion lidhur me shpalljen e vendit vakant pasi ai nuk është njoftuar për shpallje apo pushim nga puna, ndërkohë që sa më sipër shpallja e pozicionit vakant të punës është bërë dhe në strukturë ka vetëm një pozicion pune si menaxher projekti.

Në datën 28.02.2018 është pushuar nga puna Menaxheri i Projektit z. E..... N....., me motivacion performancë e dobët. Z. N..... ka hapur proces gjyqësor kundër ARRSH për pushim të padrejtë nga detyra. Me vendim nr. 6086, datë 05.07.2018 Gjykata e Shkallës së Parë të Tiranës ka vendosur:

1. Pranimin e kërkesë-padisë,
2. Detyrimin e palës së paditur, ARRSH, të dëmshpërblejë paditësin me pagën e dy muajve për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës,
3. Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin me dyzet paga mujore ($42 \times 1.500 = 63.000$ Euro), si rezultat i ndërprerjes së kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara,
4. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.

Kundër këtij vendimi është ushtruar ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë me shkresë nr. 7109/1 prot, datë 24.08.2018.

Sa më sipër vlera totale prej 63.000 Euro përbën efekt financiar negativ deri në këtë fazë të gjykimit.

-Po ashtu pozicioni i specialistit të prokurimeve ka qenë vakant nga periudha 22.08.2016 deri në 14.06.2018, dhe nga data 04.07.2019 është larguar nga detyra specialistja e prokurimeve. Nga kjo datë deri në periudhën aktuale ky pozicion konstatohet të jetë vakant. Nuk na janë vënë në dispozicion dokumentet justifikues të këtij pushimi nga puna.

-Në datën 31.01.2018 është larguar nga detyra me dëshirën e saj specialistja e menaxhimit financiar znj. A..... S.....

Në këtë pozicion është emëruar në datën 02.03.2018 znj.E.... A....., e cila më pas është pushuar nga puna për performancë të dobët në detyrë, në datën 16.07.2019. Vakanca e krijuar nga ky pushim nga puna ka dëmtuar procesin e disbursimit të fondeve të projektit, dhe ka shkaktuar ngërç. Duke ditur situatën e rënduar dhe faktin që llogaria e projektit tashmë kishte shkuar në minus, duhet të ishin marrë masa për realizimin e aplikimit për disbursim dhe jo të largohej nga detyra specialistja në fjalë.

-Me Vendimin Nr. 3700, datë 31.05.2021, Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë ka vendosur:

1. Pranimin e pjeshëm të kërkesë-padisë.
2. Detyrimin e palës së paditur Autoriteti Rrugor Shqiptar, të dëmshpërblejë paditësen E.A. me pagën e 17 muajve punë, që i përket periudhës së marrëdhënieve të punës me afat të përcaktuar.

3. Detyrimin e palës së paditur Autoriteti Rrugor Shqiptar, të dëmshpërblejë paditësen E.A. me pagën e një muaji si rezultat i mosrespektimit të afatit të njoftimit.

4. Detyrimin e të paditurit Autoriteti Rrugor Shqiptar, të dëmshpërblejë paditësen E. A. me pagën e 2 (dy) muajve si rezultat i mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së marrëdhënieve të punës.

5. Detyrimin e palës së paditur Autoriteti Rrugor Shqiptar ti paguajë palës paditëse lejen vjetore të vitit 2019.

6. Përlllogaritja e pagës për paditësen të bëhet në vlerën 1400 Euro në muaj.

7. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër si e pabazuar në ligj.

8. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të paditurit.

-Ky vendim gjyqësor është ankimuar nga ARRSH, Ankim nr.9952 datë 04.11.2021 dhe çështja nuk është shqyrtuar ende nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Sa më sipër vlera totale prej 29,400 Euro (21 paga * 1,400) përbën efekt financiar negativ deri në këtë fazë të gjykimit.

-Bazuar në pikën 30, faqa 19 të MOP largimet nga detyra të stafit/konsulentëve mund të kryhen duke u bazuar në performancën e tyre apo në parashikimet e kontratave të lidhura. Po ashtu referuar këtij manuali, duhet të kryhen vlerësime vjetore të vlerësimeve të performancës të stafit bazuar në specifikimet teknike, e cila duhet të udhëhiqet nga Drejtori i Projektit (pra Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH) dhe t'i raportohet Bankës.

Rezultoni se deri në periudhën aktuale nuk janë kryer vlerësime vjetore referuar këtij manuali.

Për sa më sipër për mos respektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, mban përgjegjësi në cilësinë e ish Drejtoreshës të ARRSH znj. S..... Q.....

Në Marrëveshjen e Huasë, pika 2, seksioni I. A i pjesës 2 “Zbatimi i Projektit”, përcaktohet ngritja e Komitetit Drejtues për zbatimin e projektit. Ky komitet ka për qëllim të sigurojë cilësinë në lidhje me aspektet teknike të sigurisë rrugore.

-Me urdhrin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 164, datë 17.12.2015 “Për ngritjen e Komitetit Drejtues për Projektin Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore bazuar në rezultate” është ngritur Komiteti Drejtues. i përbërë nga specialistët përkatës të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, si dhe specialistë të ARRSH.

-ARRSH me shkresën nr. 756 prot, datë 25.01.2017 ka propozuar ndryshimin e anëtarëve të saj të Komitetit Drejtues të Projektit bazuar në emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH. Përfaqësuesit e ARRSH sipas kësaj shkrese janë A..... Q..... dhe S..... T.....

-ARRSH me shkresën nr. 8458 prot, datë 24.10.2017 ka propozuar ndryshimin e anëtarëve të saj të Komitetit Drejtues të Projektit bazuar në emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH. Përfaqësuesit e ARRSH sipas kësaj shkrese janë A..... Q..... dhe S..... T.....

-Referuar konfirmimit të Menaxherit të Projektit, në dijeninë e tij nuk rezulton të jenë kryer takime dhe të jenë marrë vendime nga ky Komitet Drejtues i Projektit.

Grupi i auditimit konstatoi se bazuar në korrespondencën e datë 17 maj 2019 (nr. 4859 prot, datë 20.02.2019) midis ARRSH dhe Bankës, e cila i referohet Aide-Memoire të misionit të Bankës mbi Rishikimin Afatmesëm i cili u zhvillua në Tiranë gjatë periudhës 2-9 prill 2019, Banka ka dakordësuar se ka lindur nevoja për një ristrukturim të Projektit, duke përfshirë ri alokimin e fondeve ndërmjet komponentëve të Projektit.

Gjatë këtij takimi është rënë dakort në parimin lidhur me nevojën e Amendimit të Marrëveshjes së Huasë, si më poshtë:

“Në Shtojcën “Përkufizime” të Marrëveshjes së Huasë, “Viti 1” i projektit i referohet vitit kalendarik 2016, duke supozuar se katër Kontratat e Mirëmbajtjes të bazuara në Rezultate do të ishin nënshkruar deri atëherë. Por për shkak të vonësës prej më shumë se një viti të procesit të

përzgjedhjes së kontraktorëve të mirëmbajtjes, katër kontratat u nënshkruan në fillim të vitit 2017 (janar dhe shkurt). Kjo ka sjellësi pasojë që për vitin 2016 nuk u realizua asnjë indikatorë dhe automatikisht një humbje prej 7.88 milionë Euro të Projektit. Për këtë arsye u dakordësua që “Viti 1” të ripërcaktohet viti 2017, dhe “Viti 5” të jetë viti 2021.

-Po ashtu u dakordësua në parim modifikimi i DLI 2.1, i cili lidhet me sondazhet e sigurisë rrugore (iRAP) dhe vlerësimet me yje të rrugëve të projektit. Kjo DLI fillimisht përcakton realizimin e tre studimeve të iRAP-it (e para në vitin 1, e dyta në vitin 3 dhe e treta në vitin 5). Por gjatë rishikimit afatmesëm u konstatua se sondazhi i dytë iRAP nuk është teknikisht i justifikuar pasi punimet e rehabilitimit dhe përmirësimit nuk do të përfundojnë brenda vitit. Prandaj, sondazhi i dytë duhet të bjerë dhe DLI 2.1 të modifikohet, me shumën totale prej 2.97 milionë Euro, për tu ndarë në mënyrë të barabartë midis dy viteve të mbetura.”

Me shkresën nr. 9592 prot, datë 21.10.2019 “Rishikimi dhe amendimi i marrëveshjes së huasë” referuar konsultimeve me Bankën, ARRSH i ka dërguar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë kërkesën për komunikim me Ministrinë e Financave lidhur me amendimet e kërkuara dhe argumentet përkatëse.

Nëpërmjet kësaj shkrese kërkesat janë si më poshtë:

– “Viti 1” i projektit të ripërcaktohet si viti kalendarik 2017 dhe “Viti 5” të jetë viti 2021.

-Data e përfundimit të kësaj marrëveshje huaje të ripërcaktohet data 30 qershor 2022.

-Modifikimi i Indikatorit të Disbursimit DLI 2.1 i cili lidhet me sondazhet e sigurisë së rrugës (iRAP) dhe vlerësimet me yje të rrugëve të projektit, i parashikuar për tu realizuar tre herë gjatë kohëzgjatjes së projektit në vetëm, dy herë.

-Ri përcaktimi i vitit 2021 si afati final i synimit për arritjen e Indikatorit të Disbursimit DLI 2.2. Referuar kësaj shkrese, kjo është kërkesa e parë për ndryshimin e kësaj marrëveshje huaje dhe arsyet në mbështetje të kësaj kërkesë janë si më poshtë:

1. Ka patur vonesa në nënshkrimin e e Kontratave të Mirëmbajtjes dhe fillimi i këtij Projekti është viti 2017 dhe jo viti 2016 si ishte parashikuar në Marrëveshjen e Huasë. Kjo lidhet me arritjen e objektivave të disbursimit (DLI-të).

2. Shtyrja edhe për gjashtë muaj të afatit të përfundimit të kësaj Marrëveshje do të krijonte hapësirat për përgatitjen e dokumentacionit të përmbylljes së kësaj Marrëveshje.

Po ashtu me këtë shkresë janë kërkuar nga ana e ARRSH dhe ndryshimet e mëposhtme, të cilat nuk i janë paraqitur Bankës për miratim:

-Megenëse tashmë data e përfundimit të këtij projekti është e njëjtë me datën e përfundimit të kontratave pesë vjeçare të Mirëmbajtjes, kërkohet një periudhë minimalisht gjashtë mujore shtesë, pas përfundimit për të mundësuar përgatitjen e dokumentacionit përmbyllës të këtij projekti dhe dorëzimit të tij pranë autoritetit kontraktor (në këtë rast ARRSH). Gjithashtu kjo periudhë mund të përdoret për të mbështetur ARRSH-në në përgatitjen dhe fillimin e kontratës/ave pasardhëse të Mirëmbajtjes me bazë Performancë.

-Indikatorit DLI 2.2 është i lidhur me ndërtimin brenda ARRSH të një Sistemi për Menaxhimin e Aseteve Rrugore (RAMS), mbledhjen dhe analizimin e të dhënave mbi gjendjen e aseteve rrugore dhe përdorimin e këtij sistemi (RAMS) për të përgatitur programe shumëvjeçare mirëmbajtjeje për shpenzimet dhe investimet. Indikatorit DLI 2.2 në Marrëveshjen e Huasë ishte përcaktuar nën supozimin se sistemi RAMS do të krijohet në vitin e parë të projektit. Me gjithë asistencën teknike për ARRSH nga një firmë konsulente e huaj e specializuar, sistemi parashikohet të vendoset plotësisht në funksionimin në vitin e fundit të projektit (2021). Për sa më sipër, ARRSH kërkon që afati i synuar për arritjen e indikatorit DLI 2.2 të ripërcaktohet viti 2021 dhe shuma përkatëse e

disbursimit prej 5.93 milionë Euro të jetë e lidhur me arritjen e indikatorit po atë vit (pra në 2021).”

Sa më sipër akoma nuk ka një përgjigje nga institucionet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Sa i takon Manualit të Operacioneve të Projektit, ai është amenduar dy herë, në Mars 2020 dhe në Shtator 2021. Amendimet konsistojnë si më poshtë:

-Ndërsa synimi është që RAMS përfundimisht të operohet nga një njësi e specializuar RAMS brenda Strukturës organizative të ARRSH-së, Banka dhe ARRSH ranë dakord në prill 2021 që RAMS do të operohet përkohësisht si pjesë e Ekipit të Menaxhimit të Projektit (PMT) deri në atë moment kur Buxheti i ARRSH-së do kryejë alokimin e nevojshëm të fondeve për të paguar koston e plotë të njësisë RAMS (përfshirë stafin dhe kosto të tjera operative). Më tej u dakordësua, që për të vënë në funksion RAMS, ARRSH do të transferojë tre nga stafi ekzistues në EMP për të plotësuar pozicionet e specialistit RAMS, specialistit të GIS dhe specialistit të IT-së. Përveç kësaj, EMP do të punësojë dhe tre punonjës të tjerë për të plotësuar pozicionet e mbetura të RAMS ekipi. I gjithë personeli i njësisë RAMS do të jetë nën kontratat e konsulentit.

-Banka dhe ARRSH kanë rënë dakord që në vitin 2021, si një marrëveshje e përkohshme, në ARRSH do të krijohet Njësia e re e Sistemit të Menaxhimit të Aseteve Rrugore (RAMS), brenda EMP-së, deri në këtë rast koha kur buxheti i rregullt vjetor i ARRSH-së përfshin burimet e nevojshme për pagimin e kostove dhe shpenzimet e njësisë RAMS.

-PMM (Plani i Menaxhimit të Mjedisit) do të operojë gjithashtu Sistemin e Menaxhimit të Aseteve Rrugore të ARRSH-së, si pjesë e një marrëveshje e përkohshme.

Në strukturë ndryshimet konsistojnë si më poshtë:

Koordinator i RAMS (Konsulent Individual)

Specialist i RAMS (Konsulent Individual)

Specialist i IT (Konsulent Individual)

Specialist i GIS (Konsulent Individual)

Specialist i HDM – 4 (Konsulent Individual)

Menaxher Sistemi (Konsulent Individual)

Specialist

- Personeli i lidhur me RAMS (përfshi dhe rekrutimin e pozicioneve të konsulencës) janë nën kontrollin e Menaxherit të Projektit.

-Menaxhimi i përgjithshëm dhe koordinimi me personelin e ARRSH-së lidhur me Asetit Rrugor. Njësia e Sistemit të Menaxhimit (RAMS), do të jetë nëpërmjet Drejtorisë së Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes (struktura aktuale), pasi kjo drejtori është përgjegjëse për funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve nën juridiksionin e ARRSH.

Me shkresën e Bankës Botërore të datës 29.03.2021 “Amendimi i marrëveshjes së huasë”, drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, referuar bisedimeve mes palëve janë miratuar nga Banka ndryshime si më poshtë:

-Data e përfundimit të Projektit është 31 Dhjetor 2022,

-Viti 1 do të konsiderohet periudha 10 mujore duke filluar nga Marsi 2017 e deri në 31 Dhjetor 2017,

-Viti 2 do të konsiderohet periudha 12 mujore duke filluar nga 1 Janar 2018 e deri në 31 Dhjetor 2018,

-Viti 3 do të konsiderohet periudha 12 mujore duke filluar nga 1 Janar 2019 e deri në 31 Dhjetor 2019,

- Viti 4 do të konsiderohet periudha 12 mujore duke filluar nga 1 Janar 2020 e deri në 31 Dhjetor 2020,
- Viti 5 do të konsiderohet periudha 15 mujore duke filluar nga 1 Janar 2021 e deri në 31 Mars 2022,
- Këto ndryshime janë reflektuar dhe në indikatorët e lidhur me disbursimet.

Nga sa më sipër rezultoi:

1. Titulli i Gjetjes:	Rialokim i fondeve si rezultat i mos realizimit të projektit të zbatimit sipas afateve të përcaktuara në marrëveshjen financiare.
Situata:	<p>Në marrëveshjen e huasë, viti i fillimit të Projektit (viti 1) do të ishte viti 2016 dhe viti i përfundimit (viti 5) do të ishte viti 2021 por konstatohet se periudha kohore e fillimit është viti 2017 dhe jo ai I parashikuar në marrëveshje. Kjo shtyrje ka ardhur si rezultat i vonesave të procesit të prokurimit, lidhjes të kontratave (në janar dhe shkurt të vitit 2017), mos njohja e disa komponentëve të projektit nga palët, të cilat kanë sjell disbursimin e vlerat e parashikuara në këtë marrëveshje me vonesë. Bankës Botërore, me shkresën datë 29.03.2021 “Amendimi i marrëveshjes së huasë”, amendimet konsistuan në konsiderimin e vitit 1 të periudhës 10 mujore duke filluar nga Marsi 2017 e deri në 31 Dhjetor 2017 dhe data e përfundimit të Projektit është 31 Dhjetor 2022. Shuma origjinale e kontratës ishte në vlerën 70,486,573.71 Euro, e cila pas rishikimeve të kontratës arriti në vlerën përfundimtare 85,651,671.08 Euro.</p> <p>Referuar përcaktimeve të Marrëveshjes, problematikat e krijuara gjatë realizimit të këtij Projekti mund të sillnin për pasojë anulimin ose rialokimin e shumës të përcaktuar për kategorinë 1 “<i>Mallra, punime, shërbime të konsulentëve dhe trajnim për pjesët 1 dhe 2 të Projektit</i>” në një kategori më poshtë, pra shërbime konsulence dhe kosto operative, duke mos realizuar objektivat dhe qëllimet kryesore të Projektit.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 71, datë 02.07.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate”, seksioni IV, pika B, 4 ,d) “ <i>Pa cenuar dispozitat e paragrafëve “a” dhe “b” më sipër, çdo shumë e Huas që nuk jepet në përputhje me paragrafët në fjalë mund të anulohet ose të rialokohet në kategorinë 2 nga Banka në konsultim me Ministrinë e Financave të Huamarrësit ose për shumën e caktuar për secilin Shpenzim të Pranueshëm brenda kategorisë 1 bëhet me miratimin e Ministrisë së Financave të Huamarrësit</i> ”.
Ndikimi/Efekti:	Devijim nga objektivat e projektit.
Rëndësia:	E lartë.
Shkaku:	Mos disbursim i kësteve kredisë sipas afateve të përcaktuara në marrëveshje.
Rekomandim:	Nga Autoriteti Rrugor Shqiptar të merren masa që në Projektet e ardhshme të shmangen situatat të cilat mund të sillnin për pasojë realizimin e objektivave të projektit.

2. Titulli i Gjetjes:	Ndërprerja e marrëdhënieve të punës në mënyrë të pa justifikuar.
Situata:	<p>Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion u konstatua janë larguar nga puna Menaxheri i Projektit dhe Specialistja e Menaxhimit Financiar. Në datën 28.02.2018 është pushuar nga puna Menaxheri i Projektit me motivacion performancë e dobët gjatë ushtrimit të detyrës, pasi me shkresën nr. 9168/2 prot, datë 06.12.2017 “Kërkesë zyrtare për dorëheqje” nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH, i është kërkuar Menaxherit të Projektit dorëheqja zyrtare. Pas Largimit nga detyra Menaxheri i Projektit ka hapur proces gjyqësor kundër ARRSH për pushim të padrejtë nga detyra. Me vendim nr. 6086, datë 05.07.2018 Gjykata e Shkallës së Parë të Tiranës ka vendosur pranimin e kërkesë-padisë dhe dëmshpërblimin e paditësit me dyzetë e dy paga (42*1.500=63.000 Euro). Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë me shkresë nr. 7109/1 prot, datë 24.08.2018, ku kjo gjykatë nuk ka dalë ende me një vendim.</p> <p>Në pozicionin e Specialistes së Menaxhimit Financiar është emëruar në datën 02.03.2018 znj..... A....., e cila më pas është pushuar nga puna për performancë të dobët në detyrë, në datën 16.07.2019. Me vendim nr. 6086, datë 05.07.2018 Gjykata e Shkallës së Parë të Tiranës ka vendosur pranimin e kërkesë-padisë dhe dëmshpërblimin e paditësit me njëzetë e një paga (42*1.500=63.000 Euro).</p> <p>-Me Vendimin Nr. 3700, datë 31.05.2021, Gjykata e Shkallës të Parë, Tiranë vendosur pranimin e kërkesë-padisë dhe dëmshpërblimin e paditësit me dyzetë e dy paga ((21 paga * 1,400 = 29,400 Euro). Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë me shkresë nr. 9952 prot, datë 04.11.2021 dhe çështja nuk është shqyrtuar ende nga Gjykata e Apelit Tiranë.</p> <p>Largimet nga detyra janë bërë në kundërshtim me MOP ku punëdhënësi nuk është bazuar në performancën e tyre apo në parashikimet e kontratave të lidhura e cila nuk justifikon veprimet e kryera.</p> <p>Sa më sipër vlera totale prej 92,400 Euro të fituara nga punonjësit e larguar nga puna, deri në këtë shkallë të gjykimit, konsiderohet shpenzim pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet në buxhetin e shtetit.</p>
Kriteri:	MOP pika 30, faqa 19 të “ <i>Stafi/konsulentët e Projektit mund të pushohen bazuar në performancë dhe në parashikimet e kontratës së punës. Vlerësimet vjetore të performancës së të gjithë stafit duhet të bëhen nga Drejtori i PMT dhe t’i raportohet ARRSH-së dhe Bankës</i> ”.
Ndikimi/Efekti:	Shpenzim pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet në buxhetin e shtetit në vlerën prej 92,400 Euro.
Rëndësia:	E lartë.
Shkaku:	Mungesë vlerësimi e performancës së punonjësve.
Rekomandim:	Nga Autoriteti Rrugor Shqiptar të merren masa për vlerësimin e performancës së stafit të projekteve, duke shmangur shpenzimet e proceset gjyqësore që mund të rezultojnë në rastet e largimit të tyre nga puna e për rrjedhojë shmangien e përdorimit të fondeve pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet.

2.2 Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit.

Autoriteti Rrugor Shqiptar (më poshtë referuar si ARRSH) si institucioni përfitues huasë së lidhur midis Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rikonstruksion dhe Zhvillim (më poshtë referuar si Banka) për projektin “Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore bazuar në rezultate”, në të cilën janë përcaktuar kushtet dhe objektivat të cilat duhet të arrihen, në mënyrë që të disbursohet në këste shumata e huasë. Marrëveshja dhe komponentët e saj paraqiten si më poshtë.

Pjesa 1. Punime mirëmbajtje dhe monitorimi

- a) Realizimi i mirëmbajtjes periodike dhe rutinë të rrugëve parësore dhe dytësore,
- b) Kryerja e veprimtarive për të monitoruar mirëmbajtjen e rrugëve parësore dhe rrugëve parësore-dytësore, si dhe sigurim se nivelet e përcaktuara të shërbimit respektohen duke, përfshirë: kryerjen e auditimeve fillestare për mirëmbajtjen e rrugëve, realizimin e studimeve periodike të Programit Ndërkombëtar për Vlerësimin e Sigurisë Rrugore (PNVSRR) për t’u siguruar që njollat e zeza shtesë të sigurisë rrugore që identifikohen dhe përmirësimet e duhura të sigurisë të përfshihen në punimet e mirëmbajtjes për rrugët përkatëse dhe zhvillimin e zbatimit të Sistemit të transparencës sociale.

Pjesa 2. Reforma institucionale.

- a) Kryerja e veprimtarive për të rritur kapacitetet e MTI-së, ARRSH-së dhe KNSRR-së në lidhje me kryerjen e veprimtarive nga ana e tyre për të promovuar sigurinë rrugore, që ndër të tjera do të përfshijë: -kryerjen e kurseve të akredituara për vlerësimin e sigurisë rrugore; -realizimin e fushatave mediatike për sigurinë rrugore; -zhvillimin e një baze të integruar të dhënash për të forcuar Sistemin e Informacionit për Aksidentet.
- b) Kryerja e veprimtarive për të fuqizuar aftësitë e ARRSH-së për të: -mbledhur dhe analizuar të dhënat rrugore; -realizuar studime për gjendjen e rrugëve për të mbledhur të dhëna që do të përdoren si kontribut për Sistemin e Menaxhimit të Aksidenteve Rrugore; -përdor SMARR për të përgatitur programe shumëvjeçare mirëmbajtjeje për shpenzimet dhe investimet.

Pjesa 3. Reformat në sektor

- a) Dhënia e shërbimeve teknike dhe këshillimore për Huadhënësin për reformat të ndryshme të sektorit dhe veprimtarisë planifikuese afatmesme ose afatgjata duke përfshirë finalizimin e strategjisë së tij të sektorit të transportit.

Pjesa 4. Menaxhimi dhe auditimi i projektit.

- a) Fuqizimi i kapacitetit të ARRSH-së dhe Ekipit të Menaxhimit të Projektit për të realizuar veprimtarinë e menaxhimit të projektit duke përfshirë respektimin e politikave mbrojtëse, masat për menaxhimin financiar dhe për prokurimin, si dhe financimin e kostove operative.
- b) Kryerja e veprimtarive monitoruese duke përfshirë Vlerësimet e Ndikimit të Përfituesit dhe Auditimet Teknike e Auditet e ILD-ve.

Bazuar në ligjin 71/2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim” kosto totale e parashikuar është në vlerën 128.47 milionë Euro, ndër të cilat shumata e huasë është 65.90 milionë Euro ndërsa pjesa tjetër e mbetur 62.57 milion Euro financohet nga fondet Qeverisë Shqiptare. Kostot përkatëse të çdo komponenti dhe nën komponenti paraqiten si më poshtë:

Pasqyra Nr. 1 Projekt Buxheti

Komponentët e Projektit	Kosto e Projektit (në milionë Euro)	Financimi nga Banka (në milionë Euro)	Përqindja e Financimit
Komponenti 1 1A Punimet e mirëmbajtjes 1B Shërbimet e monitorimit	114.67	56.39	Mbi 50%
Komponenti 2 2A Operacionalizimi i Sigurisë Rrugore 2B Menaxhimi i Aseteve Rrugore	5.93	2.92	Mbi 50%
Komponenti 3 3A Mbështetja për Reforma Sektoriale	4.74	3.95	Mbi 84%
Komponenti 4 4A Mbështetja për Menaxhimin e Projektit 4B Kosto Operacionale 4C Auditime Vjetore të ILD-ve dhe Auditime Teknike	2.97	2.47	Mbi 84%
Taksa Fundore	0.16	0.16	
Totali i Financimit të Kërkuar	128.47	65.90	51.29%

Burimi: Raporti i auditimit të ILD -ve

Këto komponentë janë si më poshtë:

- Komponenti 1 – Punimet e mirëmbajtjes dhe monitorimit, mbështetja periodike dhe rutinë e mirëmbajtjes të rrugëve të Projektit,
- Komponenti 2 – Reforma Institucionale: mbështetja për reformën institucionale si për ARRSH dhe për Ministrinë e Linjës përgjegjëse për transportin, duke synuar zgjerimin e kapaciteteve të sigurisë rrugore dhe menaxhimit të aseteve rrugore në nivel vendor.

Data të rëndësishme për Projektin janë:

- Data e Marrëveshjes së Kredisë në 10 Prill 2015,
- Data e pritur për të bërë efektive Marrëveshjen në Shtator 2015,
- Data e fillimit të Projektit 27 Mars 2015,
- Data e finalizimit të Projektit 31 Mars 2022.

Bazuar në ligjin 71/2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim” ka detyrim të hartojë raporte si më poshtë:

-Raportet e projektit, nëpërmjet të cilave huamarrësi për MIE sigurohet se ARRSH-ja monitoron dhe vlerëson progresin e Projektit në përputhje me dispozitat e përcaktuara në ligj, jo më vonë se një muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga ky raport,

-Raportet Financiare dhe kontrollat Financiare, nëpërmjet të cilave huamarrësi për MIE sigurohet se ARRSH-ja mban ose merr masa përmbajtjen e një sistemi të menaxhimit financiar në përputhje me dispozitat e përcaktuara në ligj, jo më vonë se dyzetë e pesë ditë pas përfundimit të çdo semestri kalendarik(raporte të ndërmjetme),

-Auditimet e ILD-ve, nëpërmjet të cilave sigurohet që janë arritur Treguesit Lidhur me Disbursimin për vitin që do të mbulohet nga auditi, jo më vonë se tre muaj pas fundit të çdo viti.

-Auditimet Teknike, jo më vonë se tre muaj pas fundit të çdo vit.

Referuar detyrimit ligjor mbi raportimin rezulton se në përgjithësi këto afate janë zbatuar.

Sa i takon realizimit të **ILD-ve, për gjithë periudhën e projektit**, paraqiten si më poshtë:

Pasqyra Nr.2 Arritjet e ILD –ve dhe shumat respektive (milion Euro) për periudhën 2016 – 2022

Nr	Emri i ILD	Totali i vlerës të ILD – ve (Plan)	Shuma e ILD Viti 1 (2017)	Shuma e ILD Viti 2 (2018)	Shuma e ILD Viti 3 (2019)	Shuma e ILD Viti 4 (2020)	Shuma e ILD Viti 5 (2021/22)	Shuma totale për vitet 1 – 5 (2017 – 2021/22) (Fakt)
1	ILD-1.1 Mirëmbajtja periodike e rrjetit kombëtar të rrugëve	26.69	0	11.57	5.57	2.37	7.18	26.69 (100%)
2	ILD-1.2 Mirëmbajtja rutinë e rrjetit kombëtar të rrugëve	17.79	3.08	3.56	3.56	3.56	4.03	17.79 (100%)
3	ILD -1.3 Zhvillimi dhe operacionalizimi i Sistemit Social të Transparencës/ Reagimi publik – Sistemi i zgjidhjes	2.97	0.375	0	0	0	0.275	0.65 (22%)
4	ILD -2.1 Mbikqyrje periodike IRAP janë kryer dhe vlerësimi me yje	2.97	0.99	0	0	0	1.98	2.97 (100%)
5	ILD -2.2 Vendosja dhe operacionalizimi i RAMS/BMS	5.93	0	0	0	0	0	0 (0%)
6	ILD -2.3 Niveli i marrëveshjes të shërbimit midis ARRSH dhe MTI	2.96	0	0	0	0	0	0 (0%)
Totali		59.31	4.445	15.13	9.13	5.93	13.465	48.10 (81%)

Burimi: Raporti i auditimit të ILD -ve

Sa më sipër rezulton se arritja e realizimit të ILD – ve paraqitet në masën 81%, konkretisht: ILD 1.1, 1.2 dhe 2.1 janë realizuar në 100% të parashikimit, ndërsa ILD 1.3 është realizuar 22%, ILD 2.2, dhe 2.3 është realizuar në 0%. Sa më sipër arsyet e mos realizimit paraqiten di më poshtë:

ILD 1.1	% aktuale e përmbushjes mirëmbajtjes periodike	Formula përlogaritjes të ILD e	Shuma e çertifikuar për vitin relevant (milione Euro)	Shuma kumulative e çertifikuar (milione Euro)
Viti 1 (Janar – Dhjetor 2017)	0%	0% * 7.48 milionë (shuma e ILD – së për vitin 1)	0	0
Viti 2 (Janar – Dhjetor 2018)	86.6%	86.6% * 13.35 milionë (vlera kumulative nga viti 1 në vitin 2) më pak se 0 milionë (vlera kumulative e çertifikimeve të mëparshme)	11.57	11.57
Viti 3 (Janar – Dhjetor 2019)	89.0%	89.0% * 19.22 milionë (vlera kumulative nga viti 1 në vitin 3) më pak se 11.57 milionë (vlera kumulative e çertifikimeve të mëparshme)	5.57	17.14
Viti 4 (Janar – Dhjetor 2020)	77.9%	77.9% * 25.09 milionë (vlera kumulative nga viti 1 në vitin 4) më pak se 17.14 milionë (vlera kumulative e çertifikimeve të mëparshme)	2.37	19.51
Viti 5 (Janar 2021 – Mars 2022)	104% (mbuluar në 100%)	100% * 26.69 milionë (vlera kumulative nga viti 1 në vitin 4) më pak	7.18	26.69

		se 19.51 milionë (vlera kumulative e çertifikimeve të mëparshme)		
--	--	--	--	--

ILD 1.1 (37,5% e financimit të lidhur me ILD – të), ka lidhje me mnrëmbajtjen periodike të 554 km rrugë. Pas fillimit me hapa të ngadaltë në përgjithësi në fund të projektit target – i u arrit. Marrëveshja e financimit u firmos në datën 10 Prill 2015, dhe përfundimi i vitit 1 konsiderohet fundi i vitit 2016. Duke qenë se Grupi i Menaxhimit të Projektit duhet të përcaktohej dhe kontraktorët duhet të prokuroheshin dhe monitoroheshin, pritshmëritë e realizimit në 28% në vitin e parë, konsiderohet se kanë qenë të larta. Kjo përqindje nuk u arrit deri në vitin e tretë. Mungesa e analizës të kohës të kërkuar për fazat parapërgatitore duket se kanë qenë pengesë lidhur me arritjen e objektivave të përcaktuara.

- Në vitin e parë – 2017: objektivi ka qenë 155 km, ndërsa realizimi 0 km (pra 0 %),
 - Në vitin e dytë – 2018: objektivi ka qenë 277 km, ndërsa realizimi 240 km (pra 86.6 %),
 - Në vitin e tretë – 2019: objektivi ka qenë 399 km, ndërsa realizimi 355 km (pra 89%),
 - Në vitin e katërt – 2020: objektivi ka qenë 520 km, ndërsa realizimi 405 km (pra 77.9 %),
 - Në vitin e pestë – 2021–2022: objektivi ka qenë 554 km, ndërsa realizimi 576 km (pra 104 %).
- Dhe pse objektivi është **realizuar**, përsëri kjo ka ndodhur **një vit me vonesë**.

ILD 1.2	% e pagesave kumulative mesatare për mirëmbajtjen periodike	Formula e përlogaritjes të ILD	Shuma e çertifikuar për vitin relevant (milionë Euro)	Shuma kumulative e çertifikuar (milionë Euro)
Viti 1 (Mars – Dhjetor 2017)	100%	100% * 3.08 milionë (shuma e ILD – së për vitin 1)	3.08	3.08
Viti 2 (Janar – Dhjetor 2018)	100%	100% * 3.56 milionë (shuma e ILD – së për vitin 2)	3.56	6.64
Viti 3 (Janar – Dhjetor 2019)	100%	100% * 3.56 milionë (shuma e ILD – së për vitin 3)	3.56	10.20
Viti 4 (Janar – Dhjetor 2020)	100%	100% * 3.56 milionë (shuma e ILD – së për vitin 4)	3.56	13.76
Viti 5 (Janar 2021 – Mars 2022)	100%	100% * 4.03 milionë (shuma e ILD – së për vitin 5)	4.03	17.79

ILD 1.2 (34,1% e financimit të lidhur me ILD – të), ka lidhje me mundësimin e mirëmbajtjes rutinë, e cila sipas çertifikatave të pagesave, zë 80% të vlerës të kontratave, për çdo vit. Përsëri u desh kohë për të stabilizuar një rregjim të suksesshëm për mirëmbajtjen e bazuar në performancë, por në vitin 2017 (viti 2 i marrëveshjes), janë regjistruar 85% realizim për këtë ILD. Kjo përqindje konstatohet të jetë rritur, duke kaluar 95% në dy vitet e fundit të projektit.

Ky fenomen vendos në pikëpyetje procesin e shkallëzueshmërisë. Veç vitit 2017, shkalla e realizimit 80% në praktikë ka qenë e lehtë për t'u realizuar, duke ju afruar 100% në vitet e fundit.

ILD 1.3	Sistemi i Transparencës Sociale /Mekanizmi i reagimit publik të zhvilluar (viti 1) dhe operacional (viti 2 - 5)	Formula e përlogaritjes të ILD	Shuma e çertifikuar për vitin relevant (milionë Euro)	Shuma kumulative e çertifikuar (milionë Euro)
Viti 1 (Mars – Dhjetor 2017)	100%	100% * 0.375 milionë (shuma e ILD – së për vitin 1)	0.375	0.375
Viti 2 (Janar – Dhjetor 2018)	0%	0% * 0.74 milionë (shuma e ILD – së për vitin 2)	0	0.375

Viti 3 (Janar – Dhjetor 2019)	0%	0% * 0.74 milionë (shuma e ILD – së për vitin 3)	0	0.375
Viti 4 (Janar – Dhjetor 2020)	0%	0% * 0.74 milionë (shuma e ILD – së për vitin 4)	0	0.375
Viti 5 (Janar 2021 – Mars 2022)	(73.33%)	(73.33) * 0.375 milionë (shuma e ILD – së për vitin 5)	0.275	0.650

ILD 1.3 (5,7% e financimit të lidhur me ILD – të), i referohet sistemit të transparencës sociale. Ky sistem nuk ka qenë efektiv dhe nuk është implementuar nga ARRSH. Monitorimi i reagimit të publikut nuk ka qenë i duhuri. Grupi i Menaxhimit të projektit mund t'a ketë implementuar gabim këtë sistem, i cili varet nga seksioni i marrëdhënieve me publikun dhe seksione Në tjera në ARRSH.

ILD 2.1	Mbikqyrje periodike IRAP janë kryer dhe vlerësimi me yje	Formula përlogaritjes të ILD e	Shuma e çertifikuar për vitin rilevant (milionë Euro)	Shuma kumulative e çertifikuar (milionë Euro)
Viti 1 (Mars – Dhjetor 2017)	100%	100% * 0.99 milionë (shuma e ILD – së për vitin 1)	0.99	0.99
Viti 2 (Janar – Dhjetor 2018)	I paaplikuar	I paaplikuar	0	0.99
Viti 3 (Janar – Dhjetor 2019)	I paaplikuar	I paaplikuar	0	0.99
Viti 4 (Janar – Dhjetor 2020)	I paaplikuar	I paaplikuar	0	0.99
Viti 5 (Janar 2021 – Mars 2022)	100%	100% * 1.98 milionë (shuma e ILD – së për vitin 5)	1.98	2.97

ILD 2.1 (5,7% e financimit të lidhur me ILD – të), ka lidhje me përmirësimin e sigurisë rrugore në përgjithësi, e cila matet duke përdorur sistemin e vlerësimit, iRap, nga fillimi deri në fund të projektit. Ky sistem solli të mira të vlefshme, dhe mund të përsëritet çdo 4 – 5 vjet. Hapësira midis sigurisë të rrugëve të automjeteve (me mesatare 2.8 yje nga shkalla 1 - 5) dhe sigurisë të këmbësorëve (2.2 yje) duhet të mbikqyret dhe të ketë përmirësime të menjëhershme.

ILD 2.2	Përfundimi i mbikëqyrjes vjetore (duke përdorur RAMS)/ përgatitja e mirëmbajtjes shumë vjeçare	Formula përlogaritjes të ILD e	Shuma e çertifikuar për vitin rilevant (milionë Euro)	Shuma kumulative e çertifikuar (milionë Euro)
Viti 1 (Mars – Dhjetor 2017)	0%	I paaplikuar	0	0
Viti 2 (Janar – Dhjetor 2018)	0%	I paaplikuar	0	0
Viti 3 (Janar – Dhjetor 2019)	0%	I paaplikuar	0	0
Viti 4 (Janar – Dhjetor 2020)	0%	I paaplikuar	0	0
Viti 5 (Janar 2021 – Mars 2022)	0%	I paaplikuar	0	0

ILD 2.2 (11,4% e financimit të lidhur me ILD – të), ishte menaxhimi i aseteve rrugore, që dështoi për shkak të një serie ngjarjesh, të cilat nuk mund t'i atribuohen vetëm ARRSH – së. Duke qenë se, RAMS – i, ka qenë objektivi kryesor, përqindja e përcaktuar duket të ketë qenë e duhura. Lidhur me këtë ILD nuk janë marrë masa për përmirësim dhe realizim.

ILD 2.3	Niveli i shërbimit të marrëveshjes i firmosur / i ekzekutuar	Formula e përlogaritjes të ILD	Shuma e çertifikuar për vitin relevant (milionë Euro)	Shuma kumulative e çertifikuar (milionë Euro)
Viti 1 (Mars – Dhjetor 2017)	0%	0% * 2.96 milionë (shuma e ILD – së për vitin 1)	0	0
Viti 2 (Janar – Dhjetor 2018)	0%	0% * 2.96 milionë (shuma e ILD – së për vitin 2)	0	0
Viti 3 (Janar – Dhjetor 2019)	0%	0% * 2.96 milionë (shuma e ILD – së për vitin 3)	0	0
Viti 4 (Janar – Dhjetor 2020)	0%	0% * 2.96 milionë (shuma e ILD – së për vitin 4)	0	0
Viti 5 (Janar 2021 – Mars 2022)	0%	0% * 2.96 milionë (shuma e ILD – së për vitin 5)	0	0

ILD 2.3 (5,7% e financimit të lidhur me ILD – të), nuk përshtatet me objektivat e pranuar të projektit. Kjo pikë e ILD – ve, nuk është kuptuar dhe nuk është realizuar nga palët.

Një mjet i ri i Reagimit Publik është krijuar nga IT në ARRSH, në vitin 2017, në fazat e herëshme të projektit. Ky është një aplikacion për përdoruesit, në mënyrë që të merrej reagimi dhe ankesat e popullatës. Më pas këto të dhëna, që mund të vinin përmes e – mail – it, telefonit, korrierit apo dhe platformës e – qeveritare, të procesoheshin, sipas procedurave të aprovuara të ARRSH. Mjete të tilla të bazuara në Sistemin e Transparencës Sociale (STS), kanë për qëllim t'i mundësojnë popullatës lehtësira për të marrë informacion, për të shprehur ankesat, dhe të merret reagimi i saj lidhur me rrjetin rrugor të ARRSH. Ky sistem është përdorur dhe si pikë referimi për performancën, nga katër kontraktorët e me të cilët janë lidhur kontratat.

Sistemi u bë funksional në tetor 2018, por statistikat nuk janë publikuar nga ARRSH në mënyrë sistematike, si dhe raportet e analizat e dala nga ky proces ose janë të papërshtatshme, ose mungojnë. Statistikat mujore shfaqen në ëb-site- n e ARRSH, për periudhën tetor 2018 – shkurt 2020 dhe janar 2021 – mars 2022. Këto raporte nuk i përmbushin kriteret e kërkuara nga ILD – të, si dhe referuar Raportit të Auditit të ILD – ve, sistemi nuk gjeneron më asnjë të dhënë, për shkaqe të pa ditura. Pra si përfundim, **sistemi ekziston, por nuk është funksional**. Komponenti 3. Reforma Sektoriale paraqitet në vlerën 3.95 mln Euro.

Komponenti 4. Menaxhimi i Projektit dhe Auditit paraqiten në vlerën 2.47 mln Euro.

Komponenti 3 dhe 4 konsiderohen si komponentë të cilë nuk kanë pikë krahasimi, dhe si të tilla janë të pamatshme.

Lidhja midis DLI –ve dhe Objektivave të Projektit.

Objektivat e Projektit, sipas përcaktimit të marrëveshjes, shtrihen në dy pika kryesore:

- Mirëmbajtja dhe përmirësimi i sigurisë rrugore, në rrjetin kryesor të rrugëve,
- Përforcimi i qëndrueshëm dhe eficient i menaxhimit të aseteve rrugore, si dhe praktikave të sigurisë, për përfitimin e përdoruesve të rrugëve.

Sa i takon pjesës të parë të objektivave a), **ILD 1.1 dhe 1.2** lidhen me mirëmbajtjen dhe si të tilla, kishin objektin gjendjen e rrugëve. Ishin indikatorit output, më tepër se sa indikatorë të ardhurash. Këto indikatorë masnin punën që ishte bërë, por jo direkt gjendjen e rrugëve. Kjo mund të ishte realizuar duke kryer matjen e ashpërsisë të rrjetit të rrugëve, duke e shprehur në termat e Indeksit Ndërkombëtar të Ashpërsisë (INA). **Asnjë nga këto ILD, nuk shpreh se në cilën masë janë përmirësuar kushtet rrugore, gjatë periudhës të projektit.**

Sa i takon pjesës të dytë të objektivave a), ILD 2.1, vlerësimi me yje Irap, plotësonte në mënyrë të plotë këtë objektiv. Ky sistem rezultoi të ishte plotësisht i dobishëm për përmirësimin e

përgjithshëm të infrastrukturës për të gjitha kategoritë e përdoruesve rrugorë. Por përsëri dhe ky indikator nuk paraqet panoramën e plotë, si psh: numri i aksidenteve u ul apo u rrit, a pati aksidente më rënda, duke qenë se përmirësimi i rrugëve shkaktoi më tepër trafik dhe/ose shpejtësi të shkatuar nga trafiku.

Sa më sipër, **ky indikator është i pjesshëm** dhe në mënyrë që të paraqesë sukses duhet të merret në konsideratë bashkë me indikatorët e tjerë.

Sa i takon pjesës të parë të objektivave b), që kanë të bëjnë me përforcimin e qëndrueshëm dhe eficient të menaxhimit të aseteve rrugore, si mirëmbajtja e vlerave të aseteve rrugore, për përfitimin e përdoruesve. Sa i takon kësaj pike, projekti nuk arriti të sistemonte me sukses, sistemin e bazuar në evidenca, të dizenuar për të patur informacion lidhur me planifikim vjetor të mirëmbajtjes. Planifikimi vazhdoi duke u bazuar në vendimet vjetore, të marra duke analizuar evidencat. Dhe nëse ka patur përmirësim në menaxhimin e aseteve gjatë kësaj periudhe, kjo nuk pasqyrohet nga ILD 2.2, që dështoi të materializohej në digjitalizimin e RAMS.

Sistemi RAMS, duket se ka dështuar për shkak të dështimit të prokurimit, dhe sepse nuk i është kushtuar rëndësia e duhur, ndryshe nga indikatorët e tjerë. Trajnimet që mund të ishin organizuar nga ARRS, mund të kishin rezultuar në kontraktorë të cilët të kishin kuptueshmëri më të lartë lidhur me menaxhimin e sistemit të aseteve.

Sa më sipër kuptohet që ecuria e projektit varet nga qartësimi dhe përcaktimi me detaje të sakta se cilët do të jenë indikatorët, të cilët do të përcaktojnë mbarëvajtjen e projektit.

Përmirësimi i sigurisë të rrjetit paraqitet në sistemin e yjzimit (ILD 2.1). Përmirësimi shprehet në disa seksione të reja ose të përmirësuara. Por ky indikator nuk shpreh qartë dhe gjerësisht nëse përmirësimi ka ndodhur lidhur me: përmirësimin e pikave të zeza të aksidenteve, inspektimet e sigurisë rrugore të cilat do të çonin në implementimin e rekomandimeve për punët korrigjuese, dizenim më i sigurt rrugor për të gjithë përdoruesit e rrjetit rrugor. Etj.

Konkluzione: -Theksimi i rëndësisë të përcaktimit të indikatorëve bazuar në objektivat thelbësorë të projektit. Sa më sipër, as ILD 1.3 dhe as ILD 2.3 nuk kanë përshkruar objektivat kryesore të projektit, dhe mund të konsiderohen si shpërqëndrim i menaxhmentit nga objektivat thelbësore të këtij projekti. Vlerat e disbursuara lidhur me këto ILD, mund të ishin shpenzuar në indikatorë tjerë të rëndësisë të lartë për mirëmbajtjen dhe sigurinë rrugore.

Konceptimi

-Koncepti i kontraktimit për performancën nuk është kuptuar si duhet nga kontraktorët dhe nga ARRS. Ky koncept është një koncept i panjohur për të dyja palët: Kontraktorët presin tu thuhet çfarë të bëjnë, kur dhe si ta bëjnë punën e tyre, ndërsa Klienti (pra ARRS) pret të jetë në gjendje të instruktojë Kontraktorin çfarë të bëjë, si dhe kur.

-Në fillimin e punimeve të kontratave, zakonisht, kontraktorët mund të konstatojnë se nuk kishte staf në terren duke inspektuar, kështu që ata krijuan idenë se askush nuk po monitoronte dhe se nuk duhej bërë ndonjë punim. Kjo gjë shkaktoi problematikë të ashpër në momentin e kontrollit të performancës.

-Çështja e mos kuptimit të konceptit të performancës, duhej të ishte adresuar plotësisht në periudhën para procesit të ofertimit, duke mbajtur disa Workshop – e lidhur me kuptimin dhe pjesëmarrjen, për t'u siguruar që të gjithë ofertuesit të kishin një qasje sa më të përshtatshme lidhur me procesin, implemetimin dhe risqet për çdo fazë.

Për sa më sipër rezultoi:

1. Titulli i Gjetjes:	Mospërmbushja e objektivave sipas kritereve të parashikuara në marrëveshje.
------------------------------	---

<p>Situata:</p>	<p>Nga auditimi rezulton se arritja e realizimit të ILD – ve paraqitet në masën 81%, konkretisht: ILD 1.1, 1.2 dhe 2.1 janë realizuar në 100% të parashikimit, ndërsa ILD 1.3 është realizuar 22%, ILD 2.2, dhe 2.3 është realizuar në 0%.</p> <p>Duke ju referuar qëllimit primar të Projektit rezulton se ILD 1.3 dhe 2.3 rezultojnë se nuk kanë përshkruar objektivat kryesore të projektit, dhe mund të konsiderohen si shpërqëndrim i menaxhmentit nga objektivat thelbësore të këtij projekti. Vlerat e disbursuara lidhur me këto ILD, mund të ishin shpenzuar në indikatorë tjerë të rëndësisë të lartë për mirëmbajtjen dhe sigurinë rrugore.</p> <p>Komponentët 1.1 dhe 1.2, të cilët lidhen me mirëmbajtjen dhe kishin objektiv gjendjen e rrugëve. Në përgjithësi këta indikatorë masnin punën e bërë, por jo direkt gjendjen e rrugëve. Kjo mund të ishte realizuar duke kryer matjen e ashpërsisë të rrjetit të rrugëve, duke e shprehur në termat e Indeksit Ndërkombëtar të Ashpërsisë (INA). Asnjë nga këto ILD, nuk shpreh se në cilën masë janë përmirësuar kushtet rrugore, gjatë periudhës të projektit.</p> <p>Komponentin ILD 2.1, vlerësimi me yje Irap, sistemi rezultoi të ishte i dobishëm për përmirësimin e përgjithshëm të infrastrukturës për të gjitha kategoritë e përdoruesve rrugorë, por dhe ky indikator nuk paraqet panoramën e plotë.</p> <p>Lidhur me komponentin ILD -2.2 vendosja dhe operacionalizimi i RAMS/BMS, Projekti nuk arriti të krijonte sistemin e bazuar në evidenca, të dizenuar për të patur informacion lidhur me planifikim vjetor të mirëmbajtjes. Planifikimi u realizua duke u bazuar në vendimet vjetore, të marra duke analizuar evidencat. Dhe nëse ka patur përmirësim në menaxhimin e aseteve gjatë kësaj periudhe, kjo nuk pasqyrohet nga ILD 2.2, që dështoi të materializohej në digjitalizimin e RAMS.</p> <p>Ecuria e projektit varet nga qartësimi dhe përcaktimi me detaje të sakta se cilët do të jenë indikatorët, të cilët do të përcaktojnë mbarëvajtjen e projektit.</p> <p>-Koncepti i kontraktimit për performancën nuk është kuptuar si duhet nga kontraktorët dhe nga ARRSH. Ky koncept është një koncept i panjohur për të dyja palët: Kontraktorët presin tu thuhet çfarë të bëjnë, kur dhe si ta bëjnë punën e tyre, ndërsa Klienti (pra ARRSH) pret të jetë në gjendje të instruktojë Kontraktorin çfarë të bëjë, si dhe kur.</p>
<p>Kriteri:</p>	<p>Ligji nr. 71, datë 02.07.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” dhe përcaktimet e Manualit të Operacioneve të Projektit.</p>
<p>Ndikimi/Efekti:</p>	<p>Vlerësimi i gjendjes së rrugëve jo i saktë dhe mos krijimi i sistemit të evidencave për gjendjen e tyre.</p>
<p>Rëndësia:</p>	<p>E lartë.</p>
<p>Shkaku:</p>	<p>Mos kuptimi dhe mos përmbushja në kohën e përcaktuar e detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjen e huasë.</p>

Rekomandim:	Nga Autoriteti Rrugor Shqiptar të merren masa që në Projektet e ardhshme të mirë kuptohen nga të gjitha palët pjesëmarrëse dhe të përmbushen në kohë objektivat, duke patur në fokus rezultatin në terren njëkohësisht me atë financiar.
2. Titulli i Gjetjes:	Mos rialokimi i fondeve lidhur me objektivat e parealizuara.
Situata:	<p>Komponenti 1.3 “Zhvillimi dhe operacionalizimi i Sistemit Social të Transparencës/ Reagimi publik – Sistemi i zgjidhjes” është realizuar 22%, ndërsa komponentët 2.2 “Vendosja dhe operacionalizimi i RAMS/BMS”, dhe 2.3 “Niveli i marrëveshjes të shërbimit midis ARRSH dhe MTP” është realizuar në 0%.</p> <p>Nga auditimi rezulton se këta komponentë nuk kanë sjellë përfitime lidhur me qëllimin kryesor të projektit, dhe mund të konsiderohen si shpërqëndrim i menaxhimit nga objektivat thelbësore të këtij projekti. Vlerat e disbursuara lidhur me këto ILD, mund të ishin shpenzuar në indikatorë tjerë të rëndësishëm të lartë për mirëmbajtjen dhe sigurinë rrugore.</p> <p>Në marrëveshje përcaktohet se pas konsultimeve me Huamarrësin dhe duke njoftuar Bankën, mund të përshtaten shumat dhe objektivat e parashikuara për ILD specifike. Ecuria e projektit varet nga qartësimi dhe përcaktimi me detaje të sakta se cilët do të jenë indikatorët, të cilët do të përcaktojnë mbarëvajtjen e projektit.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 71, datë 02.07.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate”, seksioni IV, pika B, 5, “ <i>Banka, pas konsultimeve me Huamarrësin dhe duke e njoftuar atë, mund të përshtatë shumat dhe objektivat e parashikuara në pjesën 4 të kësaj Marrëveshjeje për ILD specifike</i> ”.
Ndikimi/Efekti:	Mosdisbursimi i fondeve për indikatorët sipas marrëveshjes.
Rëndësia:	E lartë.
Shkaku:	Mos kuptimi dhe mos përmbushja në kohën e përcaktuar e detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjen e huasë.
Rekomandim:	Nga Autoriteti Rrugor Shqiptar të merren masa që në Projektet e ardhshme të analizohen komponentët dhe të kryhen ndryshimet e tyre, përkatëse në fillim dhe gjatë fazave të Projektit, dhe rialokimin e fondeve për të sjellë rritjen e cilësisë të realizimit të tyre e kështu arritjen e objektivave të Projektit.

2.3 Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimin e fondeve publike.

Në zbatim të pikës 3 të Programit të Auditimit nr. 827/1 prot., datë 07.10.2022, “Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Dosjet e prokurimit për punimet civile
- 2) Dokumentacionin e subjekteve fituese
- 3) Korrespondenca zyrtare me Bankën Botërore
- 4) Korrespondenca të ndryshme;

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se procedura e konkurrimit për kontratat e punimeve civile ka qenë tender i hapur ndërkombëtar me parakualifikim (ICB) për të cilin kanë shprehur interes 30 OE/BOE të cilët janë s'kualifikuar sipas shkallëve dhe kushteve të udhëzimeve të bankës botërore nga KVO pas shqyrtimit të dokumenteve të parakualifikimit dhe kritereve teknike, duke shpallur fitues operatorët për:

Loti 1, Kontrata A, BOE B..... A.T.E.V.E & G.....

Loti 2 Kontrata B, BOE B..... A.T.E.V.E & G.....

Loti 3, Kontrata C, OE R..... AL-T.... C..... E.....

Loti 4, Kontrata D, BOE E..... C..... S..... A..... (E..... ATEE) & S.....

Me konkretisht procedura është zhvilluar si më poshtë:

Korrespondenca me BB në lidhje me këtë procedure ka qenë e shumtë dhe e shpeshtë kjo lidhur me faktin e llojit të vecantë të kontratës dhe të interesimit të shumë operatorëve ndërkombëtar për procedurën.

Tabela e procedurës së prokurimit për punimet civile:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:		
<p>1. <i>Contract A: North of Albania – Roads in Shkodër & Kukës Regions (276 km), - RRMSP/CŴ/2015/1;</i> 2. <i>Contract B: Central/North East – Roads in Tirana & Dibër Regions (286 km), - RRMSP/CŴ/2015/2;</i> 3. <i>Contract C: Central/South East – Roads in Fier, Elbasan & Korça Regions (419km), - RRMSP/CŴ/2015/3;</i> 4. <i>Contract D: South of Albania –Roads in Vlora & Gjirokastrit Regions - (RRMSP/CŴ/2015/4;</i></p>		
<p>1.Urdhër Prokurimi Nr. 9853 datë 27.11.2015 bazuar në planin e prokurimit</p>	<p>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Consultenti Individual Subash Seth- Prokuruar sipas procedurës se prokurimit për kontrata te vogla (small assignments, time – based payment). Contrat ref nr. CS-14 me emërtimin “<i>Kontrate shërbimi konsulence individuale për përgatitjen e Dokumenteve të Tenderit për projektin e mirëmbajtjes me bazë performancë</i>”. Kontrata datë 23.12.2015</p>	<p>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Sipas Urdhrit, 9853 datë 27.11.2015 1. D.F. (Kryetar) 2. A. H. (Anëtar) 3. K. K. (Anëtar) 4. E. H. (Anëtar) 5. A.Sh. (Anëtare)</p>
<p>2. Procedura e Prokurimit Tender i hapur ndërkombëtar, sipas udhëzuesve te bankës Botërore për prokurimin e pajisjeve, punimeve dhe shërbimeve jo konsulentë për huat nga IBRD dhe Kreditë nga IDA (udhëzuesi i janarit 2011 rishikuar ne Korrik 2014)</p>	<p>6.Oferta fituese (pa TVSh) Kontrata A: 21,205,783.99 euro Kontrata B: 19,205,601.48 euro Kontrata C: 13,531,838.04 Euro Kontrata D: 16,543,350.20 Euro</p>	<p>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh) Në procedurat e Bankës Botërore referuar udhëzuesve të saj për punimet civile nuk ka fond limit të deklaruar në dokumentet e tenderit.</p>
<p>5.Fondi Limit (euro pa TVSh) Përcaktuar nga Konsulenti Subash Seth. Shkresa me nr. 5790 prot, datë 08.07.2016. Kontrata A: 26,029,488 Euro Kontrata B: 23,488,146 Euro Kontrata C: 16,014,826 Euro Kontrata D: 22,044,276 Euro</p>		

<p>8. Data e hapjes së tenderit: 27 nëntor 2015 (Invitation for prequalification) është data kur kompanitë e interesuar duhet të dorëzonin Aplikimin për parakualifikim për Kontrata e mirëmbajtjes dhe sigurisë rrugore. Data e paraqitjes së ofertës financiare të kompanive të parakualifikuara. 7 tetor 2016</p>	<p>9. Burimi Financimit Banka Botërore & Qeveria Shqiptare sipas % të përcaktuara në marrëveshjes se Kredisë</p>	<p>10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në parakualifikim 30-OE/BOE b) S'kualifikuar - 14 c) Parakualifikuar sipas tabelës së mëposhtme (16 OE apo BOE)</p>
<p>b. Zbatimi i Kontratës 1. Contract A: North of Albania – Roads in Shkoder & Kukës Regions (276 km), - RRMSP/CŴ/2015/1; 2. Contract B: Central/North East – Roads in Tirana & Dibër Regions (286 km), - RRMSP/CŴ/2015/2; 3. Contract C: Central/South East – Roads in Fier, Elbasan & Korça Regions (419km), - RRMSP/CŴ/2015/3; 4. Contract D: South of Albania – Roads in Vlora & Gjirokastrë Regions - (RRMSP/CŴ/2015/4;</p>		
<p>11. Lidhja e kontratës 1. Kontrata A - BOE “B..... A.T.E.V.E & G..... ltd” 2. Kontrata B BOE “B..... A.T.E.V.E” & “G..... ltd” 3. Kontrata C R..... AL – T..... C..... E..... 4. Kontrata D BOE “E.....C..... S..... A..... (E.....ATEE)” & “S.....”</p>	<p>12. Vlera e kontratës (me TVSh) Bid Price: 21,749,522.04 Euro Discount: 543,738.05 Euro Vlera 21,205,783.99 Euro Bid Price: 19.698.052.080 Euro Discount: 492,451.32 Euro Vlera 19,205,601.48 Euro Bid Price: 13,950348.49 Euro Discount: 418,510.45 Euro Vlera 13,531,838.04 Euro Bid Price: 16,543,343.40 Euro Correction 6.8 Euro Vlera: 16,543,350.20 Euro</p>	<p>13. Likuiduar deri në fund të Projektit Kontrata A: (me TVSH) 23,448,636.10 euro Kontrata B: 21,120,286.61 euro Kontrata C: 14,816,445.65 Euro Kontrata D: 18,105,480.72 Euro</p>

Subjektet të cilat kanë kaluar fazën e parë të para kualifikimit janë sipas tabelës së mëposhtme:

NR.	EMRI	VENDI
1.	E..... S.A	S.....
2.	V..... I..... I.....sh.p.k	K.....
3.	G..... K..... JH.S.C & “ K..... I..... M..... San Ve tic A.S”, JV	A..... –T.....
4.	R..... AL-T..... C..... E.....	K..... S..... Ar.....
5.	B..... A.T.E.V.E &” G..... LTD”, JV	G.....-A.....
6.	“ G..... & “ Gi.....C..... G.... Ni..... Ltd”, JV	A.....-N.....
7.	V.. Vr.....e in sbnova cest d.d & “Al..... shpk”, JV	S.....-A.....
8.	T.... S..... SPA	I.....
9.	E..... C..... S..... A..... (E..... ATEE) & “ S.....“ sh.p.k, JV	G.....-A.....
10.	“ S..... AG &”T..... sh.p.k & C.....t AD”, JV	A.....-a.-M.....
11.	“ CarenaS.P.A &T.....e S.R.L, JV	I.....
12.	V..... S.P.A	I.....

13.	C..... K..... T..... K..... E..... A..... E.....	G.....
14.	S..... C..... B..... R..... (CBR)	I.....
15.	S..... C..... S.p.a	I.....
16.	"I..... I..... a.d" & "K.....d.d, G....." & "BP M..... d.o.o" IKG	B..... -H.....a-S.....

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Me kërkesë të Bankës Botërore është kërkuar përzgjedhja e një konsulenti individual për hartimin e dokumenteve të Parakualifikimit, dokumenteve të tenderit dhe dokumenteve të kontratës së monitorimit për katër kontratat e mirëmbajtjes me bazë outputi dhe performancë. Është përzgjedhur konsulenti individual Subash Set, përzgjedhja e të cilit është prokuruar sipas procedurës së prokurimit për kontratat e vogla (small assignments, time – based payment), Contract ref nr. CS-14 me emërtimin “*Kontratë shërbimi konsulence individuale për përgatitjen e Dokumenteve të Tenderit për projektin e mirëmbajtjes me bazë performancë*”. Kontrata është lidhur më datë 23.12.2015 pas marrjes së aprovimit nga Banka botërore. Termat e referencës së konsulentit janë aprovuar nga Banka Botërore.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për këtë procedurë, referuar urdhrin nr.9853, datë 27.11.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm përbëhet nga:

1. D..... F..... (Kryetar)
2. A..... H..... (Anëtare)
3. K..... K..... (Anëtar)
4. E..... H..... (Anëtar)
5. A..... Sh..... (Anëtare)

Kriteret teknike për listën e shkurtër kanë qenë:

1. Statusi dhe historiku i kontratave të pa performuara
2. Situata Financiare dhe performanca

Kapaciteti Financiar:

(i) *Aplikanti duhet të vërtetojë se kanë gjendje ose kanë në dispozicion të aktiveve likuide, pasuri të patundshme, linja krediti dhe mjete të tjera financiare (të pavarura nga çdo pagesë paraprake kontraktuale) të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat e rrjedhës së parave të ndërtimit për Kontrata e subjektit neto i aplikantëve, të vlerësuara në një shumë të barabartë të paktën, në si më poshtë:*

Kontrata A 1,600,000 Euro;

Kontrata B 1,600,000 Euro;

Kontrata C 1,500,000 Euro;

Kontrata D 1,500,000 Euro

(ii) *Aplikantët duhet të dëshmojnë gjithashtu se kanë burime të përshtatshme të financave për të përmbushur kërkesat e fluksit të parave për punët që janë aktualisht në zhvillim e sipër dhe për angazhimet e ardhshme të kontratës*

(iii) *Qarkullimi mesatar vjetor i ndërtimeve minimale në një shumë të barabartë, në Euro:*

Kontrata A- 10.000,000

Kontrata B- 9,400,000

Kontrata C- 6,800,000

Kontrata D- 8,800,000

llogaritur si pagesa totale të certifikuara të marra për kontrata në proces dhe / ose të përfunduara brenda pesë (5) viteve të fundit [2010,2011,2012,2013,2014], e ndarë me pesë (5) vjet

3. Eksperienca e përgjithshme në ndërtim: *Përvojë në ndërtimin e rrugëve dhe / ose kontratat e mirëmbajtjes së rrugëve në rolin e kontraktorit kryesor, anëtarit të JV, nënkontraktuesit ose kontraktuesit të menaxhimit për të paktën pesë vitet e fundit, duke filluar nga 1 janari 2010.*

Përvojë specifike në ndërtimin e rrugëve / rehabilitimin e punëve dhe shërbimeve të mirëmbajtjes së rrugëve:

(i) *Një numër minimal i kontratave të ngjashme të specifikuara më poshtë që janë përfunduar në mënyrë të kënaqshme dhe thelbësore si një kontraktues kryesor, anëtar i JV, kontraktues menaxhimi ose nënkontraktues midis janarit 2010 dhe afatit të paraqitjes së aplikimit:*

1 (një) kontratë në lidhje me ndërtimin e rrugëve dhe / ose punimet e rehabilitimit të rrugës dhe / ose punimet e mirëmbajtjes, me vlerë minimale në Euro:

Për Kontratën A: 17,500,000

Për Kontratën B: 11,900,000

Për Kontratën C: 16,500,000

Për Kontratën D: 15,500,000

Në rast se aplikanti synon të bëjë kërkesë për shumë lote, ai duhet të përmbushë kërkesën e përgjithshme për pjesët/kontratat e kombinuara që po aplikon. Në këtë drejtim, Opsioni 3 nën nenin 25.3 b do të aplikohet për vlerësimin e shumë loteve. Për shembull, në rast se aplikanti aplikon për Kontratën A dhe B së bashku, ai duhet të sigurojë prova që ai ka përfunduar, brenda periudhës së kaluar të kërkuar:

(i) *Dy kontrata, një jo më pak se 17.5 milion Euro dhe një jo më pak se 16.5 Euro milion ose (ii) Një kontratë jo më pak se 34 milion Euro, dhe kështu me radhë për kombinime të tjera.*

Eksperienca në aktivitet kyç: Në Asfaltim.

Eksperienca në projektim

Shoqëritë janë përzgjedhur në përputhje me metodën “ICB” “Ofertë Konkurruese Ndërkombëtare” e përcaktuar në Udhëzuesit e Bankës Botërore - Versioni i Janarit të vitit 2011 i rishikuar në korrik 2014. (World Bank’s Guidelines: Procurement of goods, Works and non - consultancy services under IBRD Loans and IDA Credits by World Bank Borrowers dated January 2011 and revised in July 2014.

Për tenderin me objekt “Konsulenti për monitorimin e katër kontratave të mirëmbajtjes me bazë outputi dhe performance” kanë shprehur interes 30 OE ose BOE të cilët kanë marrë pjesë në fazën e para kualifikimit:

Komisioni i Vlerësimit pasi shqyrtoi dokumentet e para kualifikimit dhe kriteret teknike, përzgjodhi shoqëritë sipas short listës së mëposhtme:

No.	Name (clarify if alone or JV)	Country (all countries for JV)	Prequalification Status*				
			Lot 1	Lot 2	Lot 3	Lot 4	Multiple Lots
1	E....., S.A	S.....	FQ	FQ	FQ	FQ	(1 & 2 & 3 & 4) FQ
2	V..... I..... I..... sh.p.k	K.....	-	-	FQ	-	-
3	JV a) “G..... K..... J.S.C” & b) “K..... I.....M.....k San Ve Tic A.S”	A.....- T.....	-	FQ	-	-	-
4	R..... AL-T.....C..... E.....	K..... of S..... A.....	FQ	FQ	FQ	FQ	3 Lots Combine

5	JV a) "B..... A.T.E.V.E" & b) "..... ltd"	G..... - A.....	FQ	FQ	FQ	FQ	(1&3 or 2&3 or 3&4) FQ
6	JV a) "G....." & b) "G.....C... G... N... Ltd"	A.....- N.....	-	FQ	FQ	-	(2&3)FQ
7	JV a) "V..... C..... V..... d.d" & b) "A..... Sh.p.k"	S....a - A.....	FQ	-	FQ	-	(1&3)FQ
8	JV IKG (I.....Inzenjering a.d L..... & K..... d.d & G....., BP M..... d.o.o)	B.... / H.....a - M..... S.....	CQ	CQ	CQ	CQ	-
9.	T..... S.....i SPA	I.....	FQ	FQ	-	-	-
10	JV a) "E..... C..... S..... A.....(E... ATEE)" & b) "S....." SH.p.k	G.....- A.....	-	-	FQ	FQ	(3&4) FQ
11	JV a)"S..... AG" & b) "T..... sh.p.k" & c) "C.....t AD "	A..... - A.....- M.....	FQ	FQ	FQ	FQ	(1 & 2 & 3 & 4) FQ
12	JV "C..... S.P.A. & T..... S.R.L"	I.....- It.....	FQ	-	-	-	-
13	V..... S.P.A	I.....	-	FQ	FQ	-	-
14	S..... Co..... S.P.A	I.....	FQ	FQ	FQ	FQ	(1 & 2 & 3 & 4) FQ
15	CBR - I..... G..... C.....	I.....	FC	-	-	-	-
16	C.....S K..... S.A (T..... K..... E..... A..... E.....)	G.....	D	D	FQ	D	D

Shënim: D – S'kualifikuar, FQ – Kualifikuar plotësisht, CO- Kualifikuar me kusht

Për procesin e Parakualifikimit janë kryer 4 Raporte të cilat i janë dërguar Bankës për miratimin e short-listës së miratuar nga AK sipas shkresave të mëposhtme:

Raporti nr. 1 nëpërmjet shkresë se Drejtorit të Përgjithshëm nr. 2552 datë 06.04.2016

Raporti nr. 2 nëpërmjet shkresë se Drejtorit të Përgjithshëm nr. 3972 datë 20.05.2016

Raporti nr. 3 nëpërmjet shkresë se Drejtorit të Përgjithshëm nr. 5615 datë 01.07.2016

Raporti nr. 4 nëpërmjet shkresë se Drejtorit të Përgjithshëm nr. 6215 datë 22.07.2016

Miratimi nga Banka (*no objection*) është dhënë në datë 14 Korrik 2016

Afati i fundit i pranimit të propozimeve ka qene përcaktuar data: 7 tetor 2016 e cila pas ndryshimit të datës fillestare me aprovim të Bankës Botërore është përcaktuar 16.09.2016. Kompanitë të cilat janë konsideruar të papërshtatshme nga KVO për vlerësim të mëtejshëm janë:

No.	Name (clarify if alone or JV)	Country (all countries for JV)	Prequalification Status *				
			Lot 1	Lot 2	Lot 3	Lot 4	Multiple Lots
15/a	C.....C..... E.....	K.....	D	D	D	D	D
15/b	JV a) "C..... C.....NE....." & b)"A.... B.....G SH.P.K"	K..... - A.....	D	D	D	D	D
16	JV a)"E.....S.R.L" & b) "A..... C..... S.R.L"	-	-	-	D	-
17	S..... T..... E.....G CO. LTD	C.....	D	D	D	D	D

18	C..... S..... ECIT (E..... C..... I..... T.....)	I.....	-	-	D	-	-
19	JV a) "S..... C..... SRL" & b) "C..... C..... SRL"	I.....	D	D	D	D	D
20	T..... C.....	I.....	-	-	-	D	-
21	C..... IN..... S..... VE T..... A.S	Tu.....	D	D	D	D	D
22	J..... SH.P.K	A...a	-	-	-	D	-
23	IM... BA... SRL	I.....	D	D	-	-	-
24	KO... - S... CO... PER A....	I.....	-	D	-	D	-
25	G... L...G...L TR... & CO... CO.W.L.L	K...	-	-	D	-	-
26	JV a) "A... IN...T.. VE TI...T L...D SI...I" & b) "F... L.T.D"	T... - A..	-	-	D	-	-
27	PR...E C...I SPA	I.....	-	-	D	-	-
30	JV a) "M... CO...I" & b) "A.. KO....."	I..... - A...a	-	-	-	D	-

Raporti i fundit i vlerësimit të ofertave i dërguar në bankë tek i cili janë reflektuar komentet dhe sugjerimet e Bankës Botërore për të cilin më pas ajo ka dhënë miratimin është dërguar nëpërmjet shkresës Nr. 662 date 27.01.2017.

Nga raporti i hapjes së propozimit financiar në datë 7 tetor 2016 ofertat ekonomike rezultojnë si vijon:

Table -Bid price

Nr.	Bidders name (single company or JV)	Bid price contract A	Bid price contract B	Bid price contract C	Bid price contract D	Discount
2	E..... SA	23.799.556,14 Euro (VAT not included)	21.955.697,59 Euro (VAT not included)	19.042.273,97 Euro (VAT not included)	22.445.035,3 Euro (VAT not included)	Unconditional 1% for contract A and conditional 0.5% A&B and 0.5 % A&B&C. Unconditional 1% contract B. Unconditional 0,5% A&B or A&B&C&D 0,5 B&C. 0.5% contract B&C, 0.5C&D, 0.5% A&B&C&D, 0.5% C&D, 0.5A&B&C&D
13	V..... i...t I.....onal shpk			13.763,260,30 Euro (VAT not Included)		Not applicable
8	JV G... Konstruktion and "K..... Insaat M..... San ve Tic A.S"		19.122.309,16 Euro (VAT Included)			Not applicable
14	R.... AL- T...k C.....Establishment			11.625.290,41 Euro (VAT not Included)	15.467.271,78 Euro (VAT not Included)	3% contract C 3% contract D
4	JC B..... ATEVE and G..... LTD	21.749.522,04 Euro (VAT Included)	19.698.052,8 Euro (VAT Included)	14.294.364,1 Euro (VAT Included)	20.077.047,6 Euro (VAT Included)	1% Contract A, if we are awarded for any combination of contract under the package of four lots we offer 2.5% discount of the total amount this combination of contracts. 1% contract B, if we are awarded for any combination of contract under the package of four lots we offer 2.5% discount of the total amount of this combination of contracts. 1% contract C, if we are awarded for any combination of contract under the package of four lots we offer 2.5% discount of the total amount of this combination of contracts. 1% contract D if we are awarded for

						any combination of contract under the package of four lots offer 2.5 % discount of the total amount of this combination of contracts.
10	JV and G. Construcione General Nigeria Ltd		23.695.366,90 Euro (VAT not Included)	16.689.162,30 Euro (VAT not Included)		offered and methodology for their application is 13% in the item: rehabilitation Works, improvement Works for contract B. Offered and methodology for their
5	JV C.... SPA and tec.....e Srl	24.628.924,44 Euro (VAT Included)				4% contract A
7	V. SPA		19.012.318.00 Euro (VAT not Included)	14.212.423,00 Euro (VAT not Included)		Not applicable
3	C.....s K..... SA			14.230.610,00 Euro (VAT Included)		Not applicable
	S.....Co..... SPA					
11	CBR -Impresa Generale di Construzioni	32.385.486.70 Euro (VAT Included)				Not applicable
	CONDITIONALLY PREQUALIFIED					
	Jv ikg (Integral Inzenjering a.d Laktasi & Kostak d.d. & Gradis (Bosnia /Herzegovina, BP Maribor d.o.o					Methodology for their application is 13% in the item: Rehabilitation, Works, Improvement, Works for contract C
6	JV Voc C..... V.....e and A.....	19.812.412.06 Euro (VAT not Included)		12.982.931.6 Euro (VAT not Included)		Not applicable
9	Tirrena Scavi SPA	23.925.094.81 Euro (VAT not Included)	21.307.964.87 Euro (VAT not Included)			
	JV E.....nical Commerce and S.....i shpk			12.365.049.97 Euro (VAT not Included)	13.786.119.5 Euro (VAT not Included)	Not applicable
	JV S..... AG, and t.....a shpk, and C.....oraput AD	39.939.420.10 Euro (VAT Included)				Not applicable

Pas unifikimit të ofertave rezulton si më poshtë:

Nr.	Bidders name (single company or JV)	Bid price contract A	Bid price contract B	Bid price contract C	Bid price contract D	Discount
2	E..... SA	23.799.556,14 Euro (VAT not included)	21.955.697,59 Euro (VAT not included)	19.042.273,97 Euro (VAT not included)	22.445.035,3 Euro (VAT not included)	Unconditional 1% for contract A and conditional 0.5% A&B and 0.5 % A&B&C. Unconditional 1% contract B. Unconditional 0,5% A&B or A&B&C&D 0,5 B&C. 0.5% contract B&C, 0.5C&D, 0.5% A&B&C&D, 0.5% C&D, 0.5A&B&C&D
13	V.... i..... L..... shpk			13.763,260,30 Euro (VAT not Included)		Not applicable
8	JV G.... K.....n and "K.... L....at Mu.... Sanve Tic A.S"		15.297.847,13 Euro (VAT not Included)			Not applicable
14	R..... A....k C..... E.....			11.625.290,41 Euro (VAT not Included)	15.467.271,78 Euro (VAT not Included)	3% contract C 3% contract D

4	BOE B..... ATEVE and G..... LTD	17.399.617,63 Euro (VAT not Included)	15.758.442,24 Euro (VAT not Included)	11.435.491,3 Euro (VAT not Included)	16.061.638,08 Euro (VAT not Included)	1% Contract A, if we are awarded for any combination of contract under the package of four lots we offer 2.5% discount of the total amount of this combination of contracts. 1% contract B, if we are awarded for any combination of contract under the package of four lots we offer 2.5% discount of the total amount of this combination of contracts. 1% contract C, if we are awarded for any combination of contract under the package of four lots we offer 2.5% discount of the total amount of this combination of contracts. 1% contract D if we are awarded for any combination of contract under the package of four lots we offer 2.5 % discount of the total amount of this combination of contracts.
10	JV G..... and G..... C..... Ge.....l Ni...a Ltd		23.695.366,90 Euro (VAT not Included)	16.689.162,30 Euro (VAT not Included)		offered and methodology for their application is 13% in the item: rehabilitation Works, improvement Works for contract B. Offered and methodology for their
5	JV C.....a SPA and te..... Srl	20.524.103,7 Euro (VAT not Included)				4% contract A
7	V..... SPA		19.012.318,00 Euro (VAT not Included)	14.212.423,00 Euro (VAT not Included)		Not applicable
3	C..... K.....s SA			11.384.488,00 Euro (VAT not Included)		Not applicable
11	CBR -Im.....a Ge..... di C.....	25.908.389,36 Euro (VAT not Included)				Not applicable
6	JV Voc C..... Vr..... and A.....	19.812.412,06 Euro (VAT not Included)		12.982.931,6 Euro (VAT not Included)		Not applicable
9	T..... S.....i SPA	23.925.094,81 Euro (VAT not Included)	21.307.964,87 Euro (VAT not Included)			
	JV E.....l Commerce and S..... shpk			12.365.049,97 Euro (VAT not Included)	13.786.119,5 Euro (VAT not Included)	Not applicable
	JV S..... AG, and T..... e..... shpk, and C.....t AD	39.939.420,10 Euro (VAT not Included)				Not applicable

Për këtë procedurë bazuar në ofertat e dhëna dhe në mënyrën e llogaritjes së ofertës fituese e cila përlllogaritet për çmimin më të ulët të dhënë për të 4 kontratat në tërësi janë shpallur fitues duke marrë edhe miratimin paraprak të bankës operatorët me ofertën më të ulët të kualifikuar si më poshtë për:

- Loti 1, Kontrata A, BOE B..... A.T.E.V.E & G.....
- Loti 2 Kontrata B, BOE B..... A.T.E.V.E & G.....
- Loti 3, Kontrata C, OE R..... A..... C..... E.....
- Loti 4, Kontrata D, BOE E.... C..... S..... A..... (E. ATEE) & S.....

Për prokurimin e shërbimit të konsulentës u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Plani i prokurimit
- 2) Dosjet e prokurimit për konsulentët

- 3) Dokumentacioni i subjekteve fituese
- 4) Korrespondenca zyrtare me Bankën Botërore

Për shërbimin e konsulencës është zhvilluar procedura e prokurimit me objekt “Konsulenti për Monitorimin e katër kontratave të mirëmbajtjes me bazë outputi dhe performancë”. Lloji i procedurës së përzgjedhur ka qenë tender i hapur ndërkombëtar, sipas procedurës për “Përzgjedhje bazuar në Cilësi dhe Kosto” (Quality and Cost Based Selection QCBS method), ku kanë shprehur interes 26 operatore dhe bashkime operatorësh dhe është shpallur fitues bashkimi i operatorëve IRD Engineering s.r.l. & Sina & Sineco s.r.l.

Me kërkesë të Bankës Botërore është kërkuar përzgjedhja e një konsulenti individual për hartimin e dokumenteve të Parakualifikimit, dokumenteve të tenderit dhe dokumenteve të kontratës së monitorimit për katër kontratat e mirëmbajtjes me bazë outputi dhe performancë, procedurë e cila është prokuruar si kontratë e vogël (small assignments, time – based payment). Contrat ref. nr. CS-14 me emërtimin “Kontratë shërbimi konsulence individuale për përgatitjen e Dokumenteve të Tenderit për projektin e mirëmbajtjes me bazë performancë” dhe ka konkluduar me fitues Konsulentin individual Subash Seth. Kontrata është lidhur me datë 23.12.2015 pas marrjes së aprovimit nga Banka Botërore. Termat e referencës së konsulentit janë aprovuar nga Banka Botërore.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Konsulenti për Monitorimin e katër kontratave të mirëmbajtjes me baze outputi dhe performance”.		
<p>1.Urdhër Prokurimi Nr. 9463 datë 18.11.2015 bazuar në planin e prokurimit</p>	<p>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Consulenti Individual Subash Seth- Prokuruar sipas procedurës se prokurimit për kontrata te vogla (small assignments, time – based payment). Contrat ref nr. CS-14 me emertimin “Kontrate shërbimi konsulence individuale për përgatitjen e Dokumenteve të Tenderit për projektin e mirëmbajtjes me bazë performance. Kontrata date 23.12.2015</p>	<p>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Sipas Urdhrit, 9463 datë 18.11.2015</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. A..... S..... (Kryetar) 2. D..... X..... (Anëtare) 3. A..... H.... (Anëtare) 4. H..... L.....(Anëtar) 5. A..... L..... (Anëtare)
<p>2. Procedura e Prokurimit Tender i hapur ndërkombëtar, sipas procedurës për “Përzgjedhje bazuar në Cilësi dhe Kosto” (Quality and Cost Based Selection QCBS method)</p>		
<p>5.Fondi Limit (pa TVSh) USD është përcaktuar nga Konsulenti Subash Seth.</p>	<p>6.Oferta fituese (pa TVSh) 5,880,360 Euro</p>	<p>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</p>

<p>8. Data e hapjes së tenderit:</p> <p>8 prill 2016 (i janë dërguar kompanive të shortlistuara ftesa për pjesëmarrje).</p> <p>Data e paraqitjes së propozimeve teknike dhe financiare: 23 Maj 2016</p> <p>Shtyrë me Adendum paraqitja e propozimeve në datë 6 qershor 2016 ora 112.00.</p>	<p>9. Burimi Financimit</p> <p>Banka Botërore & Qeveria Shqiptare sipas % të përcaktuara në marrëveshjes së Kredisë</p>	<p>10. Operatoret Ekonomike</p> <p>a) Pjesëmarrës në fazën I - 26 b) S'kualifikuar -, 20 c) Kualifikuar 6</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. TNM L..... – T..... and M..... Ltd (I.....). 2. JV I.....E..... s.r.l. (I.....) (leader), S.....(I.....) (member) and Sineco s.r.l (I.....) member. 3. E.....I.... (F.....). 4. JV H..... I.....I N.V. (N.....) (leader) and M.... M..... L.... (U.....) (member). 5. AIC P..... – P..... C..... di A..... a di I..... S.p.A. (I.....). 6. MMM G.... L.... (C.....)
<p>b. Zbatimi i Kontratës “Konsulenti për Monitorimin e katër kontratave të mirëmbajtjes me baze outputi dhe performance”. Contract ref No CS 1</p>		
<p>11. Lidhja e kontratës Datë 05.12.2016 me nr. prot. 9999</p>	<p>12. Vlera e kontratës (pa TVSh) 4,900,300 Euro + 980,060 Euro (TVSh) = 5,880,360 Euro</p>	<p>13. Likuiduar (Kontrata bazë 5,880,360 euro me TVSH + amendime kontrate 2,280,102 euro me TVSH) <u>8,160,462 euro me TVSH</u></p>

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, referuar Urdhrit, 9463 datë 18.11.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm. përbëhet nga:

1. A..... S..... - (Kryetar)
2. D..... X..... - (Anëtar)
3. A..... H..... - (Anëtar)
4. H..... L..... - (Anëtar)
5. A..... L.... - (Anëtar)

Kriteret teknike për listën e shkurtër kanë qenë:

4. Eksperienca e kompanive në projekte të ngjashme;
5. Mënyra e organizimit dhe kapacitetet e konsulentit
6. Aktiviteti kryesor i biznesit dhe vitet në biznes.

Konsulenti do të përzgjidhet në përputhje me metodën “Përzgjedhje bazuar në Cilësi dhe Kosto” e përcaktuar në Udhëzuesit e Bankës Botërore - Versioni i Janarit të vitit 2011 i rishikuar në korrik 2014. (*World Bank’s Guidelines: Selection and Employment of Consultants [under IBRD Loans and IDA Credits & Grants] by World Bank Borrowers dated January 2011 and revised in July 2014 (“Consultant Guidelines”)*).

Për tenderin me objekt “Konsulenti për Monitorimin e katër kontratave të mirëmbajtjes me bazë outputi dhe performance” kanë shprehur interes 26 shoqëri ose bashkime operatorësh. Komisioni i Vlerësimit pasi shqyrtoi dokumentet e tenderit dhe kriteret teknike, përzgjodhi shoqëritë sipas shortlistës së mëposhtme:

No	Firm/Joint Venture	Nationality
1	T....Limited – T..... and M..... Ltd	(I.....).
2	JV I.. E.... s.r.l. S..... and S..... s.r.l	(I.....) (leader), and (I.....) (member) and (I.....) member.
3	E.....I.....	(F.....).
4	JV H.... I.... N.V and Mot M.... L.....	(N.....s) (leader) and (UK) (member)
5	AIC P..... – P.....C..... di A..... a di In.....S.p.A.	(I.....).
6	M.....M G..... Limited	(C.....)

Për procesin e shortlistimit janë kryer 3 Raporte:

Raporti i është dërguar Bankës nëpërmjet shkresës së Drejtorit të Përgjithshëm me nr. 1386 datë 01.03.2016 dhe miratimi prej saj është marrë në 30 Mars 2016. Pragu minimal i pikëve teknike ka qenë përcaktuar 75 pikë, afati i fundit i pranimit të propozimeve ka qenë 6 Qershor 2016 dhe raporti i vlerësimit i është dërguar bankës nëpërmjet shkresës së Drejtorit të Përgjithshëm me nr. 7989 prot., datë 28.09.2019. Kompanitë që kaluan pragun minimal të pikëve teknike janë:

No	Firm/Joint Venture	Nationality	Technical Points
1	T....Limited – T..... and M..... Ltd	(Is....).	86.15
2	JV I.. E.... s.r.l. S..... and S..... s.r.l	(I.....) (leader), and (I.....) (member) and (I.....) member.	94.71
3	E.... I.....	(F.....).	90.57
4	JV H.... I.... N.V and Mot M.... L.....	(N.....) (leader) and (UK) (member)	89.03
5	AIC P..... – P.....C..... di A..... a di In.....S.p.A.	(I.....).	85.71
6	M.....M G....Limited	(C.....)	81.56

Pas miratimit të short listës nga ana e BB, u është dërguar ftesa OE për dorëzimin e ofertës teknike dhe financiare. Në përfundim të dorëzimit dhe vlerësimit të këtij dokumentacioni, është hartuar Raporti përkatës i vlerësimit me pikë për anën teknike dhe financiare nga ku rezulton si vijon:

Consultants' names	Technical Evaluation			Financial Evaluation		Combined Evaluation	
	Technical scores ^a S(t)	Weighted scores S(t) × T ^b	Technical rank	Financial scores ^c S(f)	Weighted scores S(f) × F ^d	Scores S(t) T + S(f) F	Rank
T....Limited – T..... and M..... Ltd	86.148	68.918	4	63.230	12.646	81.564	5
JV I.. E.... s.r.l. S..... and S..... s.r.l	94.714	75.771	1	79.556	15.911	91.682	1
E.... I.....	90.573	72.458	2	92.997	18.599	91.057	2
JV H.... I.... N.V and Mot M.... L.....	89.031	71.224	3	85.344	17.069	88.293	4
AIC P..... – P.....C..... di A..... a di In.....S.p.A.	85.714	68.571	5	100.000	20.000	88.571	3
M.....M G.... Limited	81.563	65.250	6	59.322	11.864	77.114	6
Award recommendation	To highest combined technical/financial score. Consultant's name: JV I....., E..... s.r.l. & S..... & S..... s.r.l						

Rregullimet - Konvertimi i Valutës, çmimet e Vlerësuara

Consultants' Names	Proposals' prices ^a		Adjustments ^b	Evaluated price(s)	Conversion to currency of evaluation ^c		Financial scores ^d
	Currency	Amounts (1)	(2)	(3) = (1) + (2)	Exchange rate(s) ^e (4)	Proposals' prices (5) = (3)/(4)	
T.....Limited – T..... and M..... Ltd	Euro	6.165.324	(+) 208	6.165.532		6.165.532	63.230
JV I... E..... s.r.l. S..... and S..... s.r.l	Euro	4.900.300	Nil	4.900.300		4.900.300	79.556
E..... I.....	Euro	4.192.050	Nil	4.192.050		4.192.050	92.997
JV H.... I.... N.V and Mot M.... L.....	Euro	4.999.950	(-) 432.000	4,567,950		4,567,950	85.344
AIC P..... – P.....C..... di A..... a di In.....S.p.A.	Euro	3.898.460	Nil	3.898.460		3.898.460	100.000
M....M G..... Limited	Canadian Dollar +	3.636.500	(-)7,329.25	3.629.170.75	1 Euro=1.4551 Canadian Dollar 1 Euro =0.8006 GBP	2,494,104.01 +1,608,257.24 +2,469,308.00 ----- =6,571,669.26	59.322
	Pound (GBP)+	1.287.575	(-)4.25	1.287.570.75			
	Euro	2.469.241	(+) 67	2.469.308.00			

a. Exchange rates 1 Euro = 1.4551 Canadian Dollar, 1 Euro= 0.8006 GBP;
b. Arithmetical errors and omissions of items included in the technical proposals. Adjustments may be positive or negative.
c. As per RFP.
d. 100 points to the lowest evaluated proposal; other scores to be determined in accordance with provisions of RFP.
e. Value of one currency unit in the common currency used for evaluation purposes, normally the local currency (e.g., US\$1 = 30 rupees).
Indicate source as per RFP.

Raporti me klasifikimin si më sipër i është dorëzuar BB sipas shkresës me nr. 8625 prot., datë 20.10.2016 sipas të cilës është kualifikuar i pari dhe shpallur fitues BOE *JV I.... E..... s.r.l. & S..... & S..... s.r.l.* Ky Raport ka marrë edhe *No objection* -in e BB sipas shkresës me nr. 8824 prot., datë 27.10.2016. Pas njoftimit të BOE është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit me nr. 9999 prot., datë 15.12.2016 me vlerë 5,880,360 Euro.

2.4 Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.

Me ligjin nr. 71/2015, (miratuar më 2.07.2015 dhe dekretuar me dekretin nr.9174, datë 14.07.2015 është ratifikuar marrëveshja e huas midis Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka) për projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate”, financuar në shumën e huas 65,900,000 Euro nga Banka dhe në shumën e financimit të Qeverisë Shqiptare 62,570,000 Euro ku totali 128,470,000 Euro. Referuar komunikimeve zyrtare marrëveshja financiare është bërë efektive me datën 25.09.2015 ku dhe disbursimi i parë për tu përdorur për shpenzime të projektit ka qenë në janar të vitit 2016 në shumën 8,244,750.71 Euro . Referuar përcaktimeve në marrëveshje kategoritë e Shpenzimeve të Pranueshme që mund të financohen nga të ardhurat nga Huaja (kategori), ndarjen e shumave të Huas për secilën kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen për shpenzimet e pranueshme në secilën kategori paraqiten si më poshtë vijon:

Kategoria	Shuma e Huas së alokuar (shprehur në euro)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (duke përfshirë taksat)
1. Mallra, punime, shërbime të konsulentëve dhe trajnim për pjesët 1 dhe 2 të Projektit	59,310,000	deri në 50% në përputhje me dispozitat e MFP-së, ndryshuar në 65% me vkm-nr- 468, date 30.07.2021
2. Shërbime të konsulentëve dhe kosto operative për pjesët 3 dhe 4 të Projektit	6,425,250	deri në 84% në përputhje me dispozitat e MFP-së

3. Komisioni i administrimit	164,750	Shuma të pagueshme në përputhje me seksionin 2.03 të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me seksionin 2.07/b të Kushteve të Përgjithshme
4. Tavani i normës së interesit ose prim i normës së interesit brenda një intervali të caktuar	0	Shumë e pagueshme në përputhje me seksionin 2.08/c të kësaj Marrëveshjeje
SHUMA TOTALE	65,900,000	

Në momentin e auditimit të këtij projekti, duke ju referuar shtyrjes të afatit projekti ka përfunduar në 31 Mars 2022. Sa i takon tërheqjes të kredisë (disbursimeve), situata paraqitet si më poshtë:

Numër reference kontrate	Kontraktori	Shuma origjinale e kontrates me TVSH	Shuma rishikuar e kontrates me TVSH	Paguar me TVSH deri më date 31.12.2022	5% që do të paguhet	Shuma totale që do të paguhet me TVSH
Komponenti I pare						
OPRC - A	G....I & B...L...	€ 21,205,783.99	€ 23,448,636.10	€ 22,916,336.97	€ 532,299.13	23,448,636.10
OPRC - B	G....I & B...L...	€ 19,205,601.48	€ 21,120,286.61	€ 21,078,995.25	€ 41,291.36	21,120,286.61
OPRC - C	R.....d	€ 13,531,838.04	€ 14,816,445.65	€ 14,642,527.36	€ 173,918.29	14,816,445.65
OPRC - D	S.....&ELIKA ATEE	€ 16,543,350.20	€ 18,105,480.72	€ 17,898,481.82	€ 206,998.90	18,105,480.72
Monitoring Consultant	IRD	€ 5,880,360.00	€ 8,160,822.00	€ 8,122,109.78	€ 3,886.52	8,125,996.30
Komponenti i dyte						
Mallra per sigurine rrugore	P.... Industries shpk	€ 1,032,000.00	€ 0.00	€ 1,032,000.00	€ 0.00	1,032,000.00
Konsulence per sigurine rrugore	(NTU&E.....)	€ 3,414,600.00	€ 0.00	€ 3,321,006.00	€ 0.00	3,321,006.00
RAMS-konulence per sistemin e inventarizimit te rrugeve	A.....	€ 1,285,544.00	€ 0.00	€ 602,963.00	€ 31,326.67	634,289.67
Ngritja e sistemit RAMS sistemin e inventarizimit te rrugeve	F.....	€ 2,000,124.00	€ 0.00	€ 200,012.40	€ 0.00	200,012.40
Blerje sistemi per PMT	I.....	€ 9,947.00		€ 9,947.00		9,947.00
Komponenti I Trete						
Studimi I fizibilitetit te urave	Politecnica Ingegneria ed Architettura Società Cooperativa	€ 2,112,000.00	€ 422,400.00	€ 369,600.00	€ 52,800.00	422,400.00
Pergatitja e qendres se monitorimit te trafikut	JV T..... C..... E....S.p.a & T..... & M..... L..... NV & I.... SHPK	€ 683,748.00		€ 683,748.00		683,748.00
Komponenti I katert						
Auditi nderkombetra per DLI	NTU	€ 957,960.00		€ 943,205.00	€ 14,755.00	957,960.00
Konsulnte nderkombetar per PMT	N/A	€ 295,874.00		€ 295,874.00		295,874.00
PMU-paga, kosto operative dhe trajnime	N/A	N/A	N/A	1,456,322	N/A	1,456,322.00
Totali		€ 88,158,730.71	€ 86,074,071.08	€ 93,573,128.58	€ 1,057,275.87	€ 94,630,404.45

Sa më sipër, kosto totale e projektit duke përfshirë dhe TVSH është 94,630,404.45 Euro. Diferenca prej 1,057,275.87 Euro e mbetur për t'u paguar deri në datën 29.03.2023, është vlera që do të paguhet në përfundim të garancisë, sipas parashikimeve të marrëveshjes.

Në nenin 2 të marrëveshjes theksohet se:

“2.01 Banka bie dakord t’i japë hua Huamarrësit, sipas afateve dhe kushteve të parashikuara ose të përmendura në këtë Marrëveshje, shumën prej gjashtëdhjetë e pesë milionë e nëntëqind mijë eurosh (€ 65,900,000)....

2.2 Huamarrësi mund të tërheqë fondet e Huas në përputhje me seksionin IV, të pjesës 2, të kësaj Marrëveshjeje.

2.3 Komisioni i administrimit i pagueshëm nga Huamarrësi është i barabartë me një të katërtën e një për qind (0.25%) të shumës së Huas.

2.4 Komisioni i angazhimit i pagueshëm nga Huamarrësi është i barabartë me një të katërtën e një për qind (0.25%) në vit të shumës së Huas gjendje që nuk është tërhequr.”

Referuar Seksionit IV të marrëveshjes së financimit “ Tërheqja e fondeve të Huas” pika B/3 dhe B/4 “ Kushtet e Tërheqjes” Banka bën të mundur realizimin e disbursimeve referuar përcaktimeve në këto rubrika dhe ku mbi të gjitha në pjesën 4 jepen treguesit e lidhur me disbursimet e planifikuara për çdo vit të përcaktuar në pikën 39 dhe 40 të shtojcës së marrëveshjes. Disbursimet e planifikuara nga Banka referuar realizimit të DLI (objektivave) për çdo komponent , paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela e disbursimeve të realizuara gjatë viteve 2016-2022 (pa TVSH)

Data	Monedha	Disbursime	Pa disbursuar	Komisione te paguara	Interes i paguar
31.12.2015	EUR	164,750.00	65,735,250.00	164,750.00	-
31.12.2016	EUR	8,244,750.71	57,490,499.29	-	-
31.12.2017	EUR	-	57,490,499.29	-	-
31.12.2018	EUR	9,980,884.49	47,509,614.80	-	-
31.12.2019	EUR	17,906,369.18	29,603,245.62	-	-
31.12.2020	EUR	7,920,151.80	21,683,093.82	-	-
31.12.2021	EUR	0.00	0.00	-	-
31.12.2022	EUR	12,452,321.70	9,230,772.12	-	-
G.TOTAL	EUR	56,669,227.88		-	-

Referuar tabelës sa më sipër shuma e disbursuar deri më 31 Dhjetor 2022 (nuk ka asnjë disbursim të shumave të kredisë gjatë viteve 2017 dhe 2021) është 56,669,227.88 Euro, ku shuma e pa disbursuar është në nivelin e 9,230,772.12 euro dhe komisioni i paguar (Front End Fee) rezulton shumën prej 164,750 Euro.

Sa më sipër mungesa e disbursimeve për këto vite ka ardhur si pasojë e paaftesisë menaxhuese të tërheqjes të fondeve referuar planifikimit.

- Sa më sipër cituar në nenin 2.4 për shumën e pa tërhequra nga kredia huamarrësi është i detyruar të paguaj komisionin e angazhimit për 0.25 %.

Interesi i angazhimit i paguar krahasuar me atë të planifikuar

Komisioni i angazhimit	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	2020	2021	Shuma euro
Planifikimi	0	122,725	91,125	49,650	18,05	0		263,518

Amendimi i marrëvshjes		122,725	91,125	49,650	18.05	0	263,518
Fakti sipas disbursimit	0	143,726.25	118,774.04	74,008.11	74,008.11	42,877.31	453,393.82
Diferenca (+)	-	21,001.25	27,649.04	24,358.11	73,990.06	42,877.31	189,875.77
%		17.11%	30.34%	49.06%	409.91%		

Si rezultat i mos tërheqjes së kredisë pra mos aftësisë menaxhuese të tërheqjes së disbursimeve referuar planifikimit janë paguar komisione angazhimi deri më 31 Dhjetor 2022 shuma gjithsej 453,393.82 Euro (ose **189,875.77 Euro më shumë**) kundrejt 263,518 Euro që do të paguhej në qofte se do të realizoheshin sipas afateve objektivat e projektit.

*Sa më sipër përgjegjësia për këtë efekt negativ financiar **189,875.77 Euro** për pagesa më shumë të komisioneve të angazhimit bie mbi menaxhimin dhe drejtorët e projektit për periudhën 2016 - 2021 për secilën periudhë drejtimi z. A..... Q....., znj. S.... Q....., z. E..... V...., z. E..... B....., z. E..... N....., z. K.... S.....*

Sa i takon financimit të brendshëm, Projekti përdor një sistem të integruar të planifikimit dhe buxhetimit të Qeverisë Shqiptare. Dokumentet e planifikimit dhe të buxhetimit procedohen përmes Grupit të Menaxhimit të Projektit të ARRSH, dhe nga ARRSH të Ministria e Linjës përgjegjëse për çështjet e transportit duke u bazuar në treguesit tavan të mundësuar nga Ministria e Financave. Grupi i Menaxhimit të Projektit ka respektuar dy fazat e raundeve të aplikimit:

1. Fazën e planifikimit të shpenzimeve dhe investimeve,
2. Fazën e planifikimit afatmesëm dhe të draftimit vjetor të buxhetit.

Pasqyra Nr.3 Aplikimet për tërheqje kësti huaje

Aplikim për tërheqje fondesh	Data	Shuma (Euro)	Lloji	Kategoria e disbursimit	Statusi	
					Disbursuar	Konvertuar në shpenzim të drejtë
Nr. 1	22 Dhjetor 2015	8,244,750.71	Paradhënie në avancë		8,244,750.71	
Nr.2	6 Qershor 2017	120,541.78	Dokumentacioni për paradhënien në avancë	2		120,541.78
Nr.3	30 Gusht 2018	9,980,884.49	Paradhënie në avancë dhe dokumentacion për paradhënie në avancë	1 + 2	0	
		101,732.68				101,732.68
Nr.4	18 Tetor 2019	9,980,884.49	Paradhënie në avancë		9,980,884.49	
Nr.5	Pa informacion	-				
Nr.6	12 Nëntor 2019	17,906,369.18	Paradhënie në avancë dhe dokumentacion për paradhënie në avancë	1 + 2	17,906,369.18	15,097,568.75
Nr.7	23 Tetor 2020	7,920,151.80	Paradhënie në avancë dhe dokumentacion për paradhënie në avancë	1 + 2	7,920,151.80	10,543,274.89
Nr.8	25 Janar 2022	12,452,321.70	Paradhënie në avancë dhe dokumentacion për paradhënie në avancë	1 + 2	12,452,321.70	7,265,411.00
Totali në 30.07.2022					56,504,477.88	33,128,529.1

Burimi: Raporti i auditimit të ILD -ve

Gjatë periudhës të audituar, tërheqja numër 8, është dorëzuar në 25.01.2022, si më poshtë:

-Dokumentacioni për paradhënie në avancë lidhur me shpenzimet e pranueshme lidhur me Komponentët 1 dhe 2, për vlerën 7,200,485 Euro, si dhe Komponentët 3 dhe 4 për vlerën 64,926 Euro, që në total bëjnë vlerën 7,264,411 Euro.

-Një paradhënie e cila do të dokumentohet më vonë në vlerën 5,186,9100 Euro.

Sa i takon rregullshmërisë të faturës dhe rishikimit të saj, fondet e kredisë nga Banka Botërore janë mundësuar menjëherë, në llogarinë bankare të hapur me këtë qëllim në Bankën Credins. Fondi total i kredisë rezulton në vlerën 56.5 milionë Euro, nga të cilat afërsisht 33.1 milionë Euro janë dokumentuar dhe pranuar si shpenzime të pranueshme. Ky fond nga auditimi i ILD – ve konstatohet të jetë i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm për të mbuluar pjesën e parashikuar që do të financohej me kredi nga Banka Botërore.

Sa i takon afateve të aplikimit, nga ana e ARRSH është ndjekur një model i rregullt që konsiston në në aplikime njëherë në vit, për vitet 2019, 2020 dhe 2021, dhe pse për vitin 2022 dorëzimi është bërë në Janar 2022.

Financime të brendshme.

Projekti ka përdorur sistemin e integruar të planifikimit dhe buxhetimit të Qeverisë Shqiptare. Dokumentet e planifikimit dhe buxhetimit të Projektit janë proceduar përmes Grupit të Menaxhimit Të Projektit dhe ARRSH, dhe nga ARRSH te Ministria e Linjës përgjegjëse për çështje të transportit duke u bazuar në indikatorët tavan të Ministrisë së Financave. Grupi i Menaxhimit të Projektit ka respektuar dy fazat e raundeve të aplikimit:

1. Fazën e planifikimit të shpenzimeve dhe investimeve,
2. Fazën e planifikimit afatmesëm dhe të draftimit vjetor të buxhetit.

Pasqyra e mëposhtme tregon aplikimet e bëra për financim nga qeveria Shqiptare për periudhën 2016 - 2022:

Aplikime për financim nga Qeveria Shqiptare

Viti	Aplikimet finale të ARRSH për financim nga Qeveria Shqiptare		Fondi i miratuar nga Qeveria Shqiptare/Ministria e Financave			Fondi i Disbursuar nga Qeveria Shqiptare/Ministria e Financave
	Data	Shuma (milionë Lekë)	Data	Shuma (milionë Lekë)	Shuma (milionë Lekë)	Shuma (milionë Lekë)
2016		-	-	-	-	0,31
2017	23.08.2016	1,385	27.02.2017	1,196	8,30	2,73
2018	31.08.2017	1,060	26.03.2018 01.08.2018 21.12.2018	1,225 (Finale)	9,73	9,58
2019	04.05.2018 Gusht/Dhjetor 2018	1,263 1,427	08.04.2019	1,413	11,60	9,10
2020	Gusht/Dhjetor 2019	2,217	Mars 2020	1,341	10,60	9,81
2021	Dhjetor 2020	2,045	Mars 2021	1,142	11,86	10,37
2022	Dhjetor 2021	562	Mars 2022	352	2,98	-

Burimi: Raporti i ILD –ve

Sa i takon aplikimeve të ARRSH për fonde nga Qeveria për periudhën 2021 – 2022, shuma e kërkuar është 16.5 milionë Euro dhe ajo e aprovuar rezulton të jetë 14.8 milionë Euro. Duke u bazuar në progresin e Projektit për vitin 2021, buxheti i disbursuar nga Qeveria është 10.37 milionë Euro. Kjo vlerë konsiderohet e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e çertifikuara dhe

detyrimet deri në fund të vitit. Vlera e disbursuar për vitin 2022, konkretisht 2.98 milionë Euro, është përdorur për të mbuluar pagesat e caktuara kryesisht për gjysmën e parë të vitit 2022.

Probleme në lidhje me ekzistencën dhe çeljen e fondeve ka pasur dhe me pjesën e financimit nga Qeveria Shqiptare.

Sa i takon afateve të alokimit nga buxheti i shtetit, konstatohet se problematika konsiston në aprovimin e fondeve për çdo vit. Në fillim të çdo viti (psh në Janar), ARRSH – së i kërkohet të konfirmojë përsëri me Ministrinë e Financave lidhur me vlerën vjetore të buxhetit për vitin korrent. Dhe pse mund të ketë ndryshime, përsëri buxheti i aprovuar nuk është i disponueshëm për ARRSH – në, para periudhës Mars – Prill. Një pjesë e konsiderueshme e kësaj vlere shkon për pagesat e mbetura pezull nga viti paraardhës, dhe pjesa tjetër përdoret për pagesat e gjysmës të parë të vitit aktual. Në muajt Korrik/Gusht përsëri kërkohet nga ARRSH – ja konfirmimi ose përditësimi i vlerës për vitin korrent. Ndërkohë që kjo konsiderohet si diçka pozitive duke qenë se mundëson mirë përcaktimin e vlerës të nevojshme, ana negative qëndron në faktin se nga Shtatori në vazhdim ka patur mungesë fondesh. Për pasojë, Projekti vazhdimisht ka patur riskun lidhur me pjesën e financiar nga Qeveria, duke qenë se kjo pjesë e Projektit nuk ka qenë e disponueshme në çerekun e parë dhe të fundit për çdo vit financiar. Shmangia e këtyre problematikave përgjithësisht ka ardhur si rezultat i mbulimit në 65% të financimit nga Banka Botërore.

Tabela e Kostove Lokale dhe TVSH të realizuar nga Projekti deri në datën 31.12.2022

Kontrata	Realizuar nga Projekti deri me 31.12.2022, monedha Euro	
	Kosto Lokale	TVSH
Loti 1 Kontrata A	6,572,324	3,826,921
Loti 2 Kontrata B	6,816,170	3,511,325
Loti 3 Kontrata C	4,546,273	2,440,354
Loti 4 Kontrata D	5,798,707	2,964,429
Konsulentit monitorues	2,544,650	1,347,870
Totali	26,278,125	14,090,899

Sa sipër rezulton se për Lotin 1 – Kontrata A Kosto Lokale janë paguar në vlerën 6,572,324 Euro dhe TVSH 3,826,921 Euro.

Loti 2 – Kontrata B Kosto Lokale janë paguar në vlerën 6,816,170 Euro dhe TVSH 3,511,325 Euro.

Loti 3– Kontrata C Kosto Lokale janë paguar në vlerën 4,546,273 Euro dhe TVSH 2,440,354 Euro.

Loti 4 – Kontrata D Kosto Lokale janë paguar në vlerën 5,798,707 Euro dhe TVSH 2,964,429 Euro.

Lidhur me Konsulentin Monitorues Kosto Lokale janë paguar në vlerën 2,544,650 Euro dhe TVSH 1,347,870 Euro.

Pra në total Kostot Lokale të projektit paraqiten në vlerën 26,278,125 Euro dhe TVSH – ja paraqitet në 14,090,899 Euro.

Për mos korrektësinë në pagesa si dhe mos realizim të tyre, nga kontraktorët janë paraqitur njoftime referuar neneve dhe të drejtave të përcaktuara në kontratë.

a. Nga operatori “G.....” shpk për Kontratën A Loti 1 me dokumentin hyrje në ARRSH me nr. 4896, datë 21.5.2019 “Vonesa për pagesat e situacioneve të aprovuara për kontratën A ku referuar neneve, klauzolës 50.1 dhe 58.2 njofton për aplikimin e normave të interesave.

Gjithashtu ky kontraktor ka njoftuar me dokumentin hyrës në ARRSH me nr.9191, datë 14.10.2019 “pagesa të vonuara për certifikata pagese të përkohshme” duke paraqitur dhe një

llogaritje totale të pagesës së interesit për vonesat në pagesa të situacioneve (IPC). Referuar pasqyrës së paraqitur për penalitete të llogaritura për pagesa me vonesë rezultojnë të llogaritura penalitete për të gjithë periudhën e vitit 2017 ,2018 dhe 2019.

b. Nga operatori “G.....” shpk për Kontratën B Loti 2 me dokumentin hyrje në ARRSH me nr. 9200, datë 14.10.2019 “Pagesa të vonuara për certifikata pagese të përkohshme” për kontratën B ku referuar neneve, klauzolës 50.1 dhe 58.2 njofton për aplikimin e normave të interesave duke paraqitur dhe një llogaritje totale të pagesës së interesit për vonesat në pagesa të situacioneve (IPC). Referuar pasqyrës së paraqitur për penalitete të llogaritura për pagesa me vonesë rezultojnë të llogaritura penalitete për të gjithë periudhën e vitit 2017,2018 dhe 2019.

c. Nga operatori JV E.... ATEE & S..... L.t.d për kontratën D Loti 4 me dokumentet hyrëse me nr.3086, datë 1.04.2019 , nr.5287, datë 30.05.2019, janë kërkuar pagesat për ditë vonesë të rezultuara nga situacionet e Dhjetorit 2018 dhe të shkurtit 2019 të cilat nuk janë paguar deri më maj të 2019.

-Me dokumentin hyrës në ARRSH me nr.8676, datë 24.09.2019 “ Vonesa në pagesat e faturave” për situacionet 26 deri në 30.

- Me dokumentin hyrës në ARRSH me nr.9131, datë 10.10.2019 “ Njoftim për ngadalësimin e punimeve” si rezultat e vonesave në pagesa për situacionet 26 deri në 30 si dhe llogaritur pretendimet për pagesë për ditë vonesat (claim).

- Me dokumentin hyrës në ARRSH me nr. 9293, datë 15.10.2019, përsëritja e njoftimit për ngadalësim të punimeve .

-Me shkresën nr. 7483 prot, datë 01.08.2019 ARRSH i drejtohet International Centre for ADR, me kërkesë për caktimin e një eksperti për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Kjo kërkesë është bërë pas dakordësimit me operatorët “B..... A.T.E.V.E” DHE “G..... LTD”, ku taksa prej 5,000 Dollarë do të paguhet nga të dyja palët.

-Me shkresën nr.10732 prot, datë 22.11.2019 ARRSH i drejtohet z. C..... A..... M..... ku konfirmohet përzgjedhja e tij si ekspert i zgjidhjes të mosmarrëveshjeve dhe kërkohet prej tij kosto e shërbimit dhe drafti i marrëveshjes mes palëve.

-Me shkresën nr. 1706 prot, datë 25.02.2020 nga Banka Botërore vjen konfirmimi pa komente lidhur me kontraktimin e ekspertit për zgjidhjen e marrëveshjeve.

-Me shkresat nr. 7620 prot, datë 12.10.2020 (Kontrata A), nr. 7621 prot, datë 12.10.2020 (Kontrata B), nr. 7622 prot, datë 12.10.2020 (Kontrata D), dhe nr. 76203prot, datë 12.10.2020 (Kontrata C), janë lidhur kontratat me ekspertin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve z. C.... A.... M.....

-Vlera e paguar lidhur me këtë ekspert rezulton 1,875 Dollarë në datën 06.04.2021.

-Me shkresën hyrëse në ARRSH nr. 5628 prot, datë 07.06.2021, nga “B..... A.T.E.V.E” DHE “G..... LTD” është shprehur mos dakordësimi lidhur me kontratën A dhe B.

-Menaxheri i projektit z. K..... S.... me shkresën nr. 9469 prot, datë 20.10.2021, i drejtohet Drejtorisë Juridike dhe të Përputhshmërisë të Standardeve lidhur me nisjen e procedurave të arbitrazhit për mosmarrëveshjen nr. 2, kontratat A dhe B.

-Me shkresën nr. 9469/1 prot, datë 26.10.2021 nga Drejtoria Juridike dhe e Përputhshmërisë, kërkohet plotësimi i praktikës sa më sipër nga ana e Njësisë të Menaxhimit të Projektit.

-Me shkresën nr. 1350/1 prot, datë 24.02.2022 nga Menaxheri i Projektit, drejtuar Drejtorisë Juridike dhe të Përputhshmërisë të Standardeve, vendosen në dijeni lidhur me vlerat e kërkuara nga operatorët, konkretisht:

-pagesa shtesë për Urdhër Ndryshimin A06 të kontratës A, dhe Urdhër Ndryshimin B05 të kontratës b, në vlerat 206,000 Euro dhe 15,248 Euro.

-interesa lidhur me vonesat për kontratat A dhe B respektivisht në vlerat 82,181.85 Euro dhe 145,946.24 Euro,

-pagesa e kontraktorit për punimet e anuluar për kontratat A dhe B, në vlerat 56,366.01 Euro dhe 142,239.84 Euro.

-Me shkresën 5334/1 prot, datë 16.05.2022 nga Menaxheri i Projektit bëhet me dije Drejtoria Juridike dhe e Përputhshmërisë lidhur me njoftimin se nga ana e kontraktorit G..... SHPK do të nisë procedura gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës të Parë, Tiranë.

Sa më sipër, vlera 647,952 Euro, përbën një *shpenzim pa ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet për buxhetin e shtetit deri në këtë fazë të ankesës së kontraktorit.*

Sa më sipër për mosmenaxhim të situatës në lidhje me kryerjen në kohë të pagesave brenda afatit 28 të miratimit të situacionit nga dita e paraqitur mban përgjegjësi z. E.... N..... për periudhën e vitit 2017 deri shkurt 2018 dhe z.K.... S.... për periudhën në vijim. Për mos likuidim të situacioneve si rezultat i mungesës së fondeve të IBRD gjatë vitit 2019 mbajnë përgjegjësi referuar periudhës si dhe funksioneve në MFP z. K..... S.....a dhe znj.E.... A.....j.

Mbi zbatimin e afateve në likuidimin e pagesave

Nga grupi i auditimi është kryer kontroll me zgjedhje të pagesave për kontratat e punimeve dhe të konsulentëve dhe nga ky auditim ka rezultuar se në urdhrat e pagesave (si të fondeve të IBRD ashtu dhe të fondeve të Qeverisë Shqiptare vendosej bashkëlidhur i gjithë dokumentacioni i përcaktuar në manualin e funksionimit të projektit (MFP). U auditua verifikimi i shumave në urdhrat e pagesës konform shumave të miratuara në situacion, faturë tatimore dhe urdhrin e drejtorit të projektit për pagesë si dhe kurset e këmbimit për TVSH (me datën e faturës konform dokumentit bashkëlidhur të kursit të Bankës së Shqipërisë si dhe kursin e këmbimit preferencial të bankës Credins për pagesat e kostos lokale në Euro në ditën e kalimit të transfertës). Nga ky auditim nuk rezultuan devijacione.

Nga auditimi ka rezultuar se ka raste të vonesave në përgatitjen e dokumentit të autorizimit të faturës dhe kërkesës së pagesës, dokument i cili konfirmohet nga menaxheri i projektit krahasuar me datën e faturës apo dhe datën e konfirmimit të situacionit nga menaxheri si më poshtë vijon:

Loti 1 Kontrata A operator JV “B..... A.T.E.V.E & G..... ”shpk

-Vlera e interesit për këtë kontratë është përlllogaritur 65,732.21 Euro, për vonesat në situacionet: 1 – 17, 21 – 24, 26 - 33, dhe 35.

Loti 2 Kontrata B operator JV “B..... A.T.E.V.E & G..... ” shpk

-Vlera e interesit për këtë kontratë është përlllogaritur 100,329.22 Euro, për vonesat në situacionet: 1 – 17, dhe 23 – 32.

Bazuar në përlllogaritjet finale nga ana e ARRSH, ku përfshihen interesat që duhet të paguhet nga fondet e kredisë dhe fondeve të Qeverisë Shqiptare për të dyja kontratat A + B, vlera totale e interesave për t’u paguar është **235,766.06 Euro** (ARRSH 69,704.63 Euro dhe IBRD 166,061.43 Euro).

Veprimet sa më sipër bien në kundërshtim me klauzolën GC 49.2 dhe 50.1 të kontratave të lidhura ku pagesa duhet të bëhet mbas 28 ditësh , ku citohet:

“49.2. Menaxheri i Projektit kontrollon deklaratën mujore të Kontraktuesit dhe vërteton brenda Katërmbëdhjetë (14) ditësh shumën që duhet t’i paguhet Kontraktori. 50.1. Pagesat do të rregullohen për zbritjet për pagesa paraprake, mbajtje, dhe ulje për të mos arritur Standardet e Performancës për Shërbimet e mirëmbajtjes. Punëdhënësi do t’i paguajë Kontraktuesit shuma të vërtetuara nga Menaxheri i Projektit në përputhje me GC Klauzola 49, brenda njëzet e tetë (28) ditëve nga data e secilit certifikatë. Nëse punëdhënësi bën një pagesë të

vonuar, nga Kontraktuesi do të do të paguhet interesi për pagesën e vonuar në pagesën tjetër. Interesi do të llogariten nga data në të cilën pagesa duhet të kishte qenë efektive.”

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi z.K.....S..... dhe z.E.... N..... për periudhën respektive.

Nga auditimi i raportimit të disbursimeve rezultoi se raportimet për disbursimet dhe shpenzimet janë dorëzuar progresivisht në Ministrinë e Financave për periudhën e vitit 2016, 2017, 2020, 2021 dhe janë kryer në përputhje me VKM nr. 116, datë 24.02.1997 “Për kompetencat, procedurat, nënshkrimin, livrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe udhëzimin nr. 8, datë 17.02.2003 të MF “Për kompetencat, procedurat, nënshkrimin, livrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe ndihmave të huaja që i jepen Republikës së Shqipërisë”.

Ndërsa për vitin 2018 dhe 10 mujorin e vitit 2019 nga Projekti nuk na u vu në dispozicion asnjë raportim zyrtar i paraqitur në Ministri të Financave. Pozicioni i Menaxherit Financiar i projektit ka shkëputur marrëdhëniet e punës më 16 Korrik të vitit 2019 dhe zëvendësimi i këtij pozicioni është bërë në Tetor të vitit 2019.

Sa më sipër mban përgjegjësi znj. E.... A..., për detyrimin dhe për afatet e dorëzimit të raporteve të disbursimeve në Ministri të Financave në kundërshtim me VKM nr. 116, datë 24.02.1997 dhe udhëzimin nr. 8, datë 17.02.2003 të MF.

Gjithashtu u krye verifikimi i dorëzimit të pasqyrave financiare për vitet respektive të zbatimit të projektit nga ku rezultoi:

Me shkresën nr.2426, datë 29.03.2017” Mbi depozitimin e llogarive vjetore të Projekteve me financim të huaj për periudhën 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2016 Drejtuar Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, Drejtuar Ministrisë së Financave janë depozituar pasqyrat financiare të vitit 2016. Referuar informacionit bashkëlidhur pasqyrave financiare rezulton se Pasqyrat financiare të vitit 2016 përfshijnë dhe veprimet e vitit 2015 nga bërja efektive e marrëveshjes financiare të projektit (ashtu si përcaktohet dhe në marrëveshje). Pasqyrat Financiare të vitit 2016 janë dorëzuar brenda afatit, pasqyrojnë treguesit e vitit paraardhës 2015, janë shoqëruar me relacionin shpjegues, plotësimin e pyetësorit pjesë e formatit të miratuar të pasqyrave financiare si dhe raportimet e çdo muaji për sigurimet shoqërore, shëndetësore, dhe TAP, për stafin e zbatimit të projektit.

Për vitin 2017 pasqyrat financiare janë paraqitur në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministri të Financave me shkresën 2138, datë 16.03.2018 brenda afateve dhe bashkëlidhur përmban plotësimin e pyetësorit dhe raportin shoqëruar të plotësimit të pasqyrave financiare. Këto pasqyra janë të konfirmuara nga Nëpunësi Zbatues dhe Nëpunësi Autorizues.

Për vitin 2018 janë dorëzuar me emailin e datë 20.11.2019 nga Menaxheri Financiar.

Për vitin 2019 janë dorëzuar me emailin e datë 04.08.2020 nga Menaxheri Financiar.

Për vitin 2020 janë dorëzuar me emailin e datë 13.02.2020 nga Menaxheri Financiar.

Për vitin 2021 janë dorëzuar me email e datës 24.02.2021 nga menaxher Financiar.

-Referuar përcaktimeve në marrëveshjen e miratuar me ligjin 71/2015 në seksionin II pika B “ Menaxhimi Financiar, raportet financiare dhe kontrollat financiare përcaktohet sa më poshtë vijon: “1. Huamarrësi, nëpërmjet MTI-së siguron se ARRSH-ja mban ose merr masa për mbajtjen e një sistemi të menaxhimit financiar në përputhje me dispozitat e seksionit 5.09 të Kushteve të Përgjithshme.

2. Huamarrësi, nëpërmjet MTI-së siguron se ARRSH-ja përgatit dhe i paraqet Bankës jo më vonë se dyzet e pesë ditë pas përfundimit të çdo semestri kalendarik raportet financiare paraprake të pakontrolluara (RFP) për Projektin që mbulon semestrin, në formë dhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën.

3. Huamarrësi nëpërmjet MTI-së siguron se Pasqyrat Financiare të ARRSH-së kontrollohen në përputhje me dispozitat e seksionit 5.09/b të Kushteve të Përgjithshme. Çdo kontroll financiar i pasqyrave financiare mbulon periudhën e një viti fiskal të Huamarrësit. Pasqyrat financiare të kontrolluara për çdo

periudhë të tillë duhet t'i paraqiten Bankës jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të kësaj periudhe.”

Sa mësipër kërkuar në marrëveshje theksojmë se a. Nga ana e projektit është instaluar program “Alfa PMR” i kontraktuar cili siguron mbajtjen e një sistemi financiar konform kërkesave dhe raportimeve të pranuar dhe dakordësuara nga Banka.

b. Nga ana e ARRSH janë përgatitur për çdo semestër (çdo 6 mujor) Raportet Financiare paraprake të pakontrolluara.

Raportet financiare janë paraqitur për periudhat si më poshtë vijon:

Dy raporte për vitin 2016 dorëzuar më 28 tetor 2016 dhe 14 shkurt 2017 të konfirmuara nga BB

Dy raporte për vitin 2017 raporti i gjashtë mujorit të dytë dorëzuar me vonesë si rezultat i disa problemeve të sistemit në lidhje me raportet e nxjerra nga përdorimi i kurseve të këmbimit, etj., të cilat kanë marrë zgjidhje hap pas hapi nga kontraktori IMB (Instituti i Modelimeve në Biznes).

Dy raporte për vitin 2018 i pari me protokoll 17.10.2018 dhe për semestrin e dytë na është vënë në dispozicion raporti i dytë i konfirmuar po pa datën e dërgimit dhe raportimit të tij në Bankën Botërore dhe konfirmimi prej saj të këtyre raporteve .

Për vitin 2019 janë dorëzuar me emailin e datë 13.02.2020 dhe 04.08.2020 nga Menaxheri Financiar.

Për vitin 2020 janë dorëzuar me emailin e datë 24.02.2021 dhe 18.08.2021 nga Menaxheri Financiar.

Për vitin 2021 janë dorëzuar me email e datës 15.02.2022 dhe 22.08.2022 nga Menaxheri Financiar.

Për vitin 2020 janë dorëzuar me email e datës 23.02.2023 nga Menaxheri Financiar.

Sa mësipër kërkuar për afatet e raportimit të RFP në marrëveshje të cilat janë jo më vonë se dyzet e pesë ditë pas përfundimit të çdo semestri kalendarik, rezulton se janë shkelur këto afate për 6 mujorin e parë të vitit 2016 dhe vitin 2018.

1. Titulli i gjetjes:	Pagesa e komisionit të angazhimit më tepër se parashikimi në Marrëveshjen Financiare.
Situata:	Termat e marrëveshjes në këtë Projekt përcaktojnë se komisioni i angazhimit i pagueshëm nga Huamarrësi për çdo vlerë e cila rezulton e pa tërhequr është i barabartë me një të katërtën e një për qind (0.25%) në vit të shumës së Huas gjendje. Nëse objektivat e Projektit do të ishin realizuar sipas afatëve të përcaktuara në marrëveshje komisioni i angazhimit do të paguhej në vlerën 263,518 Euro. Nga auditimi rezulton se vlera e paguar për këtë komision deri në datën 31 dhjetor 2022 është 453,393.82 Euro. Diferenca midis vlerës të parashikuar dhe asaj të paguar rezulton në vlerën 189,875.77 Euro dhe konsiderohet <i>shpenzim pa ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet për buxhetin e shoqërisë.</i>
Kriteri:	Ligji nr. 71, datë 02.07.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” Neni 2.5 “Komisioni i angazhimit i pagueshëm nga Huamarrësi është i barabartë me një të katërtën e një për qind (0.25%) në vit të shumës së Huas gjendje që nuk është tërhequr”.
Ndikimi/Efekti:	Efekt financiar negativ në shumën prej 189,875.77 Euro.

Shkaku:	Mos tërheqja e fondeve të kredisë në afatet e përcaktuara në marrëveshje.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga Autoriteti Rrugor Shqiptar të merren masa që në Projektet e ardhshme të përmbushen në kohë të gjitha përcaktimet e marrëveshjeve financiare, në mënyrë që të shmangen të gjitha efektet e mundshme financiare që rrjedhin nga këto vonesa në afate.

2. Titulli i gjetjes:	Vonesat në pagesën e situacioneve.
Situata:	<p>Nga auditimi i situacioneve ka rezultuar se ka raste të vonesave në përgatitjen e dokumentit të autorizimit të faturës dhe kërkesës së pagesës, dokument i cili konfirmohet nga menaxheri i projektit krahasuar me datën e faturës apo dhe datën e konfirmimit të situacionit nga menaxheri. Për Lotin 1, Kontrata A me operator JV “B..... A.T.E.V.E & G.....” shpk situacionet me vonesa janë: 1 – 17, 21 – 24, 26 - 33, dhe 35. Për Lotin 2, Kontrata B me operator JV “B..... A.T.E.V.E & G.....” shpk situacionet me vonesa janë: 1 – 17, dhe 23 – 32.</p> <p>Për shkak të vonesave lidhur me pagesat e këtyre situacioneve, midis ARRSH dhe operatorëve “B..... A.T.E.V.E” DHE “G..... LTD” kanë lindur mosmarrëveshje, për të cilat palët kanë dakordësuar t’i drejtohen International Centre for ADR, ku me shkresën e ARRSH nr. 7483 prot, datë 01.08.2019, kërkohet caktimi i një eksperti për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.</p> <p>Me shkresën nr.10732 prot, datë 22.11.2019 ARRSH i drejtohet z. C.... A... M.... ku konfirmohet përzgjedhja e tij si ekspert i zgjidhjes të mosmarrëveshjeve dhe kërkohet prej tij kosto e shërbimit dhe drafti i marrëveshjes mes palëve.</p> <p>Kontraktimi i këtij eksperti është konfirmuar pa komente nga Banka Botërore me shkresën nr. 1706 prot, datë 25.02.2020.</p> <p>-Me shkresat nr. 7620 prot, datë 12.10.2020 (Kontrata A), nr. 7621 prot, datë 12.10.2020 (Kontrata B), nr. 7622 prot, datë 12.10.2020 (Kontrata D), dhe nr. 76203prot, datë 12.10.2020 (Kontrata C), janë lidhur kontratat me ekspertin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve z. C. A.M.</p> <p>Pavarësisht bisedimeve mes palëve dhe ekspertit, me shkresën hyrëse në ARRSH nr.5628 prot, datë 07.06.2021, nga “B.... A.T.E.V.E” DHE “G..... LTD” është shprehur mos dakordësimi lidhur me kontratën A dhe B.</p> <p>-Me shkresën nr. 1350/1 prot, datë 24.02.2022 nga Menaxheri i Projektit, drejtuar Drejtorisë Juridike dhe të Përputhshmërisë të Standardeve, vendosen në dijeni lidhur me vlerat e kërkuara nga operatorët, konkretisht:</p> <p>-pagesa shtesë për Urdhër Ndryshimin A06 të kontratës A, dhe Urdhër Ndryshimin B05 të kontratës b, në vlerat 206,000 Euro dhe 15,248 Euro.</p> <p>-interesa lidhur me vonesat për kontratat A dhe B respektivisht në vlerat 82,181.85 Euro dhe 145,946.24 Euro,</p> <p>-pagesa e kontraktorit për punimet e anuluar për kontratat A dhe B, në vlerat 56,366.01 Euro dhe 142,239.84 Euro.</p>

	Sa më sipër, vlera 647,952 Euro, përbën një dëm ekonomik i mundshëm në disfavor të ARRSH.
Kriteri:	Mos zbatimi i ligjin nr. 71/2015, për projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate”. - Kontratat A dhe B, klauzola 50 “Pagesat” pika 50.1 <i>“Punëdhënësi duhet të paguaj kontraktorin në vlerën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit në përputhje me Kushtet e Përgjithshme klauzola 49, brenda 28 ditëve e çdo certifikate. Në qoftë se punëdhënësi bën një pagësë me vonesë, kontraktorit do ti paguhen interesa për vonesa në pagesën tjetër. Interesat do të llogariten nga data në të cilën duhej të kryhej kjo pagesë....”</i>
Ndikimi/Efekt:	Dëm i mundshëm ekonomik në vlerën 647,952 Euro.
Shkaku:	Mos zbatim i afateve të pagesave të përcaktuara në MFP dhe kontratë.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga ana e Autoritetit Rrugor Shqiptar të merren masa që në Projektet e ardhshme të ndiqen me përgjegjësi të procedurat e pagesave të situacioneve, të zbatohen afatet e përcaktuara lidhur me pagesat, duke shmangur procedurat gjyqësore të cilat do të sillnin për pasojë humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

2.5 Mbi lidhjen dhe zbatimin e kontratave të mallrave, shërbimeve dhe realizimin e punimeve civile.

Kontratat e punimeve civile janë të bazuara në rezultate dhe performancë e cila do të thotë që pa arritur rezultatet e kushteve të kërkuara të rrugëve nuk mund të ketë një performancë të mirë dhe një siguri rrugore sipas standarteve të kërkuara. Në këtë projekt kontratat e punimeve civile janë të tipit "Kontratë rruge bazuar në rezultate dhe performance" e cila është një kontratë e ngjashme me ato të tipit DBMOT FIDIC, "Projektim, ndërtim, mirëmbajtje, operim dhe transferim". Kontraktori ofron një çmim "lump-sum" të fiksuar për të sjellë rrugën në një nivel të caktuar shërbimi dhe për ta mirëmbajtur atë në këtë nivel për një periudhë të caktuar relativisht të gjatë. Zbatimi i kontratës ndahet në katër kategori shërbimi:

1. Shërbimet e performancës së rrjetit (Punimet rutinë të mirëmbajtjes dhe Shërbimet) Shërbimet e performancës së rrjetit përfshijnë: (i) Punët rutinë të mirëmbajtjes të cilat përbëhen nga të gjitha ndërhyrjet në rrugët që do të kryhen rregullisht nga Kontraktori për të arritur dhe mirëmbajtur Nivelet e përcaktuara të Shërbimit (LoS) për rrugët e përfshira në kontratë dhe (ii) të gjitha aktivitetet e tjera të lidhura për menaxhimin dhe monitorimin e rrjetit rrugor sipas kontratës, gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj. (*Network Performance Services (Routine Maintenance Works and Services) Network Performance Services include: (i) Routine Maintenance Works which consist of all interventions on the Roads that are to be carried out on a regular basis by the Contractor to attain and maintain the defined Service Levels (LoS) for the roads included under the contract and (ii) all other activities related to the management and monitoring of the road network under contract, throughout the entire contract duration.*)

2. Punime Rehabilitimi e cila ndahet në dy komponent a) zëvendësimi i shtresës së asfaltit të dëmtuar (*Capital Pavement Work*) dhe b) Punime të rehabilituese të rrugës pa përfshirë shtresën e tapetit (*Road Works Other than Pavement*). Për të dy komponentët e mësipërm çmimi njësi është për km. Punimet rehabilituese kryhen sipas Specifikimeve Teknike (ST) të kontratës të rishikuara me ndryshimet (4 amendmet) e saj, seksioni B Përshkrimi i shërbimeve që duhet të ofrohen

“Description of Services to be Provided”, B 1.1 Lloji i punës dhe shërbimi që duhet të kryhet (implementohet) “Type of Work and Services to be Implemented”, si më poshtë;

a) Punime rehabilitimi (shtresat), të cilat janë të nevojshme, për të sjellë shtresat e rrugës në standardet e paracaktuara. Ato përfshijnë ndërhyrje në nivele të ndryshme të shtresave (nën-baza, baza, nivelimin dhe shtresa përfundimtare, tapeti) dhe në disa raste mund të përfshijnë edhe ndërhyrje në shtresat e themelit (mbushjet e rrugës). (*“Rehabilitation Works (pavement) which are needed to bring the road pavement to pre-defined standards. They include interventions on the various layers of the pavement (sub-base, base course, levelling and finishing layers) and may in some cases also include interventions on foundation layers”*)

b) Punime rehabilitimi (përveç shtresave) të cilat janë të nevojshme për të sjellë rrugën në standardet e paracaktuara. Punimet rehabilituese, pa shtresat e rrugës, përfshijnë punime nga rrëshqitjet, çarjet, dranazhet (pusetat e kunetave, tubat e kunetave dhe të pusetave), muret mbajtëse, urat (mbrojtëset dhe nyjet e bashkimit), sinjalistika e rrugës (tabelat, vijëzimet, tabelat udhëzuese dhe ndriçimi), etj. (*Rehabilitation Works (other than pavement) which are needed to bring the road to the pre –defined standards. Non-pavement rehabilitation Works include Works on embankments, cuts, drainage (box culverts, pipe culverts and manholes), retaining walls, bridges (guardrails and expansion joints), road furniture (road signs, marking, guidance post and lighting), etc.*)

3. Punime Emergjente janë për rehabilitimin e rrugëve të cilat bëhen të nevojshme pasi dëmtimi ka ndodhur përgjithësisht për shkak të fenomeneve natyrore të paparashikueshme kryhen sipas Specifikimeve Teknike të kontratës të rishikuara me ndryshimet (4 amendmet) e saj, seksioni B Përshkrimi i shërbimeve që duhet të ofrohen “Description of Services to be Provided”, B 1.1 Lloji i punës dhe shërbimi që duhet të kryhet (implementohet) “Type of work and Services to be Implemented”. (*Emergency Works which become necessary to reinstate the Roads after damage has occurred generally because of unforeseeable natural phenomena.*)

4. Punimet përmirësuese të përcaktuara në këtë kontratë janë kryesisht për përmirësimin e sigurisë rrugore. Ato përfshijnë sigurinë përmirësime në pikat e zeza të identifikuar përmes një Auditimi të Pavarur të Sigurisë Rrugore (i kryer në 2014) dhe aktivitete të tjera që kërkohen për përmirësimin e sigurisë rrugore në përputhje me rregullat dhe standardet ekzistuese. (*Improvement Works defined under this contract are mainly to improve road safety. They include safety improvements to black spots identified through an Independent Road Safety Audit (carried out in 2014) and other activities that are required for improving the road safety in accordance with the prevailing standards.*)

Për realizimin punëve civile të këtij projekti janë lidhur katër kontrata të ndara sipas rajoneve të vendit dhe konkretisht:

Kontrata A, Nr.511/1 datë 23.01.2017 me referencë RRMSP/CW/2015/1 për rrugët bazuar në output dhe performancë (Loti 1) për Rajonin Shkodër –Kukës (Shqipëria Veriore) e lidhur midis Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSh) dhe BOE B..... A.T.E.V.E & G..... Ltd me vlerë të kontratës 21,205,783.99 Euro me TVSH dhe me aplikim zbritje 2.5%.

Kontrata B, Nr.511/2 datë 23.01.2017 me referencë RRMSP/CW/2015/2 për rrugët bazuar në output dhe performancë (Loti 2) për Rajonin Tiranë –Dibër (Shqipëria Qendrore/Veri Lindore) e lidhur midis Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSh) dhe BOE B..... A.T.E.V.E & G..... Ltd.

Kontrata C, Nr.1475 datë 23.02.2017 me referencë RRMSP/CW/2015/3 për rrugët bazuar në output dhe performancë (Loti 3) për Rajonin Fier-Elbasan Korçë (Shqipëria Qendrore/Jugore/

Lindore) e lidhur midis Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSh) dhe OE “R..... Al-T....C..... E.....” me vlerë të kontratës 13,531,838.01 Euro me TVSH dhe me aplikim zbritje 3%.

Kontrata D, Nr.549/1 datë 24.01.2017 me referencë RRMS/CW/2015/3 për rrugët bazuar në output dhe performancë (Loti 4) për Rajonin Vlorë-Gjirokastrë (Shqipëria Jugore) e lidhur midis Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSh) dhe BOE “E..... C..... S.... A..... (Elika ATTE) & S..... sh.p.k” me vlerë të kontratës 16,543,350.20 Euro me TVSH.

Kontratat e zbatimit.

Kontratat e zbatimit të mirëmbajtjes dhe punimeve të rehabilitimit dhe emergjente janë ndryshuar me katër amendamete, për të gjitha lotet, kontratat A,B,C dhe D konkretisht:

1. Amendimi Nr.1 datë 16.03.2018 është nënshkruar midis kontraktorëve dhe ARrSh përfaqësuar nga z. A..... Q..... Nga ana e të gjitha palëve, ky amendament është konsideruar i rëndësishëm bazuar në Planin e Veprimit përgatitur dhe dakortësuar në Dhjetor 2017 midis ARrSh, Bankës Botërore, Kontraktorëve dhe Konsulentit Monitorues, i cili bëri të mundur eliminimin e mundësisë së dështimit të projektit. Në Kushtet e Veçanta të Kontratës (*The Particular Conditions*) janë bërë ndryshimet si më poshtë ku ARrSh dhe kontraktorët kanë rënë dakort që:

i. Shtrirja dhe shkalla e Punëve të Rehabilitimit të përcaktuara për disa seksione rrugore në kontratë janë të pamjaftueshme për të arritur Nivelet e Shërbimit me të cilat kërkohet që Kontraktori të respektojë në ato seksione rrugore. ARrSH dhe kontraktori bien dakord se nevojiten punime të ndryshme rehabilitimi në raste të tilla, të cilat kërkojnë gjithashtu Specifikime të ndryshme dhe kohë të ndryshme për përfundimin. (*The scope and scale of Rehabilitation Works stipulated for some road sections in the Contract are insufficient to achieve the Service Levels which the Contractor is required to comply with on those road sections. ARA and the contractor agree that more and different Rehabilitation Works are needed in such cases, which also require different Specifications and different times for completion.*)

Në këtë pikë theksohet se disa seksione rrugore të parashikuara në kontratë që të kryhet rehabilitimi i tyre volumi i punimeve është i pa mjaftueshëm për të arritur nivelin e kërkuar. Nga auditimi i dokumentacionit vrehet se, asnjë nga kontraktorët nuk ka filluar të kryej punime rehabilituese dhe përmirësuese përgjatë vitit të parë të kontratës, për ato seksione ku shkalla dhe shtrirja e tyre ka qenë e mjaftueshme në ofertën e paraqitur. Në minutat e takimit të parë për fillimin e punimeve Lideri i Konsulentit Monitorues (TL-MC) ka informuar kontraktorët se projektet lidhur me punimet rehabilituese duhet të dërgohen sa më shpejt të jetë e mundur. Kontraktorët kanë informuar se disa rrugë nuk kanë patur investime për një kohë të gjatë dhe volumi i punimeve për rehabilitimin e tyre është i pa mjaftueshëm si dhe në disa segmente rrugore janë duke u kryer investime nga projekte të tjera. Në grafikun e punimeve të paraqitur në dokumentat e tenderit kontraktorët i kanë parashikuar që punimet rehabilituese dhe përmirësuese, referuar klauzolës *Particular Conditions (PC) Clause 39.1* e Kushteve të Veçanta të Kontratës (KVK) klauzola 39.1, afati i përfundimit është 12 muaj. Pra, mos realizimi i punimeve rehabilituese, për seksionet ku shkalla dhe shtrirja e tyre ka qenë e mjaftueshme në ofertën e kontraktorëve është në kundërshtim me KVK klauzola 39.1 të kontratave. Ndryshimi i afatit për përfundimin e punimeve rehabilituese dhe përmirësuese në 25 muaj nga data e lidhjes së kontratës është bërë në amendamentin nr.2 datë 16.03.2018 kjo pasi ka kaluar afati i tyre sipas kontratës bazë.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi Drejtorët e Përgjithshëm të ARrSh-së, Menaxheri i Projektit si dhe Konsulentit Monitorues sipas afateve të ushtrimit të funksionit në periudhën 1 vit nga fillimi i zbatimit të kontratave.

ii. Teksti i Specifikimeve ka mungesë të qartësisë, përfshin kontradikta dhe përsëritje, si dhe dispozita joreale, duke rezultuar në vështirësi në zbatimin e kontratës. (*The text of the*

Specifications lacks clarity, includes contradictions and repetitions, and unrealistic provisions, resulting in difficulties in implementing the Contract.)

iii. Sqarimet e dhëna ofertuesve gjatë procesit të tenderimit përfshijnë deklarata të cilat janë në kundërshtim me njëra-tjetrën dhe me pjesë të tjera të kontratës. *(The Clarifications provided to bidders during the bidding process include statements which are in contradiction with each other and with other parts of the Contract.)*

Referuar pikave ii) dhe iii), të dakortësuara në këtë amendament, konstatohet se: specifikimet teknike të hartuara dhe sqarimet e dhëna gjatë procesit të tenderimit nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe ekspertëve të BB nuk kanë qenë në përputhje me objektivat e kontratave si dhe mungesë qartësie të tyre. Për problematikat e hasura në specifikimet teknike, në pikën B të këtij amendamenti, është dakortësuar rishikimi i tyre të cilat do të zëvendësojnë ato origjinale të kontratës.

Në varësi të ndryshimit të specifikimeve teknike janë ndryshuar dhe klauzolat 47.2 dhe 47.3 për punimet rehabilituese dhe përmirësuese ku në ofertën fillestare ishin lump sum dhe gjatë zbatimit të saj do të paguhen si punime të matshme. Gjithashtu afati përfundimit të punimeve rehabilituese është ndryshuar, KVK klauzola 39.1, *(Ishte: Koha për përfundimin e punimeve Rehabilituese dhe Përmirësuese është 12 muaj nga data e firmosjes së kontratës. Bëhet: Koha për përfundimin e punimeve Rehabilituese dhe Përmirësuese është 25 muaj nga data e firmosjes së kontratës, përveç rasteve kur është e përcaktuar një kohë e ndryshme përfundimi në urdhër ndryshim ose urdhër punimi për të tilla punime.*

Ndryshimi i kryer në klauzolat 47.2, 47.3 ku punimet e rehabilitim/përmirësim do të jenë të matshme si dhe shtesa në klauzolën 39.1, ku thuhet: *“përveç rasteve kur është e përcaktuar një kohë e ndryshme përfundimi në urdhër ndryshim ose urdhër punimi për të tilla punime”*, shmang penalitetet për vonesa ndaj kontraktorit të përcaktuara në klauzolën 39.3 të Kushteve të Veçanta të Kontratës për punimet që kryehen pas afatit 25 muaj të dakortësuar në këtë amendament.

Duhet theksuar se, Amendamenti nr. 1 është nënshkruar midis palëve pas afatit 12 muaj ku duhet të kishin përfunduar punimet e rehabilitimit dhe përmirësimit të seksioneve të rrugëve të përcaktuara në kontratë, por siç është theksuar edhe më lartë nuk është kryer asnjë punim rehabilitimi dhe përmirësimi në të gjitha kontratat. Nisur nga fakti se punimet rehabilituese dhe përmirësuese nuk kanë përfunduar brenda afatit 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës dhe ndryshimi i këtij afati është bërë pas përfundimit të tij AK dhe MC nuk kanë aplikuar penalitete pasi kanë qenë në negociata të vazhdueshme për sqarimin e mospërputhjeve në DST.

Në pikën 1.1.2 *Punime rehabilitimi* të specifikimeve teknike të kontratës bazë si dhe dokumentet e tenderit është përcaktuar qartë se kontraktori ofertën e tij duhet ta jepte bazuar në një inspektim dhe vlerësim të detajuar të situatës për të përcaktuar vlerën e ofertës në varësi të kushteve dhe nevojës konkrete për punime rehabilitimi dhe përmirësimi për të arritur nivelin e kërkuar të shërbimit të rrugëve. Oferta e dhënë nga kontraktorët është datë 07.10.2016 dhe kontratat janë lidhur në fillim të vitit 2017 afërsisht 5 muaj nga dhënie e ofertës. Segmentet rrugore të vlerësuara për ndërhyrje punimesh rehabilitimi në këtë periudhë 5 mujore nuk mund të kenë patur shumë ndryshime. Pavarësisht kësaj kontraktorëve ju është dashur një vit nga lidhja e kontratës për të verifikuar kushtet dhe nevojat për punime rehabilituese e cila është e pa justifikueshme pasi janë përzgjedhur si operatorë ekonomik me përvojë në mirëmbajtjen e rrugëve bazuar në rezultate dhe performancë. Pra kontraktorët gjatë vitit të parë të kontratës kanë kryer punime vetëm mirëmbajtje në terren dhe të përqëndruar për rishimin e specifikimeve teknike. Me dakortësimet e bërë në amendamentin nr.1 si dhe rishikimi i specifikimeve teknike bënë që mënyra e zhvillimit dhe

zbatimit të projektit të ndryshojë tërësisht nga ai bazë i paraqitur në dokumentat standarte të tenderit mbi të cilat OE kanë paraqitur ofertat ekonomike.

1. Titulli i Gjetjes:	Hartimi i termave të referencës jo në përputhje me kushtet dhe gjendjen aktuale të rrugëve.
Situata:	Me Amendamentin Nr.1 është dakortësuar që: i. Shtrirja dhe shkalla e Punëve të Rehabilitimit të përcaktuara për disa seksione rrugore në kontratë janë të pamjaftueshme për të arritur Nivelet e Shërbimit me të cilat kërkohet që Kontraktori të respektojë në ato seksione rrugore. ii. Teksti i Specifikimeve ka mungesë të qartësisë, përfshin kontradikta dhe përsëritje, si dhe dispozita joreale, duke rezultuar në vështirësi në zbatimin e kontratës. iii. Sqarimet e dhëna ofertuesve gjatë procesit të tenderimit përfshijnë deklarata të cilat janë në kundërshtim me njëra-tjetrën dhe me pjesë të tjera të kontratës. Referuar pikave ii) dhe iii), të dakortësuar në këtë amendament, konstatohet se: specifikimet teknike të hartuara dhe sqarimet e dhëna gjatë procesit të tenderimit nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe ekspertëve të BB nuk kanë qenë në përputhje me objektivat e kontratave si dhe mungesë qartësie të tyre. Për problematikat e hasura në specifikimet teknike, në pikën B të këtij amendamenti, është dakortësuar rishikimi i tyre të cilat do të zëvendësojnë ato origjinale të kontratës. Mospërshtatja e kushteve të kontratës dhe specifikimeve teknike është edhe si rezultat i mungesës së experiencës pasi kjo lloj kontrate implementohet për herë të parë dhe nga koha e hartimit të tyre ka kaluar një kohë relativisht e gjatë. Këto ndryshime kanë rezultuar në implementimin e kontratave sipas një metode hibride dhe jo sipas asaj të projektuar në DST. Gjithashtu janë përfshirë rrugë që kanë pasur nevojë për një rehabilitim total dhe referuar gjendjes së tyre gjatë procesit të mirëmbajtjes nuk mund të arrihej niveli i kërkuar i shërbimit.
Kriteri:	Dokumentat standarte të tenderit, ToR dhe Specifikimet teknike.
Ndikimi/Efekti:	Vonesa në realizimin e punimeve rehabilituese dhe përmirësuese.
Rëndësia:	E lartë.
Shkaku:	Termet e referencës dhe specifikimet teknike jo në përputhje me kushtet aktuale të rrugëve.
Rekomandim:	ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që termet e referencës dhe specifikimet teknike për projektet me financim të huaj të jenë në përputhje me kushtet aktuale të gjendjes së rrugëve me qëllim ofrimin e shërbimit me cilësi dhe siguri.

2. Amendimi Nr.2 datë 12.11.2018 është nënshkruar midis kontraktorëve dhe ARrSh përfaqësuar nga z. A..... Q..... i cili është si rezultat i ndryshimeve thelbësore të dakortësuar në amendimin nr.1 dhe ndryshimit të specifikimeve teknike. Në amendamentin nr.2 specifikimet e rishikuara dhe disa KVK janë ndryshuar ose shtuar si të cilat janë të lidhura me njëra tjetrën. Konkretisht ky amendament zëvendëson disa Kushte të Përgjithshme të Kontratës si: masat e menaxhimit të kontratës së bashku me vlerën e penaliteteve të tyre; urdhrat e punës dhe afatet e përfundimit të tyre; certifikatat e marrjes në dorëzim; sqarime për raportimet mujore të performancës; testet e materialeve dhe sqarime të termave inxhinerike.

Për të patur rezultate sa më të mira në menaxhimin e kontratës, në seksionin e specifikimeve pjesa 2 të cilat janë pjesë e DST, është seksioni 6.1 Masat e performancës menaxheriale (*Management Performance Measures*) MPM e cila pasqyron aftësinë e kontraktorit për të menaxhuar me sukses rezultatet e kontratës duke përfshirë cilësinë dhe efikasitetin e raportimit të tij të informacionit tek punëdhënësi. Për çdo raportim dhe pasqyrim të dhënash tek punëdhënësi nga kontraktori që nuk përputhen me afatet e kërkuara në kontratë janë vendosur penalitete për çdo ditë vonesë përtej këtyre afateve. Masa e Penaliteteve për MPM janë të pasqyruara në DST, për çdo çështje, (Aneksi VII Reduktim i Pagesave për MPM, OPM, RDPM) të specifikimeve pjesa 2 të hartuara nga konsulenti i BB dhe AK kanë qenë kriter mbi bazën e të cilit të gjithë operatorët ekonomik kanë dhënë ofertën e tyre ekonomike.

Në këtë amendament ndryshimi më i rëndësishëm është reduktimi i penaliteteve për MPM. Nga auditimi i dokumentacionit, të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, nuk gjenden gjurmë ku të sqarohet se mbi çfarë reference ose studim është bazuar ky ndryshim duke zvogëluar ndjeshëm vlerën e penaliteteve të MPM. Tabela e mëposhtme tregon ndryshimet e vlerës së penaliteteve për MPM.

A: Tabela B-7 (Niveli i Shërbimit për masat e performancës menaxheriale) dhe tabela F.1 në aneksin VII (Reduktimi i pagesave për MPM) të specifikimeve teknike fillestare janë fshirë dhe janë zëvendësuar me tabelën bashkëlidhur amendamentit 2 në trajtën e aneksit 1.

Nryshimet e kryera pasqyrohen në tabelën më poshtë:

Specifikimet fillestare			Amendamenti		
Kodi	Artikulli	Cmimi-njesi (Leke)	Kodi	Artikulli	Cmimi-njesi (euro)
MPM-1	Grafiku i organizimit	140 000 Për Ditë/vonesë	fshire		
MPM-2	Plani i Sigurimit te Cilesise OAP	140 000 Për Ditë/vonesë	MPM1	OAP	75 Për Ditë/vonesë
MPM-2.1	Plani i Sherbimit ne Dimer	140 000 Për Ditë/vonesë	MPM2	Plani i Sherbimit ne Dimer	75 Për Ditë/vonesë
MPM-2.2	Plan specifik i menaxhimit te trafikut	140 000 Për Ditë/vonesë	fshire		
MPM-3	Performanca e programit	140 000 Për Ditë/vonesë	MPM-3	performanca e programit	75 Për Ditë/vonesë
MPM-3.1	Program pune vietor	140 000 Për Ditë/vonesë	fshire		
MPM-4	Raporti i kushteve fillestare te projektit dhe raporti I perditimit te inventarit te aseteve	140 000 Për Ditë/vonesë	MPM-4.1	Raporti i kushteve fillestare te projektit	75 Për Ditë/vonesë
			MPM-4.2	Raporti i perditimit te inventarit te aseteve	75 Për Ditë/vonesë
MPM-5	Dorezimi projektit	140 000 Për Ditë/vonesë	MPM-5	Dorezimi projektit	75 Për Ditë/vonesë
MPM-6	Masat e performances mujore, raportet mujore	140 000 Për Ditë/vonesë	MPM-6	Raporte Mujore Progressive	1000 Për Ditë/vonesë
MPM-7	Raporte Mujore Progressive	140 000 Për Ditë/vonesë	MPM-7	Raporti i defekteve te aseteve rrugore dhe incidenteve emergjente	75 Për Ditë/vonesë

MPM-8 Kaluar MPM-7	Raporti i defekteve te asetëve rrugore dhe incidenteve emergjente	140 000 Për Ditë/vonesë	MPM-8	Raporti i dorezimit dhe Perfundimi Kontrates	75 Për Ditë/vonesë
MPM-9 Kaluar MPM-8	Raporti i dorezimit dhe Perfundimi Kontrates	350 000 Për Ditë/vonesë	MPM-9	Profili i ashpërsisë së rruges	75 Për Ditë/vonesë
MPM-10 Fshirë	Mbajtja e rekordeve te korrespondences	35 000 Për Ditë/vonesë	MPM-10	Profili i fortësisë së rruges	75 Për Ditë/vonesë

Në panelitet e ndryshuara në amendamentin nr.2, aneksi VII, është fshirë MPM-1 dhe kemi një renditje të re. Janë shtuar MPM-9 e cila konsiston profilin e ashpërsinë dhe valëzimit të rrugës (IRI) dhe MPM-10 ku konsiston në profilin e fortësisë së rrugës (FWD). MPM-9 dhe MPM-10 janë të lidhura me disa MPM të tjera pasi ato janë të rëndësishme në hartimin e projekteve për rrugët që rehabilitohen dhe pjesë përbërëse e raportit përfundimtar të kontratës.

Sipas kushteve të kontratës, gjatë zbatimit të saj nga ana e MC janë aplikuar penalitete për Masat e Performancës së Menaxhimit (MPM), Masat e Performancës së Operimit (OPM), penalitete sipas klauzolës 57.2 (Kushtet e veçanta) si dhe Likuidim Dëmsh (LD). Penalitetet për OPM janë aplikuar sipas kontratës fillestare dhe nuk janë ndryshuar.

Referuar reduktimit të pagesave të penaliteteve për MPM në amendamentin nr.2, aneksi 1 për mos plotësimin e kushteve të kontratës për menaxhimin e performances së saj janë aplikuar penalitete sipas këtij ndryshimi. Penalitetet e mbajtura si më poshtë për secilën kontratë:

Nr.	Kontrata	Totali i penaliteteve OPM+MPM+LD (Euro)	Penalitete OPM (Euro)	Penalitete MPM (Euro)	Penalitete (Likuidim dëmsh+PC 57.2) (Euro)	Penalitete MPM sipas kontratës Fillestare (Lekë)
1	A	226,177.78	129,625.42	76,097	20,455.36	123,620,000
2	B	411,815.46	289,326.35	47,072	75,417.11	62,580,000
3	C	467,631.61	237,824.40	162,300.00	67,507.21	197,400,000
4	D	335,176.85	196,652.50	93,750.00	44,774.35	100,156,000
5	Shuma	1,440,801.70	853,428.67	379,219.00	208,154.03	483,656,000

Në Amendamentin nr.2 pika C thuhet: Teksti në nën-paragrafin 1) brenda seksionit B.7.2.2 (Vendimarrje për Reduktimin e Pagesave) “.....Zbritjet e pagesave për mospërputhje me MPM-të mund të aplikohen në mënyrë retroaktive.....”, por nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se për kontratat A dhe B ku janë aplikuar penalitete për MPM nuk janë rishikuar por çmimi i tyre për ditë është mbajtur sipas vlerave njësi të kontratës fillestare.

Në këtë amendament sipas pikës C, lejon dhe rishikimin e penaliteteve të vendosura para hyrjes në fuqi të tij në mënyrë retroaktive. Ky rishikim është vetëm për kohën e vonesës në bazë të tolerancës të ndryshuar në amendament por duke mbajtur vlerën e tarifës njësi fillestare. Pika C e ndryshuar citon: “Teksti në nën-paragrafin 1) brenda seksionit B.7.2.2 (Vendimarrje për Reduktimin e Pagesave) fshihet dhe zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm: “1) Reduktimet e pagesës për mospërputhje me Masat e Performancës së Menaxhimit (MPM). Shuma e zbritur llogaritet duke shumëzuar kohën e vonesës (në numër ditësh), siç përcaktohet nga Menaxheri i Projektit MC/ARA, me normën për njësi të përcaktuar në Tabelën F.1 – Reduktimet e Pagesave për MPM në Aneksin VII. Kjo shumë do të zbritet nga Menaxheri i Projektit MC/ARA nga pagesat mujore Lum Sum të njëpasnjëshme që i detyrohen Kontraktorit. Zbritjet e pagesave për mospërputhje me MPM-të mund të aplikohen në mënyrë retroaktive. Për reduktimet retroaktive të pagesës që mbulojnë periudhën para vlefshmërisë së Amendamentit Nr.2 të Kontratës, koha e vonesës llogaritet në bazë të periudhave të rishikuara të tolerancës të paraqitura sipas

Amendamentit 2, ndërsa tarifat për njësi që do të zbatohen janë ato të vlefshme përpara amendamentit Nr. 2.”

2. Titulli i Gjetjes:	Vlerat e penalitete në DST të pa argumentuara dhe ndryshimi i tyre.
Situata:	Në kontratat “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” për të patur rezultate sa më të mira në menaxhimin e tyre, në seksionin e specifikimeve pjesa 2 të cilat janë pjesë e DST, është seksioni 6.1 Masat e performancës menaxheriale (<i>Management Performance Measures</i>) MPM e cila pasqyron aftësinë e kontraktorit për të menaxhuar me sukses rezultatet e kontratës duke përfshirë cilësinë dhe efikasitetin e raportimit të tij të informacionit tek punëdhënësi. Për çdo raportim dhe pasqyrim të dhënash tek punëdhënësi nga kontraktori që nuk përputhen me afatet e kërkuara në kontratë janë vendosur penalitete për çdo ditë vonesë përtej këtyre afateve. Masa e Penaliteteve për MPM janë të pasqyruara në DST, për çdo çështje, (Aneksi VII Reduktim i Pagesave për MPM, OPM, RDPM) të specifikimeve pjesa 2 të hartuara nga konsulenti i BB dhe AK kanë qenë kriter mbi bazën e të cilit të gjithë operatorët ekonomik kanë dhënë ofertën e tyre ekonomike. Nga auditimi i dokumentacionit, të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, nuk gjenden gjurmë ku të sqarohet se mbi çfarë reference ose studimi janë bazuar vlerat e penaliteteve nga ana e ekspertit të marrë nga AK dhe BB për hartimin e tyre. Ndryshimi i specifikimeve teknike ka sjell si rezultat edhe rishikimin e penaliteteve, ku janë shtuar dhe hequr disa, duke i përshtatur me kushtet aktuale të kontratës.
Kriteri:	Dokumentat standarte të tenderit, ToR dhe Specifikimet teknike.
Ndikimi/Efekti:	Veshtirësi në aplikimin e penaliteteve nga AK duke mos qenë në përputhje me specifikimet teknike.
Rëndësia:	E lartë.
Shkaku:	Vlerat e penaliteteve jo në përputhje me kushtet aktuale të kontratës.
Rekomandim:	ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që për projektet me financim të huaj vlerat e penaliteteve të cilat do të aplikohen gjatë zbatimit të kontratave të jenë të argumentuara dhe në përputhje me kushtet aktuale të zbatimit të tyre.

3. Amendimi Nr.3 datë 16.10.2019 është nënshkruar midis kontraktorëve dhe ARrSh përfaqësuar nga z. E..... V..... Në këtë amendament janë rishikuar 5 pika të Kushteve të Veçanta të Kontratës (KVK) si dhe 19 pika të Specifikimeve Teknike (ST) të rishikuara. Ndryshimet më thelbësore janë:

a) Klauzola 51 e Kushteve të Veçanta të Kontratës është ndryshuar ku citohet se: “Zbritja e 10% do të aplikohet gjithashtu edhe për Punimet e Emergjencës të cilat janë permanente, si p.sh shtresat dhe strukturat. Në raste të veçanta siç përmendet në Specifikimet Teknike Klauzola 2.1, kjo përqindje mund të rritet deri në 20%.” (II. The text of PC Clause 51 (Retention and Reduction) is amended by adding the following text: “Retention of 10 percent shall also apply for Emergency Works which are of a permanent nature, such as pavements and structures. In the exceptional cases described in Specifications C.2.1 the percentage of Retention may be increased to up to 20%.”)

Për Specifikimet Teknike pika C 2.1 është ndryshuar në këtë amendament ku thuhet:

K: Teksti i plotë i seksionit C.2.1 hiqet dhe zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm: “Kontraktori do të kryejë testet mbi materialet dhe fuqinë punëtore e përshkruar në Specifikimet Teknike për të demonstruar përputhjen e tij me kërkesat e Specifikimeve. Rezultatet e testeve do të përdoren nga Menaxheri i Projektit/MP për të kontrolluar cilësinë e punimeve të kryera dhe për të vërtetuar pagesat përkatëse ndaj Kontraktorit. Dështimi nga Kontraktori për të kryer testet e kërkuara, ose dështimi për të dorëzuar rezultatet për testet e kërkuara, ose dorëzimi i rezultateve të testit që nuk plotësojnë kërkesat ose janë të paplota, në përgjithësi do të rezultojë në pamundësinë e Menaxherit të Projektit/MP për të certifikuar pagesën përkatëse për punimet. Megjithatë, në raste të jashtëzakonshme, MK mund t'i rekomandojë Menaxherit të Projektit pagesën e ndërmjetme për punimet pavarësisht se rezultatet e testimi nuk tregojnë përputhje të plotë me të gjitha kërkesat, me kusht që Kontraktori të pranojë (i) një zgjatje të Periudhës së Garancisë për Defektet për punimet përkatëse, me zgjatjen minimale prej të paktën gjashtë muaj deri në fund të periudhës së kontratës, dhe (ii) një rritje të përqindjes së Retention Money në PC 51. Pranimi ose jo i një rekomandimi të tillë është në diskrecionin e vetëm të Menaxherit të Projektit.” (K: The full text of section C.2.1 is deleted and replaced by the following text: “*The Contractor shall carry out the tests on materials and workmanship described in the Specifications in order to demonstrate his compliance with the requirements of the Specifications. The results of the tests will be used by the Project Manager/MC to check the quality of the Works carried out and to certify the corresponding payments to the Contractor. Failure by the Contractor to carry out the required tests, or failure to submit the results for required tests, or the submission of test results which do not fulfill requirements or are incomplete, shall generally result in the inability of the Project Manager/MC to certify the corresponding payment for Works. Nevertheless, in exceptional cases the MC may recommend to the Project Manager the interim payment for Works despite the test results not showing full compliance with all requirements, under the condition that the Contractor accepts (i) an extension of the Defects Liability Period for the corresponding Works, with the minimum extension being at least six months and up to the end of the Contract period, and (ii) an increased percentage of the Retention foreseen in PC 51. The acceptance or not of such recommendation is within the sole discretion of the Project Manager.*”)

3. Titulli i Gjetjes:	Kryerja e punimeve pa u vërtetuar me testet përkatëse sipas specifikimeve teknike.
Situata:	Në amendimin nr.3 është ndryshuar Klauzola 51 e Kushteve të Veçanta të Kontratës e cila lidhet me penalitet e dëmeve ku është 10% dhe në raste të veçanta mund të bëhet 20% e vlerës së punimeve rehabilituese, përmirësuese dhe emergjente në rastet ku testet e kryera nuk plotësojnë kërkesat e kërkuara. Për plotësimin e ndryshimeve të kësaj klauzole është ndryshuar pika C 2.1, ku kontraktori duhet të kryej të gjitha testet e materialeve në përputhje me specifikimet teknike, ku rezultatet e tyre do të tregojnë cilësinë e punimeve dhe mbi to do të kryhen pagesat përkatëse ndaj kontraktorit. Gjithashtu në këtë pikë është shtuar se, pavarësisht se rezultatet e testeve nuk janë në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat, Konsulentit Monitorues mund t'i rekomandojë Menaxherit të Projektit pagesën e ndërmjetme si dhe të zgjatet perioda e garancisë së punimeve, si dhe mbajtja 20% e vlerës së tyre e cila kthehet me përfundimin garancisë. Pavarësisht kushteve të vendosura, likuidimi i punimeve të kryera pa u vërtetuar se janë kryer sipas specifikimeve teknike nuk japin

	garanci për jetëgjatësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre e për rrjedhojë risin koston e mirëmbajtjes së rrugëve.
Kriteri:	Dokumentat standarte të tenderit, ToR dhe Specifikimet teknike. KTZ, VKM Nr. 68 datë 15.02.2001 “Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit” i ndryshuar; ligji 8402 datë 10.09.1998, i ndryshuar, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” Neni 8 ku thuhet: “Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane”.
Ndikimi/Efekti:	Kryerje e punimeve jo në përputhje me specifikimet teknike nuk japin garanci për jetëgjatësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre e për rrjedhojë risin koston e mirëmbajtjes së rrugëve.
Rëndësia:	E lartë.
Shkaku:	Ndryshimi i specifikimeve teknike të përcaktuara në kontratë.
Rekomandim:	ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që për projektet me financim të huaj punimet e kryera të likuidohen pasi të jenë realizuar në përputhje me specifikimet teknike duke siguruar jetëgjatësinë e investimit dhe ulen e koston së mirëmbajtjes.

b) Paragrafi i parë i Klauzolës 12.1 të KV është hequr dhe zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm: “Kontraktorit i lejohej në mënyrë specifike të nënkontrakttojë pjesë të kontratës deri në maksimum 80% të çmimit total të kontratës. Megjithatë, Kontraktori nuk i lejohej të nënkontrakttojë më shumë se 40% të çmimit total të kontratës me një nënkontraktor, përveç nëse Kontraktuesi është JV dhe nënkontraktori është anëtar i saj. Me kërkesë të Kontraktorit, Punëdhënësi do t’i lëshojë nënkontraktorit një certifikatë që konfirmon llojin dhe vlerën e punimeve të kryera prej tij.” (IV. The first paragraph of PC Clause 12.1 is deleted and replaced by the following text: “The Contractor is specifically allowed to subcontract parts of the contract up to a maximum of 80% of the total contract price. However, the Contractor is not allowed to subcontract more than 40% of the total contract price to one subcontractor, unless the Contractor is a Joint Venture and the subcontractor is a member of that Joint Venture. Upon request of the Contractor, the Employer shall issue a certificate to the subcontractor confirming the type and value of the Works executed by him.”)

4. Titulli i Gjetjes:	Certifikimi i nënkontraktorëve pa kryer menaxhim kontrate me performancë.
Situata:	Në amendimin nr.3 është ndryshuar klauzola 12.1 ku shtohet se nënkontraktimi mund ta kalojë vlerën 40% të kontratës vetëm në rastet kur është pjesë e JV ku bashkimi i operatorëve ekonomik ka hyrë në tender me përqindje të caktuara sipas përvojës që kanë në menaxhimin dhe zbatimin e kontratave të bazuar në rezultate me performancë. Ky ndryshim bën të mundur që të kryhen punime nga ana e kontraktorëve që nuk kanë përvojën e nevojshme për kryerjen e tyre dhe këto punime nuk do të jenë në standarin e kërkuar. Gjithashtu AK do ti lëshojë

	nënkontraktorit një certifikatë që konfirmon llojin dhe vlerën e punimeve të kryera prej tij ku në momentin e ndryshimit ka kaluar më shumë se 50% e afatit kohor të zgjatjes së kontratës. Me këtë ndryshim duke lëshuar certifikatë konfirmimi për nënkontraktorët u jep atyre mundësinë të marrin pjesë, në procedura prokurimi, në kontrata të këtij lloji pa patur përvojën e menaxhimit të tyre pasi ata kryejnë vetëm punime faktike në terren të matura dhe punime të mirëmbajtjes rutinë dhe jo “Self control unit” pasi nuk është e lejuar të nënkontraktohet.
Kriteri:	Kontratat e punimeve civile, klauzola 12.1 (paragrafi i fundit) ku thuhet: <i>“Kontraktori nuk do të lejohet të nënkontrakttoj menaxhimin e projektit dhe operimin e sistemit të vetkontrollit (self control unit)”</i>
Ndikimi/Efekti:	Certifikim i nënkontraktorëve pa kryer menaxhimin e projekteve dhe operimin e sistemit të vetkontrollit.
Rëndësia:	E lartë.
Shkaku:	Përfshirja e nënkontraktorëve në menaxhimin e projektit pa pas përvojën e kërkuar.
Rekomandim:	ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që për projektet me financim të huaj lëshimi i certifikatave për nënkontraktorët të kryhet sipas punimeve të kryera nga ana e tyre duke shmangur pjesëmarrjen e tyre në financime të tjera pa pasur përvojën e kërkuar.

c) Në këtë amendament koha e përfundimit të punimeve përmirësuese nga 25 muaj që ishte sipas amendamentit nr.2 është ndryshuar në 28 muaj, kjo konkretisht në pikën si më poshtë:

V. Teksti i pikës së dytë të Klauzoles 39.1 të KV, është hequr dhe zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm: “Koha e përfundimit të punimeve nga data e nënshkrimit të kontratës, përveç rasteve kur në një Urdhër Ndryshimi ose Urdhër Pune ky afat është parashikuar ndryshe, do të jetë 25 (njëzet e pesë) muaj për punimet e rehabilitimit dhe 28 (njëzet e tetë) muaj për punimet përmirësuese.”

Palët bien dakord më tej që ndryshimet e listuara më poshtë janë bërë në Specifikimet Teknike të Rishikuara (Aneksi 1) i Amendamentit të Kontratës Nr.1 i nënshkruar më 16 mars 2018 dhe i rishikuar përmes amendamentit nr.2, nënshkruar në nëntor 2018):

(V. The text of the second bullet-point of PC Clause 39.1 is deleted and replaced by the following text: *“The time for completion from the date of signature of the contract, unless a different time for completion is stipulated in a Change Order or Work Order, shall be 25 (twenty-five) months for Rehabilitation Works and 28 (twenty-eight) months for Improvement Works”*. The parties further agree that the changes listed below are made to the Revised Specifications (*Annex 1 to Contract Amendment No. 1 signed on March 16, 2018 and revised through Contract Amendment No. 2 signed in November 2018.*)

Referuar ndryshimeve në këtë amendament: për kontratën A punimet rehabilituese duhet të përfundonin më datë 22.02.2019 dhe punimet përmirësuese 22.05.2019; për kontratën B punimet rehabilituese duhet të përfundonin më datë 22.02.2019 dhe punimet përmirësuese 22.05.2019; për kontratën C punimet rehabilituese duhet të përfundonin më datë 24.03.2019 dhe punimet përmirësuese 24.06.2019 dhe për kontratën D punimet rehabilituese duhet të përfundonin më datë 25.02.2019 dhe punimet përmirësuese 25.05.2019.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se këto punime nuk kanë mbaruar brenda këtyre afateve por kanë vazhduar deri më 31.12.2021 dhe nga ana e Konsulentit Monitorues dhe Menaxherit të projektit nuk janë aplikuar penalitete sipas klauzolës 39.3 të KVK ku citohet: *“Për*

punimet rehabilituese të pa përfunduara brenda afateve të parashkikuara penalitetet e dëmit janë 0.1% e pagesave për punimet specifike për cdo ditë kalendarike vonesë. Penalitetet e dëmit për punimet rehabilituese do të jenë jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës së punimeve rehabilituese” dhe “Për punimet përmirësuese të pa përfunduara brenda afateve të parashkikuara penalitetet e dëmit janë 0.1% e pagesave për punimet specifike për cdo ditë kalendarike vonesë. Penalitetet e dëmit për punimet përmirësuese do të jenë jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës së punimeve përmirësuese”.

d) Niveli i shërbimit është reduktuar si më poshtë:

Një seksion i ri i titulluar "B.6.2.15 ZKM-12: "Ulja e Nivelit të Shërbimit" është bërë për të modifikuar kërkesat e nivelit të shërbimit për seksionet rrugore ku shtresat asfaltike ekzistuese nuk mund të mirëmbahen për shkak se punimet rehabilituese të përfshira në kontratë janë pezulluar ose anuluar nga Punëdhënësi. Seksioni i ri B.6.2.15 është paraqitur në Shtojcën nr. 1 të këtij amendamenti nr. 3. (A new section titled "B.6.2.15 OPM-12: Reduced Scope Service Level" is introduced to modify service level requirements for road sections where existing pavements cannot be maintained because rehabilitation Works included in the contract have been suspended or cancelled by the Employer. The new section B.6.2.15 is shown in Attachment No. 1 to this Amendment No. 3.)

Gjithashtu sipas specifikime të ndryshuara pjesë e këtij amendimi (Attachment 1) janë hequr dhe penalitetet për OPM-2 për defektet e asfaltit ku ka çarje që nuk e kalojnë thellësinë 10 cm. Ky ndryshim ka ulur nivelin e shërbimit por nuk është i shoqëruar me ulje të kostos së mirëmbajtjes rutinë pasi kontraktori kryen më pak punime nga ato të ofruara. Në DST nuk është kërkuar një analizë kostoje të çmimit/njësi, për zërat e punimeve të mirëmbajtjes rutinë, e cila do të bënte të mundur llogaritjen e uljes së kostos sipas nivelit të shërbimit të ofruar.

5. Titulli i Gjetjes:	Reduktimi i nivelit të shërbimit.
Situata:	Në kontratat "Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate" mirëmbajtja rutinë përcaktohet nga niveli i shërbimit të kërkuar sipas kategorisë dhe kushteve teknike të rrugës. Në amendimin nr.3 janë modifikuar kërkesa e nivelit të shërbimit për seksionet rrugore ku shtresat asfaltike ekzistuese nuk mund të mirëmbahen për shkak se punimet rehabilituese të përfshira në kontratë janë pezulluar ose anuluar nga Punëdhënësi. Ky ndryshim ka ulur nivelin e shërbimit por nuk është i shoqëruar me ulje të kostos së mirëmbajtjes rutinë pasi kontraktori kryen më pak punime nga ato të ofruara. Në DST nuk është kërkuar një analizë kostoje të çmimit/njësi, për zërat e punimeve të mirëmbajtjes rutinë, e cila do të bënte të mundur llogaritjen e uljes së kostos sipas nivelit të shërbimit të ofruar.
Kriteri:	Dokumentat standarte të tenderit, ToR dhe Specifikimet teknike.
Ndikimi/Efekti:	Reduktim i nivelit të shërbimit i pa shoqëruar me uljen e kostos së shërbimit.
Rëndësia:	E lartë.
Shkaku:	Mosvlerësim i saktë i nivelit të shërbimit, për secilin segment të rrugëve, në kushtet e kontratës.
Rekomandim:	ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që për kontrata të ngjashme niveli i shërbimit të kërkohej sipas kushteve të rrugëve dhe me një kosto të detajuar për punimet që kryhen ku do të bëjë të mundur uljen e kostos së

	projekteve në tërësi në rastet ku do të kërkohet një nivel shërbimi i reduktuar.
--	--

e) Në pikën F janë ndryshuar specifikimet B.3.6.4 për dëmtimin e aseteve rrugore, ku sipas kontratës fillestare thuhet se humbjet apo dëmtimet të punimeve ose aseteve risku është i kontraktorit në masën 100%. Sipas specifikimeve të rishikuara në amendamentin nr.1, kontraktori mbulon në riskun e tij deri 3,500 Euro për cdo ngjarje dhe maksimumi në total 35,000 Euro në vit. Pra dëmtimi i aseteve nga palët e treta që kalojnë vlerën mbi 3,500 Euro për rast ose mbi 35,000 Euro në vit do të paguhet nga punëdhënësi. Gjithashtu në pikën e mësipërme të këtij amendamenti në specifikimet teknike B.3.4.6 shtohet: *“Për dëmet e aseteve rrugore që kanë ndodhur para datës 16 mars 2018, zbatohen edhe dispozitat e këtij seksioni B.3.6.4. me përjashtim të kërkesave për afatin e raportimit të dëmeve të tilla tek Punëdhënësi, Konsulenti Monitorues dhe të tjerët.”* (For Road Asset Damages which have occurred prior to March 16, 2018, the provisions of this section B.3.6.4 are also applicable, with the exception of the requirements for the timeliness of reporting of such damages to the Employer, the MC and others.) e cila kthen në mënyrë retroaktive rilogarit të gjitha dëmet e shkaktuara para datës 16.03.2018, të cilat janë 100% në riskun e kontraktorit, duke ju dhënë specifikimeve teknike fuqi prapavepruese e për rrjedhojë rit koston e projektit në dëm të punëdhënësit të cilat do të shihen se sa është ky efekt në zbatimin e kontratave.

6. Titulli i Gjetjes:	Dëmtimi i aseteve dhe përcaktimi i mbulimit të kostsove.
Situata:	Në kontratat “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” në Amendamentin nr.3 datë 16.10.2019 në pikën F janë ndryshuar specifikimet B.3.6.4 për dëmtimin e aseteve rrugore, ku sipas kontratës fillestare thuhet se humbjet apo dëmtimet të punimeve ose aseteve risku është i kontraktorit në masën 100%. Sipas specifikimeve të rishikuara në amendamentin nr.1, kontraktori mbulon në riskun e tij deri 3,500 Euro për cdo ngjarje dhe maksimumi në total 35,000 Euro në vit. Pra dëmtimi i aseteve nga palët e treta që kalojnë vlerën mbi 3,500 Euro për rast ose mbi 35,000 Euro në vit do të paguhet nga punëdhënësi. Gjithashtu në pikën e mësipërme të këtij amendamenti në specifikimet teknike B.3.4.6 është shtuar që risku të mbahet nga punëdhënësi edhe para datës 16.03.2018 kur është miratuar ndryshimi i specifikimeve teknike duke patur fuqi prapavepruese. Para ndryshimeve të kryer në specifikimet teknike nuk ka pasur nga kontraktori për dëmtime të aseteve.
Kriteri:	Dokumentat standarte të tenderit, ToR dhe Specifikimet teknike.
Ndikimi/Efekt:	Kosto e dëmtimit të aseteve mbi punëdhënësin .
Rëndësia:	E mesme.
Shkaku:	Ndryshime të specifikimeve teknike me veprime prapavepruese.
Rekomandim:	ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që për kontrata të ngjashme të mos miratohen ndryshime me veprime prapavepruese të cilat risin koston e projektit mbi punëdhënësin.

f) Në pikën G seksioni i specifikimeve teknike B.4.6.7 (Vrojtimet dhe Projektimet sipas Shtresave Rrugore) është hequr totalisht e cila thotë se para dhe mbas përfundimit të punimeve rehabilitimit, kontraktori është i detyruar të kryej testet e IRI (Indeksi i Ashpersisë së Rrugës) dhe FWD (kriteri i fortësisë së rrugës) të cilat përcaktojnë nevojat e rehabilitimit të shtresave si dhe më jetëgjatësia e tyre nga punimet e kryera. Këto teste duhet të jenë pjesë e dorzimit të projektit e cila lidhet me

MPM-5 si dhe pjesë e raportimit të përfundimit të punimeve MPM-6 por që në vetvete lidhen me MPM-9 dhe MPM-10. Penalitetet e njëjta si MPM-9 dhe MPM-10 duhet të bëhen vetëm një herë në rastet e mësipërme. Testet IRI dhe FWD pas përfundimit të punimeve do të paraqiten edhe në Raportin e Inventarit të Aseteve çdo 6 muaj, por nuk duhet të ishin hequr para fillimit të punimeve pasi janë të rëndësishme.

7. Titulli i Gjetjes:	Kryerja e testeve të Ashpërsisë dhe Fortësisë së rrugës dhe Inventari i Aseteve.
Situata:	Në kontratat “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” është parashikuar që para fillimit dhe në të punimeve rehabilituese dhe përmirësuese duhet të kryheshin testet IRI (Indeksi i Ashpërsisë së Rrugës) dhe FWD (kriteri i fortësisë së rrugës). Në amendamentin nr. 3 datë 16.10.2019 në pikën G seksioni i specifikimeve teknike B.4.6.7 (Vrojtimit dhe Projektimit sipas Shtresave Rrugore) është hequr totalisht, pra testet e IRD dhe FWD të mos kryhen pas përfundimit të punimeve dhe do të paraqiten në Raportin e Inventarit të Aseteve çdo 6 muaj. Kryerja e testeve para fillimit të punimeve është e rëndësishme pasi ato përcaktojnë nevojat e rehabilitimit të shtresave si dhe më jetëgjatësia e tyre nga punimet e kryera.
Kriteri:	Dokumentat standarte të tenderit, ToR dhe Specifikimet teknike.
Ndikimi/Efekti:	Mospërcaktimi i saktë i nevojave për rehabilitimin e shresave dhe jetëgjatësia e tyre.
Rëndësia:	E lartë.
Shkaku:	Ndryshimi i specifikimeve teknike.
Rekomandim:	ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që për kontrata të ngjashme për një përcaktim sa më të saktë të nevojave rehabilituese të shtresave rrugore të kryhen testet e kërkuara duke kryer shpenzime efikase dhe ruajtjen e kushteve të rrugëve për ofrimin e shërbimit të kërkuar nga përdoruesit e saj.

3. Amendimi Nr.4 datë 26.10.2021 është nënshkruar midis kontraktorëve dhe ARrSh përfaqësuar nga z. E..... B..... Në këtë amendament është rishikuar klauzola 39.1e Kushteve të Veçanta të Kontratës (KVK) si më poshtë: “Koha e përfundimit është si vijon:

• *Shërbimet e Performancës së Rrjetit siç përshkruhet në Specifikime do të kryhen nga Kontraktori deri më 31 Mars 2022.*

Gjatë periudhës ndërmjet 1 janarit 2022 dhe 31 marsit 2022, Punëdhënësi mund të ndërpresë Shërbimet e Performancës së Rrjetit brenda 10 ditëve pas një njoftimi me shkrim të Kontraktorit për këtë qëllim. Në këtë rast, pika 59.1.3 shkronjat (b), (c), (d) dhe (e) nuk janë të zbatueshme.

• *Punimet e rehabilitimit, përmirësimit dhe emergjencave do të përfundojnë jo më vonë se data 31 dhjetor 2021, përveç rasteve kur është përcaktuar ndryshe një kohë tjetër për përfundimin në Urdhrin përkatës të Ndryshimit ose Urdhrin e Punës për këto punime.*

• *Periudha e përgjegjësisë për defektet për punë të veçanta rehabilitimi, përmirësimi dhe urgjencë përfundon 12 muaj pas përfundimit të punimeve specifike të përshkruara në Urdhrin e Ndryshimit ose Urdhrin e Punës përkatës.”.*

Sipas këtij ndryshimi vetëm punimet e performancës rutinë përfundojnë më 31.03.2022 duke e zgjatur kontratën me tre muaj, kurse punimet rehabilituese dhe përmirësuese deri më 31.12.2021 duke ndryshuar afatet e përcaktuara në amendimin nr.2 dhe nr.3 të cilat ishin përkatësisht 25 muaj

dhe 28 muaj. Ky ndryshim shmang penalitetet ndaj kontraktorëve sipas kluzoles 39.3 të KVK për ato punime rehabilituese dhe përmirësuese që nuk kanë mbaruar brenda afatit të përcaktuar në amendimet paraardhëse.

Dorëzimi i Raportit të Inventarit të Aseteve të Përditësuara, final, duhet të dorëzohet 6 muaj para përfundimit të kontratës më 30.06.2021. Në këtë amendament është ndryshuar dhe ju është lënë afat data e fundit të kontratës 31.12.2021 e cila duhet të përfshijë IRI dhe FWD të kryera nga kontraktorët gjatë vitit 2021. Në qoftë se AIR (*Asset Inventory Report*) nuk dorëzohet në datën e rishikuar penalitetet do të llogariten nga data 30.06.2021 sipas atyre të miratuara në amendimet e mëparshme. Sipas amendimit nr.3 specifikimi B.3.6.6 Raportit Përfundimtar i Kontratës, ku përfshihen dhe inventari i asetëve, duhet të dorëzohet gjashtë muaj para përfundimit të saj me qëllim kalimin e lehtë tek kontrata tjetër e mirëmbajtjes dhe të sigurojë që Punëdhënësi dhe Kontraktori të kenë dijeni për të gjitha problemet në to. Ky ndryshim nuk bën të mundur njohjen e të gjitha problemeve në kohën e duhur si dhe shmang penalitetet MPM-9 dhe MPM-10 ndaj kontraktorëve për periudhën gjashtë mujore.

Konstatohet se në pikën e fundit të amendamentit nr.4, thuhet: “ARRSH pranon raportet e dorëzimit në fund të kontratës të paraqitura tashmë nga kontraktorët (sipas specifikimeve B.3.6.6) si të përmbushura.” (*ARA accepts the End-of-Contract Handover Reports already submitted by the Contractors (as per Specifications B.3.6.6) as satisfactory.*) e cili të përfshirë të dhënat si: përshkrim total i aktivitetit të mirëmbajtjes; detajet e ndërtimit (vizatimet sipas faktit); problemet aktuale dhe kërkesat e tyre; gjendja e shtresave; tendencat e fortësisë e ashpërsisë së rrugës dhe gjendja totale e sistemit. Gjithashtu parashikimi i kërkesave për mirëmbajtjen në të ardhmen. Me ndryshimin e specifikimit B.3.6.6 (*End-of-Contract Handover Reports*) në amendimin nr.3 kërkohet që pjesë e tij të jetë: vlerësimi i jetëgjatësisë së mbetur të shtresave të rrugës, sipas seksioneve homogjene, i llogaritur mbi bazën nga të dhënat më të fundit të devijimit të shtresave (FWD) dhe ashpërsisë (IRI). Në rast se ky raport pranohet i plotësuar, sipas kësaj pike, atëherë nuk duhet të aplikohen penalitetet pas datës së dorëzimit të tij. Referuar penaliteteve të vendosura nga MC për MPM-8, MPM-9 dhe MPM-10 tregon se raporti përfundimtar nuk është i plotë sipas kërkesave të parashikuara dhe pranimi i tij në këtë pikë të amendamentit nuk qëndron.

Konkluzion:

1. Konstatohet se dokumentat standarte të tenderit nuk janë hartuar në përputhje me kushtet dhe nevojat e kontratave të cilat kanë sjell ndryshimet e tyre gjatë zbatimit. Këto ndryshime kanë rezultuar në implementimin e kontratave sipas një metode hibride dhe jo sipas asaj të projektuar në DST. Specifikimet teknike të hartuara dhe sqarimet e dhëna gjatë procesit të tenderimit nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe ekspertëve të BB nuk kanë qenë në përputhje me objektivat e kontratave si dhe mungesë qartësie të tyre. Gjithashtu janë përfshirë rrugë që kanë pasur nevojë për një rehabilitim total dhe referuar gjendjes së tyre gjatë procesit të mirëmbajtjes nuk mund të arrihej niveli i kërkuar i shërbimit.
2. Koncepti i kontratave “Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate” nuk është kuptuar siç duhet nga kontraktorët të cilët nuk kanë patur një qasje të përshtatshme lidhur me procesin e implementimit si dhe njohjen e risqeve në çdo fazë.
3. Janë kryer ndryshime të kushteve të kontratave dhe specifikimeve fillestare, në mënyrë thelbësore si dhe referuar këtyre specifikimeve të rishikuara janë ndryshuar penalitetet MPM që lidhen me kontrollin e menaxhimit të projektit, ku operatorët ekonomik kanë paraqitur ofertën e tyre. Ndryshimi i penaliteteve për MPM nuk është kryer mbi një studim ose ndonjë referencë për të treguar se si janë vendosur këto vlera.

4. Afati i punimeve rehabilituese dhe përmirësuese është ndryshuar nga 12 muaj në 25 muaj nga fillimi i kontratës si dhe nga punime të ofruara (lump sum) çmim total do të paguhet si punime të matshme si dhe shmangien nga penaltetet për mospërfundimin e tyre brenda afateve.
5. Mosparaqitja e raporteve IRI dhe FWD e vendos në vështirësi AK për të konstatuar problematikat e akteve rrugore si dhe i krijon hapësira kontraktorit të ardhshëm të kryej punime rehabilituese jo të nevojshme.

Kontrata e supervizionit

Monitorimi dhe konsulenca e projektit “Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate” për të katër Lotet kryhet nga BOE “I.... E..... S.r.l & S... S.p.a & S..... S.p.a” sipas kontratës të lidhur me ARRSH, Nr.9999Prot. datë 05.12.2017 me vlerë fillestare 4,800,300 Euro pa TVSH të cilës i janë bërë 12 (dymbëdhjetë) shtesa (addendum) me kohëzgjatje deri në përfundim të kontratës së zbatimit. Amendimet e kontratës kanë konsistuar në miratimin e ndryshimit të stafit kryesor si dhe në kohëzgjatjen e kohës së punës për stafin kryesor dhe jo kryesor. Pagesat do të kryhen në bazë të ditëve të punës për ekspertët kryesor dhe jo kryesor që do të monitorojnë zbatimin e kontratave të mirëmbajtjes.

Ndryshimi i afatit të përfundimit të punimeve rehabilituese dhe përmirësuese ka ndikuar në ritjen e kostovs së kontratës së konsulentit duke shtuar ditët e punës për stafin e huaj dhe atë lokal që do të ndiqte këto punime. Vlera fillestare e kontratës ishte 5,880,360 Euro me TVSH dhe ajo përfundimtare 8,160,462 Euro me Tvsh, pra kemi një ritje prej 38%.

Sipas Kushteve të Vecanta të Kontratës (KVK) afati i përfundimit të kontratës është 66 muaj nga nënshkrimi i saj. Gjithashtu në kontratë është parashikuar nënkontraktimi vetëm për stafin kryesor (key expert) sipas klauzolës 20.3 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës.

Amendamentet e kontratës së monitorimit dhe konsulencës si më poshtë:

1. Amendimi Nr.1 me Nr.9999/1Prot. datë 15.12.2016 ka ndryshuar klauzolën 11.1 të kushteve specilale të kontratës ku përcakton qartë se fillimi i shërbimit nga konsulenti do të jetë tre ditë pas letrës të njoftimit nga punëdhënësi. Letra e njoftimit nga punëdhënësi duhet të jetë jo më vonë se dy javë nga data e firmosjes së kontratës. Me letrën Nr.10397Prot. datë 16.12.2016 punëdhënësi njofton për fillimin e shërbimit i cili sipas klauzolave 11.1 dhe 13.1 është data 21.12.2016 që do të mbahet dhe takimi fillestar.

2. Amendimi Nr.2 me Nr.4330Prot. datë 26.05.2017 nënshkruar më datë 23.05.2017 ka miratuar ndryshimet e ekspertëve kryesor pa kosto financiare. Konkretisht është ndryshuar zv. Lideri i ekipit (Deputy Team Leader), inxhinieri i kontrollit të sasisë dhe cilësisë (Qa/Qc Egeer), Inxhinieri i mirëmbajtjes së rrugës për kotratat A dhe C (Road Maintenance Engineer) dhe specialisti i mjedisit dhe sigurisë (Environmental/Site Safety Specialist).

Nga auditimi i pagesave për mujt Mars, Prill dhe Maj 2017 konstatohet se në to është përfshirë edhe pagesa e Deputy Team Lider z. A.... B..... nga data 07.03.2017 dhe deri datë 23.05.2017 e cila është datë e miratimit nga punëdhënësi me këtë amendament. Sipas amendamentit pagesa e tij duhet të fillonte më datë 23.05.2017, e cila është data e nënshkrimit, e në vazhdim. Pra për sa më sipër konsulenti ka përfituar më tepër vlerën: 10,285.71 Euro (0.76 muaj x 13,500 Euro/muaj) në pagesën e ndërmjetme Nr.1 në muajin Mars 2017; 10,665 Euro (0.79 muaj x 13,500 Euro/muaj) në pagesën e ndërmjetme Nr.2 në muajin Prill 2017 dhe 9,450 Euro (0.7 muaj x 13,500 Euro/muaj) në pagesën e ndërmjetme Nr.3 në muajin Maj 2017, pra në total 30,390.71 Euro pa TVSH.

3. Amendimi Nr.3 me Nr.7233Prot. datë 14.09.2017 ka miratuar ndryshimin e liderit të ekipit (Team Leader) pa rritje të koston financiare të kontratës.

4. Amendimi Nr.4 me Nr.9039Prot. datë 09.11.2017 ka miratuar ndryshimin e ekspertit ligjor të kontratës (Legal/Contrakt Expert) pa rritje të kostos financiare të kontratës.

5. Amendimi Nr.5 me Nr.803/1Prot. datë 05.02.2018, nënshkruar nga z. A.... Q....., ka miratuar ndryshimin e ditëve të punës për stafin jo kryesor (lokal) duke e shtuar me 2 muaj për secilin (12 punonjës) dhe për liderin e ekipit duke e ulur me 3.64 muaj. Me këto ndryshime vlera e kontratës ka ngelur e pa ndryshuar. Me letrën No. IRD18-MR0002-T datë 23.01.2018 konsulenti informon se ditët e punës të parashikuara në kontratë për stafin lokal janë përdor dhe nevojiten më shumë ditë pune për të vazhduar me monitorimin dhe inspektimin e aktiviteteve në proces. Sipas kontratës aktivitetet e lidhura me stafin lokal janë, rehabilitimi i shtresave dhe të nënshtresave, punimet përmirësuese dhe punimet emergjente ku ato rehabilituese dhe përmirësuese duhet të përfundonin 12 muajt e parë të kontratave të zbatimit. Këtë e tregon dhe koha e parashikuar për ta në kontratën fillestare e cila është 12 muaj. Referuar zbatimit të kontratave të punimeve civile rezulton se gjatë 12 muajve të parë deri në nënshkrimin të amendamentit nr.1 datë 16.03.2018 nuk është kryer asnjë aktivitet për të cilat është punësuar dhe paguar stafi lokal, kështu që vlera prej 432,000 Euro pa TVSH është përfituar nga konsulenti pa ofruar ndonjë shërbim sipas përshkrimit të punës (scope of work) të parashikuar në kontratë nga ky staf.

6. Amendimi Nr.6 me Nr.3729/2Prot. datë 31.05.2018 ka miratuar zgjatjen e kohës për stafin kryesor dhe jo kryesor dhe disa ekspertëve me kohë të pjesshme. Ky ndryshim është bërë sipas propozimit të konsulentit me letrën No.IRD18-MR13-A datë 02.05.2018 e cili sqaron se për vonesat në punimet rehabilituese dhe përmirësuese të cilat kërkojnë më shumë kohë nga ajo e parashikuar kërkohet më shumë kohë stafi për monitorimin dhe supervizionimin e tyre. Në këtë amendament për stafin kryesor janë shtuar; 12 muaj për zv. Liderin e ekipit, zbritur 5 muaj për inxhinierin e urave, zbritur 15 muaj për specialistin mjedisit, 5 muaj për ekspertin ligjor si dhe është shtuar ekspert për projektim rruge (Road Desing Expert) 6 muaj me pagë mujore 9,500 Euro i pa parashikuar në kontratën fillestare. Konsulenti në ofertën e tij nuk ka parashikuar një ekspert projektimi duke patur parasysh se shërbimi i ofruar prej tij do të mbulohej nga ekspertet e tjerë që kanë përvojën dhe kapacitetet e nevojshme. Koha e punës për stafin jo kryesor është shtuar me 12 muaj për secilin ku gjithashtu janë shtuar dhe tre ekspertë me kohë të pjesshme 2 muaj secili, konkretisht një inxhinier hidro, një inxhinier elektrik dhe një inxhinier gjeolog me pagë mujore 3,100 në muaj.

Referuar ditëve të punës, deri në maj 2018 kur është miratuar dhe ky amendim, rezulton se stafi kryesor i cili është me kohë të pjesshme nuk ka harxhuar gjithë kohën e parashikuar në kontratën fillestare përveç ekspertit ligjor.

Nr.	Eksperti	Kontrata (muaj)	Konsumuar deri 31.05.2018 (muaj)	Koha e shtuar (muaj)	Vlera e kohës së shtuar (Euro)
1	Deputy Team Leader	36	12.61	12	162,000
2	Senior Brigde Engineer	6	0	-5	-47,500
3	Senior Env/ Specialist	18	0.29	-15	-142,500
4	Legal/Contract Expert	3	3.1	5	80,000
5	Road Desing Expert	0	0	6	57,000

Ritja e ditëve të punës për ekspertët me kohë të pjesshme duhet të bëhet pasi ata të konsumonin afatin e parashikuar në kontratë dhe vlerësimi të bëhet sipas nevojave reale, pra kjo ritje është e pa argumentuar. Gjithashtu shtimi i Ekspertit Projektues Rruge (Road Desing Expert) nuk ka qenë i nevojshëm pasi kjo kontratë është vetëm mirëmbajtje dhe rehabilitim dhe jo projektim i rrugëve. Sipas përshkrimit të punës, kontrolli i projekteve të hartuara nga kontraktori për punimet

rehabilituese, përmirësuese dhe emergjente do të kryej nga ekspertët kryesor dhe ai lokal të parashikuar në kontratën fillestare. Nga shtimi i ditëve të punës për ekspertin projektues (Road Design Expert) vlera e kontratës rritet me 57,000 Euro Pa TVSH.

Me ndryshimet e bëra në amendamentin Nr.6 vlera e kontratës fillestare është ritur me 559,600 Euro Pa TVSH.

7. Amendimi Nr.7 me Nr.4765Prot. datë 16.05.2019, nënshkruar nga znj. S.... Q...., ka miratuar zgjatjen e kohës për stafin kryesor dhe jo kryesor dhe disa ekspertëve me kohë të pjesshme. Për stafin kryesor janë shtuar 12 muaj për Road Design Expert dhe 12 muaj për Contract/Legal Specialist. Për stafin lokal: Road Inspector (A,B,C,D) koha të shtohet me 12 muaj; Materials/QA (A,B,C,D) koha të shtohet me 12 muaj; Quantity Surveyor (A,B,C,D) koha të shtohet me 12 muaj; Hydraulic Engineer koha të shtohet me 4 muaj; Geotechnical Engineer koha të shtohet me 4 muaj; Electrical Engineer koha të shtohet me 12 muaj. Nga audimi i katër kontratave të zbatimit të punimeve civile, konkretisht, urdhër ndryshimet dhe punimet emergjente konstatohet se punimet elektrike janë vetëm në disa seksione dhe volumi i punimeve për rishikimin dhe vlerësimin e tyre nuk e justifikon kontributin e inxhinierit elektrik të zgjatur me 12 muaj dhe jo të argumentuar. Nevoja e inxhinierit elektrik duhet të jetë në varësi të propozimeve të kontraktorëve për punimet elektrike dhe grafikut të zbatimit të tyre në 12 muajt e ardhshëm.

Sipas kontratës fillestare koha e parashikuar për Road Inspector (A,B,C,D); Materials/QA (A,B,C,D); Quantity Surveyor (A,B,C,D) është 12 muaj në vitin e parë ku sipas përkthimit të punës lidhen me punimet rehabilituese dhe përmirësuese, kështu që edhe koha e këtyre ekspertëve duhet të lidhet me afatin e përfundimit të këtyre punimeve.

Referuar amendamentit nr.1 datë 16.03.2018 për të katër kontratat, afati i përfundimit të punimeve rehabilituese dhe përmirësuese është ndryshuar, KVK klauzola 39.1 ku është bërë 25 muaj nga fillimi i kontratës. Në këtë amendament rezulton se janë miratuar ditë pune për inspektorët e rrugëve, kontrolli i cilësisë së materialeve dhe kontrollin e volumeve [(Road Inspector (A,B,C,D); Materials/QA (A,B,C,D); Quantity Surveyor (A,B,C,D))] ditë pune përtej afatit të përfundimit të punimeve rehabilituese dhe përmirësuese në vlerën prej 432,000 Euro pa TVSH. Gjithashtu në këtë amendim është miratuar një përkthes me kohëzgjatje 12 muaj dhe një shofer 31 muaj të cilët nuk kanë qenë të parashikuar në kontratën fillestare. Sipas kontratës fillestare është parashikuar sekretare/përkthyes dhe shtimi i një përkthyesi është i pa argumentuar. Sipas kontratës fillestare nevojat e përkthimit do të mbulojnë nga sekretarja ku referuar appendix IV, stafi suportues, thuhet Sekretare/Përkthyes për interpretimin dhe shërbim përkthimi (“Secretary/translator for interpretation and translation services”). Referuar materialeve të përkthyer të vendosura në dispozicion rezulton se janë vetëm disa raporte për të cilat nuk kanë patur nevojë për kohë 12 muaj. Shtesa e përkthyesit për 12 muaj rrit vlerën e kontratës me 10,800 Euro pa TVSH të përfituara më tepër nga konsulenti pasi këtë shërbim e kryen sekretar/përkthyes.

Referuar specifikimeve të kontratës së zbatimit dhe të konsulencës transporti dhe sigurimi i mjeteve do të bëhet nga ana e kontraktorëve kjo sipas Aneksit III (Support Facilities to be provided by the Contractor to the Monitoring Consultant) Transport Vehicles: Tëo vehicles at the minimum cost for each of the four field offices and two additional vehicles at Tirana for the office of monitoring consultant (One for Team Leader and one for Deputy Team Leader). Dy automjete me kosto minimale për secilën nga katër zyrat në terren dhe dy automjete shtesë në Tiranë për zyrën e konsulentit monitorues (një për drejtues ekipi dhe një për Zëvendës udhëheqësi i ekipit). Në kontratën e konsulentit konstatohet se në Appendix D Vlerësimi i koston për shpenzimet e rimbuesueshme, “Reimbursable expenses cost estimate” është 0 pasi ato janë të shpërndara në pagesat e stafit. Në ofertën fillestare nuk janë parashikuar shofera, për për makinat e vendosura në

dispozicion nga kontraktori, pasi janë marrë parasysh si shpenzime të rimbursueshme me kosto zero, note 7,8 dhe 9. Për sa më sipër shitimi i një shoferi për 31 muaj me vlerë 24,800 Euro pa TVSH është jashtë kushteve të kontratës. Shtimi i përkthyesit dhe shoferit me vlerë totale 35,600 Euro pa TVSH është i pa argumentuar dhe është përfituar më tepër nga konsulenti.

Me ndryshimet e bëra në amendamentin Nr.7 vlera e kontratës fillestare është ritur me 835,600 Euro Pa TVSH.

8. Amendimi Nr.8 me Nr.11598Prot. datë 19.12.2019, nënshkruar nga z. E.... V....., ka ndryshuar klauzolën 7.1 të Kushteve speciale të kontratës duke shtuar “Shërbimet e ofruara nga stafi ndërkombëtar afatshkurtër i Konsulentit konsiderohen të miratuara nga Klienti nëse këto shërbime kërkohen nga Drejtuesi i Ekipit të IRD-së ose nga Menaxheri i Projektit të ARA-s, ose nga Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH.” Ky ndryshim nuk ka rritjet të kostos së kontratës.

9. Amendimi Nr.9 me Nr.5022Prot. datë 08.07.2020, nënshkruar nga z. V..... ka miratuar zvogëlimin e kohës për stafin kryesor dhe ritjen e kohës për Deputy Team Leader me 8 muaj si dhe rritjen për stafin lokal duke shtuar me 12 muaj Materials/QA dhe Quantity Surveyor për vetëm një të cilët do të mbulojnë të katër kontratat pasi punimet rehabilituese dhe përmirësuese janë reduktuar. Koha e punës për Road Inspektor (A,B,C,D) është shtuar me 19 muaj. Ashtu siç është parashikuar që nga një Materials/QA dhe Quantity Surveyor do të mbulonte të katër kontratat duhej të ishte një Road Inspektor për të katër kontratat, kjo pasi edhe në ofertën e konsulentit janë parashikuar me kontribute të njëjta. Zgjatja e kohës për stafin lokal është jashtë afatit të përfundimit 25 muaj të punimeve rehabilituese dhe 28 muaj të punimeve përmirësuese sipas amendimit nr.3 datë 16.10.2019 të kontratave të punimeve civile. Gjithashtu edhe zgjatja e afatit për Deputy Team Leader është jashtë përshkrimit të punës së tij. Sipas kontratës ishte tre vitet e para 36 muaj dhe me mosrealizimin e punimeve rehabilituese dhe përmirësuese në vitin e parë dhe me ndryshimet e afateve të tyre koha e DTL duhet të ishte 48 muaj, kështu që shtesa prej 8 muaj në këtë amendament është e pa argumentuar dhe jashtë parashikimit.

Me ndryshimet e bëra në amendamentin Nr.7 vlera e kontratës fillestare është ritur me 198,205 Euro Pa TVSH.

10. Amendimi Nr.10 me Nr.5056Prot. datë 28.05.2021, nënshkruar nga z. E.... V..... ka miratuar ritjen e kohës për stafin lokal, konkretisht me 7 muaj për Materials/QA dhe Quantity Surveyor, 3 muaj për inxhinierin elektrik dhe nga një muaj për inxhinierin hidroteknik e gjeolog. Ashtu si edhe më sipër rritja e afatit për stafin lokal është jashtë afateve të përfundimit të punimeve rehabilituese dhe përmirësuese.

Me ndryshimet e bëra në amendamentin Nr.7 vlera e kontratës fillestare është ritur me 59,900 Euro Pa TVSH.

11. Amendimi Nr.11 me Nr.41/1Prot. datë 06.01.2022, nënshkruar nga z. E.... B..... ka miratuar ritjen e kohës për stafin kryesor dhe jo kryesor (lokal). Referuar amendimit nr.4 të kontratave të zbatimit të cilat janë zgjatur me tre muaj, deri më 31.03.2022, nga ARrSh është kërkuar monitorimi i këtyre kontratave nga ana e konsulentit ku është rënë dakort:

(i) Data e përfundimit të katër kontratave “Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate” është shtyrë deri më 31.03.2022, prandaj ARrSh ka kërkuar vazhdimin e shërbimit të konsulentit të suportoje atë në monitorimin.

(ii) Punimet e rehabilitimit sipas kontratës fillestare do të kryeshin gjatë dy viteve fillestare të ekzekutimit të këtyre kontratave ku edhe verifikimi i detajuar dhe raportimi i tyre do të bëhej po në të njëjtën afat kohor. Megjithatë, numri i madh i Urdhër Ndryshimve të lëshuara deri vonë dhe Urdhër Ndryshimet shtesë, të cilat janë të planifikuara, do të kërkojë një vëllim të madh pune për

verifikimin dhe raportimin e përfundimit nga Konsulenti në gjashtë muajt pas përfundimit të kontratave të OPRC më 31 mars, 2022 dhe deri më 30 shtator 2022.

Në këtë amendament koha e punës së shoferit i shtuar në amendamentin nr. 7, i cili sic është thënë më lart nuk ka qenë i parashikuar në kontratën fillestare, është shtuar me tre muaj. Sqarohet dhe një herë se shtimi i një shoferi, i pa parashikuar në kontratën fillestare ka rritur vlerën e kontratës për këtë amendament me 2,400 Euro pa TVSH.

Afati i punimeve rehabilituese dhe përmirësuese për kontratat e zbatimit është 31.12.2021 e pas kësaj date nuk duhet të kryej asnjë punim i tillë si dhe duhet të ishin dorëzuar me të gjitha raportet e kërkuara në specifikimit teknike. Sipas afatit të kontratës mbas datë 31.12.2021 është e kuptueshme që mund të kryhen vetëm punime emergjente. Nga auditimi i dokumentacionit të kontratave të zbatimit rezulton se mbas datës 31.12.2021 nuk janë kryer punime emergjente, të cilat kanë patur nevojë për ekspertët QA/Materials Engineer, Quantity Surveyor Engineer, Geotechnical Engineer, Hydraulic Engineer dhe Electrical Engineer. Çdo punim rehabilitimi e përmirësimi, verifikimi i detajuar dhe raportimi i tyre duhet të kryej brenda datës 31.12.2021 për të pasur një raport sa më të plotë e kalimin sa më të mirë tek kontratat në vazhdim. Vlera e ekspertëve të mësipërm të shtuar në këtë amendim rit koston e kontratës fillestare me 67,700 Euro.

Në pikën (ii) të këtij amendamenti theksohet se ka një numur të madh urdhër ndryshimesh ndaj kërkohet më shumë staf dhe kohë për rishimin e tyre. Referuar kontratave të zbatimit janë parashikuar dhe kryer punime me urdhër ndryshime për çdo kontratë si më posht:

Kontrata A parashikuar, 54 punime rehabilituese/përmirësuese nga ku janë kryer me urdhër ndryshime 13 punime rehabilituese/përmirësuese dhe 10 punime emergjente, 31 më pak.

Kontrata B parashikuar, 69 punime rehabilituese/përmirësuese nga ku janë kryer me urdhër ndryshime 18 punime rehabilituese/përmirësuese dhe 16 punime emergjente, 35 më pak.

Kontrata C parashikuar, 50 punime rehabilituese/përmirësuese nga ku janë kryer me urdhër ndryshime 33 punime rehabilituese/përmirësuese dhe 11 punime emergjente, 6 më pak.

Kontrata D parashikuar, 56 punime rehabilituese/përmirësuese nga ku janë kryer me urdhër ndryshime 18 punime rehabilituese/përmirësuese dhe 16 punime emergjente, 22 më pak.

Për sa më sipër rezulton se kemi një numur më të vogël punimesh rehabilituese/përmirësuese dhe emergjente nga ato të parashikuara në kontratat fillestare dhe shtimi i ekspertëve për volumin e ritur të punës nuk qëndron dhe është i pa argumentuar.

12. Amendimi Nr.12 me Nr.6229Prot. datë 31.05.2022, nënshkruar nga z. E..... B..... ka miratuar afatet e përfundimit të shërbimit për satifik kryesor si dhe atë përfundimtar të kontratës i cili është 31.12.2021. Këto ndryshime nuk kanë ritur vlerën e kontratës por ajo ngelet e njëjtë me ato të miratuara në amendimin nr.11.

Nisur nga fakti se, punimet e rehabilitimit dhe përmirësimit për të katër kontratat nuk filluan sipas programit, tre muajt e parë projektim nga kontraktorët dhe vlerësim/miratim i tyre nga konsulenti, ARrSh me shkresën Nr.5332Prot. datë 28.06.2017 i kërkon konsulentit të pezulloj stafin jo kryesor (*non key staff*) që përshkrimi i punës së tyre lidhet me këto punime. Pezullimi i punës është kërkuar për Quantity Surveyors dhe QA Engineer për të katër kontratat deri në një njoftim të ri. Konsulenti I..... E..... S.R.L me shkresën No. IRD17-MR007-T datë 03.07.2017 sqaron se:

1. *Demobilizimi i ekspertëve jo kryesor për një kohë të pa caktuar nuk është praktike dhe përfituese pasi ata janë staf lokal dhe janë punësuar për një vit me kohë të plotë, nuk do të jetë e mundur të mobilizohen përsëri pas pezullimit. Pezullimi pa pagesë i stafit lokal nuk është parashikuar në kontratë dhe i trembemi këtij veprimi pasi konsulenti mund të ekspozohet para detyrimeve ligjore. Nga ana tjetër ne nuk mund të sigurojmë që ekspertët jo kryesor të përzgjedhur me kujdes dhe tashmë të trajnuar gjatë këtyre gjashtë muajve të zbatimit të kontratës nuk mund të jenë më në*

dipozicion kur të jetë e nevojshme. Ne rrezikojmë të humbasim staf me përvijë dhe harxhojmë kohë tjetër të gjejmë dhe trajnojmë tjetër të përshtatshëm, kur ata do të jenë të nevojiten me fillimin e punimeve rehabilituese.

2. QA dhe QC e MC janë të angazhuar plotësisht në procesin e rishikimit të projektit dhe ata kanë përgatitur komente të vlefshme që të kihen parasysh nga kontraktori në mënyrë që të saktësoj/përmirësoj projekt idetë e dërguara. Tashmë një list me komente për projektet është dërguar zyrtarisht tek kontratat A e B që të reflektohen nga kontraktorët dhe të kontrollohen përsëri nga konsulenti. Në pak ditë do të dërgohen komentet për kontratat C dhe D. Prezenca e QA/QC në këtë moment është e nevojshme për plotësimin e pritshmërive sasiore dhe cilësore të kërkuara nga konsulenti monitorues.

Referuar dokumentave të kontratës konkretisht, Informacion përmbledhës për stafin (Summary information about the staffing) në pikën b) theksohet se: kontributi i vlerësuar për stafin lokal jo-kyç për të cilin Konsulenti do të ketë njëfarë fleksibiliteti në përbërjen e ekipit të tyre në përputhje me planin dhe metodologjinë e tyre të punës. Gjithashtu në dokumentet e tenderit thuhet se: Plani i punës dhe afati kohor i Konsulentit përfundimisht do të bazohen në kornizën kohore të procedurave të tenderimit dhe zbatimit e projektit. Prandaj, ajo që vijon është një plan paraprak pune dhe orari kohor, i cili do të rishikohet gjatë fazës fillestare për të pasqyruar situatën në terren, dhe se çdo 6 muaj nga bërja efektive e kontratës së konsulentit, ARrSh dhe konsulenti duhet të rishikojnë kontributet (input) e stafit për 6 muajt e ardhshëm bazuar në dakortësinë e planifikimit të stafit. Konstatohet se nga ana e klientit ARrSh dhe konsulentit kontributet e stafit nuk janë rishikuar çdo 6 muaj sipas situatës në terren por vetëm janë miratuar sipas kërkesës së bërë nga ana e konsulentit. Në rast se do të ishte kryer ky rishikim, kontributet e stafit jo kryesor (non key staf: Materials/QA, Quantity Surveyor, Road inspector), deri në miratimin e amendamentit nr.1 datë 16.03.2018 i kontratave të zbatimit, do të rialokoheshin për një kohë të mëvonshme duke ju përshtatur zbatimit të kontratave të punimeve civile në terren. Gjithashtu vrehet se për periudhën Prill-Maj 2018 ky staf (non key staf: Materials/QA, Quantity Surveyor, Road inspector) nuk ka qenë i angazhuar në këtë kontratë shërbimi. Për sa më sipër argumentet e dhëna nga ana e konsulentit në letrën No. IRD17-MR007-T datë 03.07.2017 nuk qendrojnë dhe duhet të veprimeve sipas kërkesës së ARrSh-së.

Sipas dokumentacionit DST kontributet për stafin janë kërkuar që minimalisht të jenë sa ato të kërkuara. Në ofertën e tij konsulenti mund ti riste ato sipas shërbimit të kërkuar nga klienti dhe në përputhje me kushtet e kontratave të zbatimit. Në ofertën e tij konsulenti ka parashikua që për 12 muaj të ketë staf lokal, Materials/QA, Quantity Surveyor, Road inspector, për secilën kontratë ku afati përkon me kohën e përfundimit të punimeve rehabilituese dhe përmirësuese. Nisur nga fakti që ky staf (Materials/QA, Quantity Surveyor, Road inspector) do të jetë për këto punime, si e ka parashikuar vetë konsulenti në ofertë e tij) koha e ofrimit të shërbimit duhet të jetë e njëjtë. Ashtu siç është vepruar me dy expert e tjerë që kontributet e tyre janë reduktuar duhet të reduktohej edhe për inspektorin e rrugëve me zvogëlimin e volumit të punimeve rehabilituese, përmirësuese dhe emergjente, pra duhet të lihej një i tillë për të katër kontratat. Kostoja e shtuar për inspektorin e rrugëve në tre kontrata është 184,800 Euro pa TVSH (3x22muajx2,800 Euro/muaj).

Në kontratën e konsulencës krahas kontributeve për stafin kryesor dhe jo kryesor është parashikuar dhe një shumë e rimbursueshme prej 100,000 Euro e cila do të përdoret për, raportin iRAP në vlerën 39,960 Euro, dy reflektometra në vlerën 30,000 Euro dhe për teste të pa varuara që do ti duhen konsulentit në vlerën 30,000 Euro. Sipas faturave të vendosura në dipozicion rezulton se 18,678.75 Euro janë shpenzuar për reflektometrat dhe 60,000 Euro për testet iRAP, në total 78,678.75 Euro.

Në kontratën fillestare dhe sipas marrëveshjes financiare aktiviteti iRAP do të kryhej tre herë gjatë zbatimit të kontratave, në vitin e parë , të tretë dhe të pestë përpara 1 Nëntorit të këtyre viteve ku konsulenti ka ofruar shumën 39.960 Euro. Në amendamenti nr.7 datë Nr.4765Prot. datë 16.05.2019 është (pika viii) është dakortësuar që do të kryhen vetëm dy herë, dhe i dyti të kryhet në mesin e viti 2021. Ky ndryshim do të zvogëloj dhe koston për iRAP të cilën Konsulenti Monitorues duhet ta ndryshojë në përputhje me pikën 30 të kontratës. *(viii) In accordance with the discussions held during the Mid-Term Review of the RRMSP, the number of iRAP surveys to be carried out by the MC through an independent provider is reduced from three to two, with the second survey to be carried out in mid-2021. This shall reduce the overall cost for the iRAP surveys which the MC shall charge in accordance with para. 30 of the Contract.*

Derisa kostoja për tre testet iRAP ishte jo më shumë se 39,960 Euro, për dy duhet të jetë 26,640 Euro. Nga auditimi i dokumentacionit dhe raporteve të vendosura në dispozicion rezulton se iRAP është kryer dy herë dhe sipas faturave të paraqitura secili ka një kosto prej 30,000 Euro dhe në total 60,000 Euro, jo vetëm që nuk është zvogëluar por ka kaluar edhe vlerën e parashikuar në kontratë. Për sa më lart vlera e dy testeve iRAP nuk duhet të kalonte vlerën 26,640 Euro e për rrjedhojë konsulenti ka përfituar më tepër vlerën 33,360 Euro pa TVSH.

Më poshtë tabela përmbledhëse e kontributeve për stafin kryesor dhe jo kryesor e ndryshuar sipas çdo amendimi.

Nr	Position	Monthly rate Euro	Input Muaj	Amount Euro	Amend. Nr.5	Amend. Nr.6	Amend. Nr.7	Amend. Nr.9	Amend. Nr.10	Amend. Nr.11	Input Final	Final amount contract (Euro)
Key staff:												
1	Team Leader/Projekt Manager	19,800	66	1,306,800	-3.64			-3		2	61.46	1,216,908
2	Deputy Team Leader	13,500	36	486,000		12		8		3	59	796,500
3	Deputy Team Leader/2/RME	4,700								6	6	28,200
4	QA/QC Engineer	11,500	60	690,000				-8			52	598,000
5	Senior Bridge Engineer	9,500	6	57,000		-5		-0.45			0.55	5,225
6	Senior Environmental Specialist	9,500	18	171,000		-15		-1.86			1.14	10,830
7	Senior Traffic&Road Safety Expert	9,500	15	142,500				-1.5			13.5	128,250
8	Legal/Contact Expert	16,000	3	48,000		5	12				20	320,000
9	Road Desing Expert	9,500	0	0		6	12				18	171,000
10	Road Maintenance Engineer #1	4,700	60	282,000				-0.5		3	62.5	293,750
11	Road Maintenance Engineer #2	4,700	60	282,000				-0.5		3	62.5	293,750
12	Road Maintenance Engineer #3	4,700	60	282,000				-0.5		3	62.5	293,750
13	Road Maintenance Engineer #4	4,700	60	282,000				-0.5		3	62.5	293,750
14	Environmental Specialist Jr	4,300	60	258,000						2	62	266,600
Non Key Staff												
15	QA/Materials Engineer #A	3,100	12	37,200	2	12	12	12	7	3	60	186,000
16	QA/Materials Engineer #B	3,100	12	37,200	2	12	12				38	117,800
17	QA/Materials Engineer #C	3,100	12	37,200	2	12	12				38	117,800
18	QA/Materials Engineer #D	3,100	12	37,200	2	12	12				38	117,800
19	Road inspector #A	2,800	12	33,600	2	12	12	19		3	60	168,000
20	Road inspector #B	2,800	12	33,600	2	12	12	19		3	60	168,000

21	Road inspector #C	2,800	12	33,600	2	12	12	19		3	60	168,000
22	Road inspector #D	2,800	12	33,600	2	12	12	19		3	60	168,000
23	Quanty surveyor/design revieëer #A	3,100	12	37,200	2	12	12	12	7	3	60	186,000
24	Quanty surveyor/design revieëer #B	3,100	12	37,200	2	12	12				38	117,800
25	Quanty surveyor/design revieëer #C	3,100	12	37,200	2	12	12				38	117,800
26	Quanty surveyor/design revieëer #D	3,100	12	37,200	2	12	12				38	117,800
27	Hydraulic Engineer	3,100	0			2	4		1	2	9	27,900
28	Electrical Engineer	3,100	0			2	12		3	1	18	55,800
29	Geotechnical Expert	3,100	0			2	4		1	2	9	27,900
30	Translator/Secretary	1,350	60	81,000						2	62	83,700
31	Translator	900	0				12				12	10,800
32	Driver	800	0				31			3	34	27,200
	Vlera totale pa TVSH			4,800,300	0	559,600	835,600	198,205	58,900	248,080		6,700,613

Konkluzion:

1. Në vitin e parë, në zbatimin e kontratave për punimet civile, asnjë projekt për punimet e rehabilitimi dhe përmirësimin nuk është hartuar dhe zbatuar, kështu që, stafi lokal i parashikuar nga ana e konsulentit për vlerësimin e projekteve dhe ndjekjen e zbatimit të tyre sipas specifikimeve teknike në terren ka konsumuar kontributet e tyre pa ofruar shërbimin e kërkuar.

2. Nga ana e ARrSh dhe Konsulentit nuk janë rishikuar kontributet e stafit çdo 6 muaj sipas situatës në terren e përcaktuar në kontratën e konsulentit e cila do të bënte një menaxhim më të mirë të fondeve.

3. Ritja e kontributeve për stafin jo kryesor është i pa argumentuar dhe jo në përputhje me grafikun e punimeve të kontratave të zbatimit të cilat kanë rritur koston e kontratës fillestare. Nga ana e BOE, i kualifikuar si me ekpëriencë në monitorimin e kontratave të këtij lloji, nuk është bërë një vlerësim i drejtë në ofertën e tij i kontributeve të nevojshme të stafit lokal pasi në DST është theksuar minimumi i kontributeve të stafit.

5. Vlera e kontratës së konsulentit Nr.9999Prot. datë 05.12.2016 ka ndryshuar nga 5,880,360 Euro me TVSH në 8,160,462 Euro me TVSH pra kemi një ritje me 38%.

Nga auditimi i dokumentacionit të urdhër ndryshimeve u konstatuan:

1. Titulli i gjetjes:	Shpenzime pa efektivitet për stafin lokal gjatë vitit të parë të për monitorimin dhe kontrollin e punimeve rehabilituese dhe përmirësuese.
Situata:	Në kontratën me objekt shërbimi “ <i>Monitorim/ Supervizionim i katër Kontratave, Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate</i> ” janë parashikuar, staf jo kryesor, 12 punonjës për kontrollin dhe monitorimin e punimeve rehabilituese dhe përmirësuese në 12 muajt e parë të kontratave të zbatimit. Referuar zbatimit të kontratave të punimeve civile rezultoi se gjatë 12 muajve të parë deri në nënshkrimin e amendamentit nr.1 datë 16.03.2018, nuk janë realizuar punime rehabilituese dhe përmirësuese. Sipas kontratës çdo 6 muaj nga bërja efektive e kontratës së konsulentit, ARrSh dhe konsulenti duhet të rishikojnë kontributet (input) e stafit për 6 muajt e ardhshëm bazuar në dakortësinë e planifikimit të stafit e cila nuk është realizuar. Nga

	mosrealizimi i punimeve rehabilituese dhe përmirësuese në 12 muajt e parë të kontratave, kontributet e stafit lokal të parashikuara për kontrollin dhe monitorimin e këtyre punimeve janë përfituar nga konsulenti pa ofruar ndonjë shërbim sipas përshkrimit të punës (scope of work) të parashikuar në kontratë nga ky staf në vlerën prej 432,000 Euro pa TVSH. Gjithashtu nga mosrealizimi i punimeve rehabilituese dhe përmirësuese në vitin e parë janë shtuar dhe kontributet e Deputy Team Leader me 12 muaj në vlerën 162,000 Euro pa TVSH. Për sa më sipër vlera prej 594,000 Euro pa TVSH (432,000 stafi lokal + 162,000 Deputy Team Leader) konsiderohet shpenzim pa economicitet, eficientë dhe efektivitet i fondeve të projektit.
Kriteri:	Kontrata e shërbimit të konsulencës nr. 9999 prot. datë 05.12.2016, informacion përmbledhës për stafin, pika b, <i>“Plani i punës dhe afati kohor i Konsulentit përfundimisht do të bazohen në kornizën kohore të procedurave të tenderimit dhe zbatimin e projektit. Prandaj, ajo që vijon është një plan paraprak pune dhe orari kohor, i cili do të rishikohet gjatë fazës fillestare për të pasqyruar situatën në terren”</i> .
Ndikimi/Efekti:	Rritje e kostos së konsulencës e pa parashikuar në kontratë me pasojë përdorimin pa EEE në vlerën 594,000 Euro pa TVSH.
Shkaku:	Mos rialokim i kontributeve të stafit lokal sipas situatës në terren.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	ARRSH të marrë masa, për projektet në proces dhe të reja, të monitoroj kontratat e konsulencës dhe shtimi i kontributeve të stafit të jetë sipas situatës në terren duke shmangur kështu ritjen e kostove të kontratave.

2. Titulli i gjetjes:	Shtimi i kontributeve të stafit lokal të pa parashikuar në kontratën fillestare.
Situata:	Në kontratën me objekt shërbimi <i>“Monitorim/ Supervizionim i katër Kontratave, Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate”</i> sipas amendimit nr. 7 me Nr.4765Prot. datë 16.05.2019 janë shtuar kontribute për një shofer 31 muaj dhe një përkthyes për 12 muaj. Në ofertën fillestare nuk janë parashikuar shofera, për makinat e vendosura në dispozicion nga kontraktori, pasi janë marrë parasysh si shpenzime të rimbursueshme me kosto zero, dhe janë të shpërndara në pagesat e stafit. Për përkthimin e dokumentave sipas kontratës fillestare mbulohen nga sekretare/përkthyes e përcaktuar në përshkrimin e punës si dhe referuar materialeve të përkthyer të vendosura në dispozicion rezulton se janë vetëm disa raporte për të cilat nuk kanë patur nevojë për kohë 12 muaj. Për sa më sipër vlera prej 35,600 Euro pa TVSH (24,800 Euro shoferi + 10,800 Euro përkthyes) është përfituar më tepër nga konsulenti dhe përben dëm ekonomik në buxhetin e projektit.
Kriteri:	Kontrata e shërbimit të konsulencës nr. 9999 prot. datë 05.12.2016, Aneksi III, shtojca IV dhe D.
Ndikimi/Efekti:	Dëm ekonomik në buxhetin e projektit në vlerën 35,600 Euro pa TVSH.

Shkaku:	Shtim i kontributeve të stafit lokal të pa parashikuar .
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	ARrSh të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 35,600 Euro pa TVSH nga BOE “I..... E.... S.r.l & S... S.p.a & S..... S.p.a” me të cilin është lidhur kontrata Nr. 9999Prot. datë 05.12.02016, për monitorimin dhe konsulencën e katër kontratave të mirëmbajtjes.

3. Titulli i gjetjes:	Përgatitja e testeve iRAP mbi vlerën e parashikuar në kontratë.
Situata:	<p>Në kontratën me objekt shërbimi “<i>Monitorim/ Supervizionim i katër Kontratave, Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate</i>” krahas kontributeve për stafin kryesor dhe jo kryesor është parashikuar dhe një shumë e rimbursueshme prej 100,000 Euro e cila do të përdoret për, raportin iRAP në vlerën 39,960 Euro, dy reflektometra në vlerën 30,000 Euro dhe për teste të pa varuara që do ti duhen konsulentit në vlerën 30,000 Euro. Sipas faturave të vendosura në dipozicion rezulton se 18,678.75 Euro janë shpenzuar për reflektometrat dhe 60,000 Euro për testet iRAP, në total 78,678.75 Euro. Në kontratën fillestare dhe sipas marrëveshjes financiare aktiviteti iRAP do të kryhej tre herë gjatë zbatimit të kontratave, në vitin e parë, të tretë dhe të pestë përpara 1 Nëntorit të këtyre viteve ku konsulenti ka ofruar shumën 39.960 Euro. Në amendamenti nr.7 datë Nr.4765Prot. datë 16.05.2019 është (pika viii) është dakortësuar që do të kryhen vetëm dy herë, dhe i dyti të kryhet në mesin e viti 2021. Ky ndryshim do të zvogëloj dhe koston për iRAP të cilën Konsulenti Monitorues duhet ta ndryshojë në përputhje me pikën 30 të kontratës. <u>(viii) In accordance with the discussions held during the Mid-Term Review of the RRMSP, the number of iRAP surveys to be carried out by the MC through an independent provider is reduced from three to two, with the second survey to be carried out in mid-2021. This shall reduce the overall cost for the iRAP surveys which the MC shall charge in accordance with para. 30 of the Contract.</u></p> <p>Derisa kostoja për tre testet iRAP ishte jo më shumë se 39,960 Euro, për dy duhet të jetë 26,640 Euro. Nga auditimi i dokumentacionit dhe raporteve të vendosura në dispozicion rezulton se iRAP është kryer dy herë dhe sipas faturave të paraqitura secili ka një kosto prej 30,000 Euro dhe në total 60,000 Euro, jo vetëm që nuk është zvogëluar por ka kaluar edhe vlerën e parashikuar në kontratë. Për sa më lart vlera e dy testeve iRAP nuk duhet të kalonte vlerën 26,640 Euro e për rrjedhojë konsulenti ka përfituar më tepër vlerën 33,360 Euro pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.</p>
Kriteri:	Kontrata e shërbimit të konsulencës nr. 9999 prot. datë 05.12.2016, dhe amendimi nr.7 datë 16.05.2019, pika (viii).
Ndikimi/Efekti:	Dëm ekonomik në buxhetin e projektit në vlerën 33,360 Euro pa TVSH.

Shkaku:	Zvogëlim i numrit të testeve iRAP i pa shoqëruar me ulje të kostos..
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	ARRSH të marri masa, për arkëtimin e shumës 33,360 Euro pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit nga BOE "I.... E S.r.l & S S.p.a & S S.p.a" me të cilin është lidhur kontrata Nr. 9999Prot. datë 05.12.02016, për monitorimin dhe konsulencën e katër kontratave të mirëmbajtjes..

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.7 datë 10.03.2023 dhe për këtë çështje z. J..... H I... në cilësinë e Team Leader i konsulentit, ka dërguar observacionet datë 10.05.2023 në ARrSh dhe përcjellë me emali në KLSH datë 22.05.2023:

Pretendimi i subjektit:

Për sa i përket shoferit dhe përkthyeses shtesë ju sqaroni se, Kontrata e Konsulentit Monitorues ishte e tipit "Baze - Kohore" dhe faturimi i stafit bazohej me anë të "kohë shënuesve" mujore që dokumentonin të dhënat e çdo eksperti individualisht. "Kohë shënuesit" janë pranuar nga ana e ARRSH-se, e cila më pas e ka paguar IRD-në mbi këtë bazë. Si konkluzion, ju vëmë në dijeni se punësimi i një shoferi dhe i një përkthyesjeje është bërë me mirëbesim, bazuar në nevojat aktuale të projektit siç është rënë dakord me ARRSH-ne dhe siç është zyrtarizuar në marrëveshjen me shkrim në Amendimin 7 ndërmjet ARRSH dhe IRD, i cili ka patur "mos-kundërshtimin" nga Banka Botërore.

Siç duket çështja e faturimit tonë për kryerjen e sondazheve të iRAP-it kërkon një sqarim, të cilin po e japim si më poshtë. Sqarimet e dhëna bazohen në një rishikim të plotë të dispozitave përkatëse në kontratën ndërmjet ARRSH-së dhe IRD-së: Në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Klauzola 42.1 citohet: Klienti duhet t'i paguajë Konsulentit (i) shpërblimin; dhe (ii) shpenzimet e rimbursueshme që janë shkaktuar realisht dhe në mënyrë të arsyeshme nga Konsulenti në kryerjen e Shërbimeve." Kështu, kjo klauzolë konfirmon se rimbursimet që ARRSH-ja do t'i bëjë IRD-së nuk janë për shuma të përgjithshme hipotetike, por për shpenzime faktike të bëra nga IRD. Shpenzimet janë kryer në mënyrë të arsyeshme pasi ato ishin një kërkesë e Termave të Referencës për të cilat janë dorëzuar raportet përfundimtare në formatin e kërkuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Ju theksoni se punësimi i një shoferi dhe i një përkthyesjeje është bërë me mirëbesim dhe se faturimi me anë të kohë "kohë shënuesve" mujor. Ju sqarojmë se, ndryshimet e kontratës nuk kryhen në mirëbesim por sipas kushteve dhe klauzolave të saj si dhe nga verifikimet tona tregon se këta dy punonjës nuk kanë qenë pjesë e listë pagesave të paraqitura në organet tatimore nga ana juaj ku sipas kushteve të kontratës stafi lokal nuk duhej të nënkontraktuhej.

Për pagesat e iRAP ju keni listuar klauzolat e parashikuara në kontratë për shpenzimet e rimbursueshme por nuk keni përmendur faktin e nënvizuar në amendimin nr.7 ku thuhet se ulja e numrit të testeve iRAP nga tre në dy do të reduktojë dhe koston. Në ToR pika 30 ju theksoni se kostot e përlllogaritura në thelb bazohen në një zbrërthim zërash, pra ju nuk i keni qëndruar këtij zbrërthimi dhe në amendamentin nr. 7 nuk keni alokuar fonde nga shuma për testimet e pa varura në koston për iRAP por vetëm keni theksuar uljen e kostos. Gjithashtu kostot për iRAP të paraqitura nga ana juaj në ofertë bazohen në eksperiencën tuaj në këto lloj kontratash për të cilën jeni përzgjedhur. Për sa më sipër pretendimet tuaja nuk merret parasysh.

2. Auditimi me zgjedhje mbi verifikimin e zbatimit të punimeve civile.

Kontrata A mbulon Rajonin Verior (Shkodër & Kukës) ku gjatësia totale e rrugëve që mbulohen me shërbim e mirëmbajtjes dhe sigurisë rrugore të bazuar në rezultate është 278.99 km. Për zbatimin është lidhur kontrata Nr.511/1 datë 23.01.2017 midis ARrSh dhe BOE B..... A.T.E.V.E & G..... ltd me vlerë të kontratës 21,205,783.99 Euro me TVSH dhe me aplikim zbritje 2.5%. Afati i kësaj kontrate është 60 muaj por jo më von se 31.12.2021. Për një kalim më të mirë tek kontratat pasardhëse afati i saj është zgajtur deri më 31.03.2022.

Kontrata është ndryshuar me katër amendime, konkretisht:

Amendimi nr.1 me Nr.2139Prot. datë 16.03.2018 ku është dakortësuar ndryshimi i specifikimeve teknike, zgjatja e afatit të punimeve rehabilituese dhe përmirësuese në 25 muaj nga fillimi i kontratës. Gjithashtu me ndryshin e klauzolës 47.2 dhe 47.3 është dakortësuar që punimet rehabilituese dhe përmirësuese do të paguhen si punime të matshme dhe jo lump sum siç janë ofertuar nga kontraktori.

Amendimi nr.2 me Nr.10014Prot. datë 12.11.2018 ku është ndryshuar dhe qartësuar disa specifikime teknike si dhe ndryshimi i disa klauzolave të kushteve të veçanta të kontratës. Në këtë amendament janë rishikuar penalitetet për masat e menaxhimit të performancës (MPM) të cilat janë rishikuar ndjeshëm nga ato të parashikuara në kontratën fillestare.

Amendimi nr.3 me Nr.9316Prot. datë 16.10.2019 ku është ndryshuar afati i përfundimit të punimeve përmirësuese nga 25 muaj, që ishte përcaktuar në amendimin nr.2, në 28 muaj. Janë ndryshuar specifikime teknike si dhe në penalitetet e dakortësuar në amendimin nr.2 në këtë është shtuar MPM-6.1 “Raporti i përfundimit të punëve” sipas seksionit B.3.6.5 të specifikimeve ku penalitetido të jetë 75 Euro për çdo ditë vonesë në dërgimin e këtij raporti. Gjithashtu në këtë amendament janë rishikuar penalitetet për MPM-4.2, MPM-5 dhe MPM-9 pasi ato janë të mbivendosura dhe janë aplikuar nga dy herë për të njëjtin mosplotësim të kushteve të kontratës.

Amendimi nr.4 Nr.9654Prot. datë 26.10.2021 ka zgjatur afatin e përfundimit të kontratës deri më 31.03.2022 si dhe ka ndryshuar afatet e dorzimit të raportit përfundimtar që duhej të dërgohej gjashtë muaj para përfundimit të kontratës. Si afat të dorëzimit të raportit përfundimtar është përcaktuar data 31.12.2021.

Në kontratatën A ishin parashikuar të kryheshin, 54 punime rehabilituese, përmirësuese të ofertuara lump sum. Sipas dokumentacionit me urdhër ndryshime janë kryer 13 punime rehabilituese, përmirësuese dhe 10 punime emergjente të cilat janë paguar si punime të matshme. Me ndryshimet e kryera kontrata është ritur në masën 10.5% nga ajo fillestare e cila është brenda kushteve të marrëveshjes financiare në të cilën është rënë dakort që rritja nuk duhet të kalojë masën 15%.

Në tabelën e më poshtme tregohet si kanë ndryshuar vlerat për secilin aktivitet të kontratës.

Nr.		Vlera fillestare e kontratës (Euro)	Vlera finale e kontratës (Euro)
	<i>Vlera (pa TVSH ose zbritje)</i>	18,124,601.70	20,041,569.32
1	Mirëmbajta rutinë	7,091,629.20	7,247,753.39
2	Punime rehabilituese	8,768,718.00	11,159,054.89
3	Punime përmirësuese	198,429.50	99,397.66
4	Punime emergjente	2,065,825.00	1,761,541.16
5	Penalitetet e zbritshme		-226,177.78
6	TVSH 20%	3,624,920.34	4,008,313.86
7	Zbritja e ofruar 2.5%	-543,738.05	-601,247.08
	Vlera totale	21,205,783.99	23,448,636.10

Punimet rehabilituese dhe përmirësuese sipas kontratës fillestare duhet të përfundonin 12 muajt e parë të kontratës por me ndryshimet e bëra afati i përfundimit të tyre është zgjatuar në 25 muaj nga fillimi i kontratës. Konstatohet se edhe pas afatit 25 mujor për punimet rehabilituese dhe 28 muaj për punimet përmirësuese të përcaktuar në amendimin nr. 3, Nr.9316Prot. datë 16.10.2019 këto punime nuk kanë përfunduar por kanë vazhduar deri në afatin përfundimtar të kontratës.

Në këtë kontratë janë mbajtur penalitete të zbritshme për masat e menaxhimit të performancës (MPM), masat e performances së operimit (OPM) dhe likuidim i dëmtimeve (LD) sipas klauzolës 57.2 të Kushteve të Veçanta të Kontratës (KVK) në vlerën totale prej 226,177.78 Euro Pa TVSH. Nga këto, 76,097 Euro janë penalitete për MPM; 129,625.42 Euro penalitete për OPM dhe 20,455.36 Euro penalitete për LD, PC 57.2.

Për punimet rehabilituese/përmirësuese dhe ato të emergjente nuk u verifikuan volumet e punimeve të kryera në terren pasi ato janë punime të maskuara dhe ka përfunduar garancia e tyre. Gjithashtu mirëmbajtja e tyre kryhet nga një kontratë e re e cila mund të ketë kryer punime të tjera të nevojshme për të ofruar shërbimin e kërkuar.

Kontrata B mbulon Rajonin Tiranë –Dibër (Shqipëria Qendrore/Veri Lindore) ku gjatësia totale e rrugëve që mbulohen me shërbim e mirëmbajtjes dhe sigurisë rrugore të bazuar në rezultate është 286 km. Për zbatimin është lidhur kontrata Nr.511/2 datë 23.01.2017 midis ARrSh dhe BOE B..... A.T.E.V.E & G..... ltd me vlerë të kontratës 19,205,601.48 Euro me TVSH dhe me aplikim zbritje 2.5%.. Afati i kësaj kontrate është 60 muaj por jo më von se 31.12.2021. Për një kalim më të mirë tek kontratat pasardhëse afati i saj është zgajtur deri më 31.03.2022.

Kontrata është ndryshuar me katër amendime, konkretisht;

Amendimi nr.1 me Nr.2139/1Prot. datë 16.03.2018 ku është dakortësuar ndryshimi i specifikimeve teknike, zgjatja e afatit të punimeve rehabilituese dhe përmirësuese në 25 muaj nga fillimi i kontratës. Gjithashtu me ndryshin e klauzolës 47.2 dhe 47.3 është dakortësuar që punimet rehabilituese dhe përmirësuese do të paguheshin si punime të matshme dhe jo lump sum siç janë ofertuar nga kontraktori.

Amendimi nr.2 me Nr.10015Prot. datë 12.11.2018 ku është ndryshuar dhe qartësuar disa specifikime teknike si dhe ndryshimi i disa klauzolave të kushteve të veçanta të kontratës. Në këtë amendament janë rishikuar penalitetet për masat e menaxhimit të performancës (MPM) të cilat janë rishikuar ndjeshëm nga ato të parashikuara në kontratën fillestare.

Amendimi nr.3 me Nr.9317Prot. datë 16.10.2019 ku është ndryshuar afati i përfundimit të punimeve përmirësuese nga 25 muaj, që ishte përcaktuar në amendimin nr.2, në 28 muaj. Janë ndryshuar specifikime teknike si dhe në penalitetet e dakortësuara në amendimin nr.2 në këtë është shtuar MPM-6.1 “Raporti i përfundimit të punëve” sipas seksionit B.3.6.5 të specifikimeve ku penalitetido të jetë 75 Euro për çdo ditë vonesë në dërgimin e këtij raporti. Gjithashtu në këtë amendament janë rishikuar penalitetet për MPM-4.2, MPM-5 dhe MPM-9 pasi ato janë të mbivendosura dhe janë aplikuar nga dy herë për të njëjtin mosplotësim të kushteve të kontratës.

Amendimi nr.4 Nr.9655Prot. datë 26.10.2021 ka zgjatuar afatin e përfundimit të kontratës deri më 31.03.2022 si dhe ka ndryshuar afatet e dorzimit të raportit përfundimtar që duhej të dërgohej gjashtë muaj para përfundimit të kontratës. Si afat të dorëzimit të raportit përfundimtar është përcaktuar data 31.12.2021.

Në kontratatën A ishin parashikuar të kryeshin, 59 punime rehabilituese/përmirësuese të ofertuara lump sum. Sipas dokumentacionit me urdhër ndryshime janë kryer 18 punime rehabilituese përmirësuese dhe 16 punime emergjente të cilat janë paguar si punime të matshme.

Me ndryshimet e kryera kontrtara është ritur në masën 9.96% nga ajo fillestare e cila është brenda kushteve të marrëveshjes financiare në të cilën është rënë dakort që rritja nuk duhet të kalojë masën 15%.

Në tabelën e më poshtme tregohet si kanë ndryshuar vlerat për secilin aktivitet të kontratës.

Nr.		Vlera fillestare e kontratës (Euro)	Vlera finale e kontratës (Euro)
	<i>Vlera (pa TVSH ose zbritje)</i>	16,415,044.00	18,051,527.02
1	Mirëmbajta rutinë	6,391,884.00	6,185,220.21
2	Punime rehabilituese	8,066,681.50	10,366,348.78
3	Punime përmirësuese	64,653.50	26,217.00
4	Punime emergjence	1,891,825.00	1,776,916.95
5	Penalitetet e zbritshme		-411,815.46
6	Limit Risku sipas TS B.3.6.4		108,639.54
7	TVSH 20%	3,283,008.80	3,610,305.40
8	Zbritja e ofruar 2.5%	-492,451.32	-541,545.81
	Vlera totale	19,205,601.48	21,120,286.61

Punimet rehabilituese dhe përmirësuese sipas kontratës fillestare duhet të përfundonin 12 muajt e parë të kontratës por me ndryshimet e bëra afati i përfundimit të tyre është zgjatur në 25 muaj nga fillimi i kontratës. Konstatohet se edhe pas afatit 25 mujor për punimet rehabilituese dhe 28 muaj për punimet përmirësuese të përcaktuar në amendimin nr. 3, Nr.9316Prot. datë 16.10.219 këto punime nuk kanë përfunduar por kanë vazhduar deri në afatin përfundimtar të kontratës.

Në këtë kontratë janë mbajtur penalitete të zbritshme për masat e menaxhimit të performancës (MPM), masat e performances së operimit (OPM) dhe likuidim i dëmtimeve (LD) sipas klauzolës 57.2 të Kushteve të Veçanta të Kontratës (KVK) në vlerën totale prej 411,815.46 Euro Pa TVSH. Nga këto, 47,072 Euro janë penalitete për MPM; 289,326.35 Euro penalitete për OPM dhe 75,426.11 Euro penalitete për LD, PC 57.2.

Për punimet rehabilituese/përmirësuese dhe ato të emergjente nuk u verifikuan volumet e punimeve të kryera në terren pasi ato janë punime të maskuara dhe ka përfunduar garancia e tyre. Gjithashtu mirëmbajtja e tyre kryhet nga një kontratë e re e cila mund të ketë kryer punime të tjera të nevojshme për të ofruar shërbimin e kërkuar.

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion konstatohet se kontraktori sipas Specifikimeve teknike B.3.6.4 Limitim Risku ka përfituar vlerën prej 108,639.54 Euro pa TVSH. Nga kjo vlerë është likuiduar 39,918.17 Euro pa TVSH për vjedhjen e kabllit të ndriçimit të rrugës në segmentin Qafë Kashar – Rinas dhe pjesa tjetër për riparimin e dëmeve të ndodhura nga aksidentet rrugore. Kontraktori me letrën nr. 078 datë 20.09.2017 njofton ARrSh se në segmentin Qafë Kashar- Rinas pjesë e kontratës B, është vjedhur kabli elektrik për ndriçimin e rrugës në gjatësinë 4500 ml. Gjithashtu me shkresën nr.079 datë 26.09.2017 njofton vjedhjen e 300 ml kabëll.

Referuar këtij rasti, PMT i është drejtuar me email MC për mendim. MC me letrën e datës 25.11.2017 drejtuar ARRSH dhe për dijeni kontraktorit të kontratës B ku sqaron se:

1. specifikimet i referohen vetëm shtyllave dhe llapave si përgjegjesi e kontraktorit por ato nuk përmendin elemente të furnizimit me energji si kabllat nëntokësor dhe kabinat elektrike.
2. Në Sqarimet nr.1 të DT lëshuar më 27.06.2016 në përgjigje të pyetjes 29, që i referohet kabllave dhe kabinave është bere e qartë se ato janë pjesë e sistemit të ndriçimit , e kështu janë nën përgjegjësinë e kontraktorit.

Referuar specifikimeve teknike 3.5.5 të kontratës fillestare riparimi i dëmtimeve të aseteve të rrugës është në riskun e kontraktorit. Me amendimin nr.1 datë 16.03.2018 ku është rënë dakort

rishikimi i specifikimeve teknike për dëmtimin e aseteve të rrugës B.3.6.4 thuhet se të gjitha riparimi i dëmtimeve të vogla do të mbulohet nga kontraktori deri në vlerën 3,500 Euro për rast dhe pjesa tjetër nga punëdhënësi dhe risku i kontraktorit është maksimumi 35,000 Euro në vit kalendarik. Gjithashtu në amendimin nr.3 datë 16.10.2019 është miratuar që ndryshimet e bërë në specifikimet teknike, për dëmtimin e aseteve, të kenë efekt edhe para datës 16.03.2018. Ky ndryshim e shmang kontraktorin nga të gjitha kostot e dëmtimeve të shaktuara para hyrjes në fuqi të specifikimeve të rishikuara.

Kontrata C mbulon Rajonin Fier-Elbasan Korçë (Shqipëria Qendrore/Jugore/ Lindore) ku gjatësia totale e rrugëve që mbulohen me shërbim e mirëmbajtjes dhe sigurisë rrugore të bazuar në rezultate është 419.42 km. Për zbatimin është lidhur kontrata Nr.1475 datë 23.02.2017 midis ARrSh dhe OE “R..... A..... C..... E.....” me vlerë të kontratës 13,531,838.01 Euro me TVSH dhe me aplikim zbritje 3%. Afati i kësaj kontrate është 60 muaj por jo më von se 31.12.2021. Për një kalim më të mirë tek kontratat pasardhëse afati i saj është zgajtur deri më 31.03.2022.

Kontrata është ndryshuar me katër amendime, konkretisht:

Amendimi nr.1 me Nr.2139/2Prot. datë 16.03.2018 ku është dakortësuar ndryshimi i specifikimeve teknike, zgjatja e afatit të punimeve rehabilituese dhe përmirësuese në 25 muaj nga fillimi i kontratës. Gjithashtu me ndryshin e klauzolës 47.2 dhe 47.3 është dakortësuar që punimet rehabilituese dhe përmirësuese do të paguhen si punime të matshme dhe jo lump sum siç janë ofertuar nga kontraktori.

Amendimi nr.2 me Nr.10016Prot. datë 12.11.2018 ku është ndryshuar dhe qartësuar disa specifikime teknike si dhe ndryshimi i disa klauzolave të kushteve të veçanta të kontratës. Në këtë amendament janë rishikuar penalitetet për masat e menaxhimit të performancës (MPM) të cilat janë rishikuar ndjeshëm nga ato të parashikuara në kontratën fillestare.

Amendimi nr.3 me Nr.9318Prot. datë 16.10.2019 ku është ndryshuar afati i përfundimit të punimeve përmirësuese nga 25 muaj, që ishte përcaktuar në amendimin nr.2, në 28 muaj. Janë ndryshuar specifikime teknike si dhe në penalitetet e dakortësuara në amendimin nr.2 në këtë është shtuar MPM-6.1 “Raporti i përfundimit të punëve” sipas seksionit B.3.6.5 të specifikimeve ku penalitetido të jetë 75 Euro për çdo ditë vonesë në dërgimin e këtij raporti. Gjithashtu në këtë amendament janë rishikuar penalitetet për MPM-4.2, MPM-5 dhe MPM-9 pasi ato janë të mbivendosura dhe janë aplikuar nga dy herë për të njëjtin mosplotësim të kushteve të kontratës.

Amendimi nr.4 Nr.9651Prot. datë 26.10.2021 ka zgjatur afatin e përfundimit të kontratës deri më 31.03.2022 si dhe ka ndryshuar afatet e dorzimit të raportit përfundimtar që duhej të dërgohej gjashtë muaj para përfundimit të kontratës. Si afat të dorzimit të raportit përfundimtar është përcaktuar data 31.12.2021. Në kontratatën A ishin parashikuar të kryeshin, 50 punime rehabilituese, përmirësuese të ofertuara lump sum. Sipas dokumentacionit me urdhër ndryshime janë kryer 33 punime rehabilituese/përmirësuese dhe 11 punime emergjente të cilat janë paguar si punime të matshme. Me ndryshimet e kryera kontrata është ritur në masën 9.4% nga ajo fillestare e cila është brenda kushteve të marrëveshjes financiare në të cilën është rënë dakort që rritja nuk duhet të kalojë masën 15%.

Në tabelën e më poshtme tregohet si kanë ndryshuar vlerat për secilin aktivitet të kontratës.

Nr.		Vlera fillestare e kontratës (Euro)	Vlera finale e kontratës (Euro)
	<i>Vlera (pa TVSH ose zbritje)</i>	11,625,290.41	12,728,905.20
1	Mirëmbajta rutinë	6,424,812.00	6,064,067.55
2	Punime rehabilituese	2,896,893.41	5,136,136.52
3	Punime përmirësuese	946,035.00	925,284.91

4	Punime emergjence	1,357,550.00	1,071,047.83
5	Penalitetet e zbritshme		-467,631.61
6	Zbritja e ofruar 3%	-348,758.71	-381,867.16
7	TVSH 20%	2,255,306.34	2,469,407.61
	Vlera totale	13,531,838.04	14,816,445.65

Punimet rehabilituese dhe përmirësuese sipas kontratës fillestare duhet të përfundonin 12 muajt e parë të kontratës por me ndryshimet e bëra afati i përfundimit të tyre është zgjatur në 25 muaj nga fillimi i kontratës. Konstatohet se edhe pas afatit 25 mujor për punimet rehabilituese dhe 28 muaj për punimet përmirësuese të përcaktuar në amendimin nr. 3, Nr.9316Prot. datë 16.10.2019 këto punime nuk kanë përfunduar por kanë vazhduar deri në afatin përfundimtar të kontratës.

Në këtë kontratë janë mbajtur penalitete të zbritshme për masat e menaxhimit të performancës (MPM), masat e performances së operimit (OPM) dhe likuidim i dëmtimeve (LD) sipas klauzolës 57.2 të Kushteve të Veçanta të Kontratës (KVK) në vlerën totale prej 381,867.16 Euro Pa TVSH. Nga këto, 162,300 Euro janë penalitete për MPM; 237,824.40 Euro penalitete për OPM dhe 67,507.21 Euro penalitete për LD, PC 57.2. Për punimet rehabilituese/përmirësuese dhe ato të emergjente u verifikua vetëm urdhër ndryshimi C07, punime emergjente, pasi ato ishin jashtë trupit të rrugës dhe të dukshme në pjesën më të madhe. Për pjesën tjetër të urdhër ndryshimeve nuk u verifikuan volumet e punimeve të kryera në terren pasi ato janë punime të maskuara dhe ka përfunduar garancia e tyre. Gjithashtu mirëmbajtja e tyre kryhet nga një kontratë e re e cila mund të ketë kryer punime të tjera të nevojshme për të ofruar shërbimin e kërkuar.

Kontrata D mbulon Rajonin Vlorë-Gjirokastrë (Shqipëria Jugore) ku gjatësia totale e rrugëve që mbulohen me shërbim e mirëmbajtjes dhe sigurisë rrugore të bazuar në rezultate është 350.66 km. Gjatësia totale është shtuar ose zbritur në varësi të përfundimit dhe zbatimit të punimeve rehabilituese për segmente të caktuara nga projekte të tjera. Për zbatimin është lidhur kontrata Nr.549/1 datë 24.01.2017 midis ARrSh dhe BOE “El..... C..... S..... A..... (E.....) & S..... sh.p.k” me vlerë të kontratës 16,543,350.20 Euro me TVSH. Afati i kësaj kontrate është 60 muaj por jo më von se 31.12.2021. Për një kalim më të mirë tek kontratat pasardhëse afati i saj është zgjatur deri më 31.03.2022.

Kontrata është ndryshuar me katër amendime, konkretisht;

Amendimi nr.1 me Nr.2139/3Prot. datë 16.03.2018 ku është dakortësuar ndryshimi i specifikimeve teknike, zgjatja e afatit të punimeve rehabilituese dhe përmirësuese në 25 muaj nga fillimi i kontratës. Gjithashtu me ndryshin e klauzolës 47.2 dhe 47.3 është dakortësuar që punimet rehabilituese dhe përmirësuese do të paguheshin si punime të matshme dhe jo lump sum siç janë ofertuar nga kontraktori.

Amendimi nr.2 me Nr.10017Prot. datë 12.11.2018 ku është ndryshuar dhe qartësuar disa specifikime teknike si dhe ndryshimi i disa klauzolave të kushteve të veçanta të kontratës. Në këtë amendament janë rishikuar penalitetet për masat e menaxhimit të performancës (MPM) të cilat janë rishikuar ndjeshëm nga ato të parashikuara në kontratën fillestare.

Amendimi nr.3 me Nr.9319Prot. datë 16.10.2019 ku është ndryshuar afati i përfundimit të punimeve përmirësuese nga 25 muaj, që ishte përcaktuar në amendimin nr.2, në 28 muaj. Janë ndryshuar specifikime teknike si dhe në penalitetet e dakortësuar në amendimin nr.2 në këtë është shtuar MPM-6.1 “Raporti i përfundimit të punëve” sipas seksionit B.3.6.5 të specifikimeve ku penalitetido të jetë 75 Euro për çdo ditë vonesë në dërgimin e këtij raporti. Gjithashtu në këtë amendament janë rishikuar penalitetet për MPM-4.2, MPM-5 dhe MPM-9 pasi ato janë të mbivendosura dhe janë aplikuar nga dy herë për të njëjtin mosplotësim të kushteve të kontratës.

Amendimi nr.4 me nr.9656Prot. datë 26.10.2021 ka zgjatur afatin e përfundimit të kontratës deri më 31.03.2022 si dhe ka ndryshuar afatet e dorzimit të raportit përfundimtar që duhej të dërgohej gjashtë muaj para përfundimit të kontratës. Si afat të dorzimit të raportit përfundimtar është përcaktuar data 31.12.2021.

Në kontratën D ishin parashikuar të kryheshin, 56 punime rehabilituese/përmirësuese të ofertuara lump sum. Sipas dokumentacionit me urdhër ndryshime janë kryer 18 punime rehabilituese përmirësuese dhe 16 punime emergjente të cilat janë paguar si punime të matshme. Me ndyshimet e kryera kontrata është ritur në masën 9.44% nga ajo fillestare e cila është brenda kushteve të marrëveshjes financiare në të cilën është rënë dakort që rritja nuk duhet të kalojë masën 15%.

Në tabelën e më poshtme tregohet si kanë ndryshuar vlerat për secilin aktivitet të kontratës.

Nr.		Vlera fillestare e kontratës (Euro)	Vlera finale e kontratës (Euro)
	<i>Vlera (pa TVSH ose zbritje)</i>	13,786,125.17	15,087,900.60
1	Mirëmbajta rutinë	7,736,916.00	7,924,960.99
2	Punime rehabilituese	4,403,669.17	6,128,422.63
3	Punime përmirësuese	0	0
4	Punime emergjente	1,645,540.00	1,369,693.83
5	Penalitetet e zbritshme		-335,176.85
6	TVSH 20%	2,757,225.03	3,017,580.12
	Vlera totale	16,543,350.20	18,105,480.72

Punimet rehabilituese dhe përmirësuese sipas kontratës fillestare duhet të përfundonin 12 muajt e parë të kontratës por me ndryshimet e bëra afati i përfundimit të tyre është zgjatur në 25 muaj nga fillimi i kontratës. Konstatohet se edhe pas afatit 25 mujor për punimet rehabilituese dhe 28 muaj për punimet përmirësuese të përcaktuar në amendimin nr. 3, Nr.9319Prot. datë 16.10.2019 këto punime nuk kanë përfunduar por kanë vazhduar deri në afatin përfundimtar të kontratës.

Në këtë kontratë janë mbajtur penalitete të zbritshme për masat e menaxhimit të performancës (MPM), masat e performances së operimit (OPM) dhe likuidim i dëmtimeve (LD) sipas klauzolës 57.2 të Kushteve të Veçanta të Kontratës (KVK) në vlerën totale prej 355,176.85 Euro Pa TVSH. Nga këto, 93,750 Euro janë penalitete për MPM; 196,652.50 Euro penalitete për OPM dhe 64,774 Euro penalitete për LD, PC 57.2.

Për punimet rehabilituese/përmirësuese dhe ato të emergjente nuk u verifikuan volumet e punimeve të kryera në terren pasi ato janë punime të maskuara dhe ka përfunduar garancia e tyre. Gjithashtu mirëmbajtja e tyre kryhet nga një kontratë e re e cila mund të ketë kryer punime të tjera të nevojshme për të ofruar shërbimin e kërkuar.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetja nga auditimi: Në marrëveshjen e huasë, viti i fillimit të Projektit (viti 1) do të ishte viti 2016 dhe viti i përfundimit (viti 5) do të ishte viti 2021 por konstatohet se periudha kohore e fillimit është viti 2017 dhe jo ai I parashikuar në marrëveshje. Kjo shtyrje ka ardhur si rezultati i vonesave të procesit të prokurimit, lidhjes të kontratave (në janar dhe shkurt të vitit 2017), mos njohja e disa komponentëve të projektit nga palët, të cilat kanë sjell disbursimin e vlerat e parashikuara në këtë marrëveshje me vonesë. Bankës Botërore, me shkresën datë 29.03.2021 “Amendimi i marrëveshjes së huasë”, amendimet konsistuan në konsiderimin e vitit 1 të periudhës 10 mujore duke filluar nga Marsi 2017 e deri në 31 Dhjetor 2017 dhe data e përfundimit të Projektit është 31 Dhjetor 2022. Shuma origjinale e kontratës ishte në vlerën 70,486,573.71 Euro, e cila pas rishikimeve të kontratës arriti në vlerën përfundimtare 85,651,671.08 Euro. Referuar përcaktimeve të Marrëveshjes, problematikat e krijuara gjatë realizimit të këtij Projekti mund të sillnin për pasojë anulimin ose rialokimin e shumës të përcaktuar për kategorinë 1 “*Mallra, punime, shërbime të konsulentëve dhe trajnim për pjesët 1 dhe 2 të Projektit*” në një kategori më poshtë, pra shërbime konsulence dhe kosto operative, duke mos realizuar objektivat dhe qëllimet kryesore të Projektit. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligji nr. 71, datë 02.07.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate”, seksioni IV, pika B, 4d. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 16-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: ARRSH në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (ministra e linjës) dhe Ministrinë e Financave (si përfaqësuese e huamarrësit) të marrin masa që të bashkërendojnë punën dhe në çdo rast të kryejnë kërkesat për amendimin e marrëveshjeve të huave brenda afateve të marrëveshjeve duke ulur riskun e ndërprerjes së financimit.

Në vijimësi

2. Gjetje nga Auditimi: Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion u konstatua janë larguar nga puna Menaxheri i Projektit dhe Specialistja e Menaxhimit Financiar. Në datën 28.02.2018 është pushuar nga puna Menaxheri i Projektit me motivacion performancë e dobët gjatë ushtrimit të detyrës, pasi me shkresën nr. 9168/2 prot, datë 06.12.2017 “Kërkesë zyrtare për dorëheqje” nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH, i është kërkuar Menaxherit të Projektit dorëheqja zyrtare. Pas Largimit nga detyra Menaxheri i Projektit ka hapur proces gjyqësor kundër ARRSH për pushim të padrejtë nga detyra. Me vendim nr. 6086, datë 05.07.2018 Gjykata e Shkallës së Parë të Tiranës ka vendosur pranimin e kërkesë-padisë dhe dëmshpërblimin e paditësit me dyzetë e dy paga (42*1.500=63.000 Euro). Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë me shkresë nr. 7109/1 prot, datë 24.08.2018, ku kjo gjykatë nuk ka dalë ende me një vendim.

Në pozicionin e Specialistes së Menaxhimit Financiar është emëruar në datën 02.03.2018 znj. E..... A....., e cila më pas është pushuar nga puna për performancë të dobët në detyrë, në datën 16.07.2019. Me vendim nr. 6086, datë 05.07.2018 Gjykata e Shkallës së Parë të Tiranës ka vendosur pranimin e kërkesë-padisë dhe dëmshpërblimin e paditësit me njëzetë e një paga (42*1.500=63.000 Euro).

-Me Vendimin Nr. 3700, datë 31.05.2021, Gjykata e Shkallës të Parë, Tiranë vendosur pranimin e kërkesë-padisë dhe dëmshpërblimin e paditësit me dyzetë e dy paga ((21 paga * 1,400 = 29,400

Euro). Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë me shkresë nr. 9952 prot, datë 04.11.2021 dhe çështja nuk është shqyrtuar ende nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Largimet nga detyra janë bërë në kundërshtim me MOP ku punëdhënësi nuk është bazuar në performancën e tyre apo në parashikimet e kontratave të lidhura e cila nuk justifikon veprimet e kryera. Sa më sipër vlera totale prej 92,400 Euro të fituara nga punonjësit e larguar nga puna, deri në këtë shkallë të gjykimit, konsiderohet *shpenzim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet në buxhetin e shtetit* e cila është në kundërshtim me Manualin e Operimit të Projektit (MOP), pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 16-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Nga Autoriteti Rrugor Shqiptar të merren masa për vlerësimin e performancës së stafit të projekteve, duke shmangur shpenzimet e proceset gjyqësore që mund të rezultojnë në rastet e largimit të tyre nga puna e për rrjedhojë shmangien e përdorimit të fondeve pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet.

Në vijimësi

3. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi rezulton se arritja e realizimit të ILD – ve paraqitet në masën 81%, konkretisht: ILD 1.1, 1.2 dhe 2.1 janë realizuar në 100% të parashikimit, ndërsa ILD 1.3 është realizuar 22%, ILD 2.2, dhe 2.3 është realizuar në 0%.

Duke ju referuar qëllimit primar të Projektit rezulton se ILD 1.3 dhe 2.3 rezultojnë se nuk kanë përshkruar objektivat kryesore të projektit, dhe mund të konsiderohen si shpërqendrim i menaxhmentit nga objektivat thelbësore të këtij projekti. Vlerat e disbursuar lidhur me këto ILD, mund të ishin shpenzuar në indikatorë tjerë të rëndësishëm të lartë për mirëmbajtjen dhe sigurinë rrugore.

Komponentët 1.1 dhe 1.2, të cilët lidhen me mirëmbajtjen dhe kishin objektiv gjendjen e rrugëve. Në përgjithësi këta indikatorë masin punën e bërë, por jo direkt gjendjen e rrugëve. Kjo mund të ishte realizuar duke kryer matjen e ashpërsisë të rrjetit të rrugëve, duke e shprehur në termat e Indeksit Ndërkombëtar të Ashpërsisë (INA). Asnjë nga këto ILD, nuk shpreh se në cilën masë janë përmirësuar kushtet rrugore, gjatë periudhës të projektit.

Komponentin ILD 2.1, vlerësimi me yje iRAP, sistemi rezultoi të ishte i dobishëm për përmirësimin e përgjithshëm të infrastrukturës për të gjitha kategoritë e përdoruesve rrugorë, por dhe ky indikator nuk paraqet panoramën e plotë.

Lidhur me komponentin ILD -2.2 vendosja dhe operacionalizimi i RAMS/BMS, Projekti nuk arriti të krijonte sistemin e bazuar në evidenca, të dizenuar për të patur informacion lidhur me planifikim vjetor të mirëmbajtjes. Planifikimi u realizua duke u bazuar në vendimet vjetore, të marra duke analizuar evidencat. Dhe nëse ka patur përmirësim në menaxhimin e aseteve gjatë kësaj periudhe, kjo nuk pasqyrohet nga ILD 2.2, që dështoi të materializohej në digjitalizimin e RAMS. Ecuria e projektit varet nga qartësimi dhe përcaktimi me detaje të sakta se cilët do të jenë indikatorët, të cilët do të përcaktojnë mbarëvajtjen e projektit.

-Koncepti i kontraktimit për performancën nuk është kuptuar si duhet nga kontraktorët dhe nga ARRSH. Ky koncept është një koncept i panjohur për të dyja palët: Kontraktorët presin tu thuhet çfarë të bëjnë, kur dhe si ta bëjnë punën e tyre, ndërsa Klienti (pra ARRSH) pret të jetë në gjendje të instruktojë Kontraktorin çfarë të bëjë, si dhe kur. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 71, datë 02.07.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” dhe përcaktimet e Manualit të Operacioneve të Projektit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 26-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Nga Autoriteti Rrugor Shqiptar të merren masa që në Projektet e ardhshme të mirë kuptohen nga të gjitha palët pjesëmarrëse dhe të përmbushen në kohë objektivat, duke patur në fokus rezultatin në terren njëkohësisht me atë financiar.

Në vijimësi

4. Gjetje nga Auditimi: Komponenti 1.3 “Zhvillimi dhe operacionalizimi i Sistemit Social të Transparencës/ Reagimi publik – Sistemi i zgjidhjes” është realizuar 22%, ndërsa komponentët 2.2 “Vendosja dhe operacionalizimi i RAMS/BMS”, dhe 2.3 “Niveli i marrëveshjes të shërbimit midis ARRSH dhe MTI” është realizuar në 0%.

Nga auditimi rezulton se këta komponentë nuk kanë sjellë përfitime lidhur me qëllimin kryesor të projektit, dhe mund të konsiderohen si shpërqëndrim i menaxhimit nga objektivat thelbësore të këtij projekti. Vlerat e disbursuara lidhur me këto ILD, mund të ishin shpenzuar në indikatorë tjerë të rëndësishëm të lartë për mirëmbajtjen dhe sigurinë rrugore.

Në marrëveshje përcaktohet se pas konsultimeve me Huamarrësin dhe duke njoftuar Bankën, mund të përshtaten shumat dhe objektivat e parashikuara për ILD specifike. Ecuria e projektit varet nga qartësimi dhe përcaktimi me detaje të sakta se cilët do të jenë indikatorët, të cilët do të përcaktojnë mbarëvajtjen e projektit. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 71, datë 02.07.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate”, seksioni IV, pika B5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 26-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi: ARRSH në bashkëpunim me të gjitha institucionet e përfshira në hartimin dhe miratimin e marrëveshjeve të financimit të marrë masa që për projektet që hartohen në të ardhmen të përcaktohen objektiva të qarta dhe të matshme, me synim monitorimin e saktë të përfitimeve që arrihen nga zbatimi i tyre.

Në vijimësi

5. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i situacioneve ka rezultuar se ka raste të vonesave në përgatitjen e dokumentit të autorizimit të faturës dhe kërkesës së pagesës, dokument i cili konfirmohet nga menaxheri i projektit krahasuar me datën e faturës apo dhe datën e konfirmimit të situacionit nga menaxheri. Për Lotin 1, Kontrata A me operator JV “B..... A.T.E.V.E & G.....” shpk situacionet me vonesa janë: 1 – 17, 21 – 24, 26 - 33, dhe 35. Për Lotin 2, Kontrata B me operator JV “B..... A.T.E.V.E & G.....” shpk situacionet me vonesa janë: 1 – 17, dhe 23 – 32.

Për shkak të vonesave lidhur me pagesat e këtyre situacioneve, midis ARRSH dhe operatorëve “B..... A.T.E.V.E” DHE “G..... LTD” kanë lindur mosmarrëveshje, për të cilat palët kanë dakordësuar t’i drejtohen International Centre for ADR, ku me shkresën e ARRSH nr. 7483 prot, datë 01.08.2019, kërkohet caktimi i një eksperti për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Me shkresën nr.10732 prot, datë 22.11.2019 ARRSH i drejtohet z. C..... A..... M..... ku konfirmohet përzgjedhja e tij si ekspert i zgjidhjes të mosmarrëveshjeve dhe kërkohet prej tij kosto e shërbimit dhe drafti i marrëveshjes mes palëve.

Kontraktimi i këtij eksperti është konfirmuar pa komente nga Banka Botërore me shkresën nr. 1706 prot, datë 25.02.2020.

-Me shkresat nr. 7620 prot, datë 12.10.2020 (Kontrata A), nr. 7621 prot, datë 12.10.2020 (Kontrata B), nr. 7622 prot, datë 12.10.2020 (Kontrata D), dhe nr. 76203prot, datë 12.10.2020 (Kontrata C), janë lidhur kontratat me ekspertin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve z. C..... A..... M.....

Pavarësisht bisedimeve mes palëve dhe ekspertit, me shkresën hyrëse në ARRSH nr. 5628 prot, datë 07.06.2021, nga “B..... A.T.E.V.E” DHE “G..... LTD” është shprehur mos dakordësimi lidhur me kontratën A dhe B.

-Me shkresën nr. 1350/1 prot, datë 24.02.2022 nga Menaxheri i Projektit, drejtuar Drejtorisë Juridike dhe të Përputhshmërisë të Standardeve, vendosen në dijeni lidhur me vlerat e kërkuara nga operatorët, konkretisht:

-pagesa shtesë për Urdhër Ndryshimin A06 të kontratës A, dhe Urdhër Ndryshimin B05 të kontratës b, në vlerat 206,000 Euro dhe 15,248 Euro.

-interesa lidhur me vonesat për kontratat A dhe B respektivisht në vlerat 82,181.85 Euro dhe 145,946.24 Euro,

-pagesa e kontraktorit për punimet e anuluar për kontratat A dhe B, në vlerat 56,366.01 Euro dhe 142,239.84 Euro.

Sa më sipër, vlera 647,952 Euro, përbën një dëm ekonomik i mundshëm në disfavor të ARRSH. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 71/2015, (miratuar më 2.07.2015 dhe dekretuar me dekretin nr.9174, datë 14.07.2015, për projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” dhe kontratat A dhe B, klauzola 50 “Pagesat” pika 50.1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 46-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Nga ana e Autoritetit Rrugor Shqiptar të merren masa që në Projektet e ardhshme të ndiqen me përgjegjësi të procedurat e pagesave të situacioneve, të zbatohen afatet e përcaktuara lidhur me pagesat, duke shmangur procedurat gjyqësore të cilat do të sillnin për pasojë humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Me Amendamentin Nr.1 është dakortësuar që: i. Shtrirja dhe shkalla e Punëve të Rehabilitimit të përcaktuara për disa seksione rrugore në kontratë janë të pamjaftueshme për të arritur Nivelet e Shërbimit me të cilat kërkohet që Kontraktori të respektojë në ato seksione rrugore. ii. Teksti i Specifikimeve ka mungesë të qartësisë, përfshin kontradikta dhe përsëritje, si dhe dispozita joreale, duke rezultuar në vështirësi në zbatimin e kontratës. iii. Sqarimet e dhëna ofertuesve gjatë procesit të tenderimit përfshijnë deklarata të cilat janë në kundërshtim me njëra-tjetrën dhe me pjesë të tjera të kontratës.

Referuar pikave ii) dhe iii), të dakortësuara në këtë amendament, konstatohet se: specifikimet teknike të hartuara dhe sqarimet e dhëna gjatë procesit të tenderimit nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe ekspertëve të BB nuk kanë qenë në përputhje me objektivat e kontratave si dhe mungesë qartësie të tyre. Për problematikat e hasura në specifikimet teknike, në pikën B të këtij amendamenti, është dakortësuar rishikimi i tyre të cilat do të zëvendësojnë ato origjinale të kontratës. Mospërshtatja e kushteve të kontratës dhe specifikimeve teknike është edhe si rezultat i mungesës së experiencës pasi kjo lloj kontrate implementohet për herë të parë dhe nga koha e hartimit të tyre ka kaluar një kohë relativisht e gjatë. Këto ndryshime kanë rezultuar në implementimin e kontratave sipas një metode hibride dhe jo sipas asaj të projektuar në DST. Gjithashtu janë përfshirë rrugë që kanë pasur nevojë për një rehabilitim total dhe referuar gjendjes së tyre gjatë procesit të mirëmbajtjes nuk mund të arrihej niveli i kërkuar i shërbimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me dokumentat standarte të tenderit, ToR dhe Specifikimet teknike. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që termat e referencës dhe specifikimet teknike për projektet me financim të huaj të jenë në përputhje me kushtet aktuale të gjendjes së rrugëve me qëllim ofrimin e shërbimit me cilësi dhe siguri.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në kontratat “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” për të patur rezultate sa më të mira në menaxhimin e tyre, në seksionin e specifikimeve pjesa 2 të cilat

janë pjesë e DST, është seksioni 6.1 Masat e performancës menaxheriale (*Management Performance Measures*) MPM e cila pasqyron aftësinë e kontraktorit për të menaxhuar me sukses rezultatet e kontratës duke përfshirë cilësinë dhe efikasitetin e raportimit të tij të informacionit tek punëdhënësi. Për çdo raportim dhe pasqyrim të dhënash tek punëdhënësi nga kontraktori që nuk përputhen me afatet e kërkuara në kontratë janë vendosur penalitete për çdo ditë vonesë përtej këtyre afateve. Masa e Penaliteteve për MPM janë të pasqyruara në DST, për çdo çështje, (Aneksi VII Reduktim i Pagesave për MPM, OPM, RDPM) të specifikimeve pjesa 2 të hartuara nga konsulenti i BB dhe AK kanë qenë kriter mbi bazën e të cilit të gjithë operatorët ekonomik kanë dhënë ofertën e tyre ekonomike. Nga auditimi i dokumentacionit, të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, nuk gjenden gjurmë ku të sqarohet se mbi çfarë reference ose studimi janë bazuar vlerat e penaliteteve nga ana e ekspertit të marrë nga AK dhe BB për hartimin e tyre. Ndryshimi i specifikimeve teknike ka sjell si rezultat edhe rishikimin e penaliteteve, ku janë shtuar dhe hequr disa, duke i përshtatur me kushtet aktuale të kontratës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me dokumentat standarte të tenderit, ToR dhe Specifikimet teknike . *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandimi: ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që për projektet me financim të huaj vlerat e penaliteteve të cilat do të aplikohen gjatë zbatimit të kontratave të jenë të argumentuara dhe në përputhje me kushtet aktuale të zbatimit të tyre.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Në amendimin nr.3 është ndryshuar Klauzola 51 e Kushteve të Veçanta të Kontratës e cila lidhet me penalitetet e dëmeve ku është 10% dhe në raste të veçanta mund të bëhet 20% e vlerës së punimeve rehabilituese, përmirësuese dhe emergjente në rastet ku testet e kryera nuk plotësojnë kërkesat e kërkuara. Për plotësimin e ndryshimeve të kësaj klauzole është ndryshuar pika C 2.1, ku kontraktori duhet të kryej të gjitha testet e materialeve në përputhje me specifikimet teknike, ku rezultatet e tyre do të tregojnë cilësinë e punimeve dhe mbi to do të kryhen pagesat përkatëse ndaj kontraktorit. Gjithashtu në këtë pikë është shtuar se, pavarësisht se rezultatet e testeve nuk janë në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat, Konsulenti Monitorues mund t'i rekomandojë Menaxherit të Projektit pagesën e ndërmjetme si dhe të zgjatet perioda e garancisë së punimeve, si dhe mbajtja 20% e vlerës së tyre e cila kthehet me përfundimin garancisë. Pavarësisht kushteve të vendosura, likuidimi i punimeve të kryera pa u vërtetuar se janë kryer sipas specifikimeve teknike nuk japin garanci për jetëgjatësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre e për rrjedhojë risin koston e mirëmbajtjes së rrugëve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me dokumentat standarte të tenderit, ToR dhe Specifikimet teknike; KTZ, VKM Nr. 68 datë 15.02.2001 "*Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar; ligjin 8402 datë 10.09.1998, i ndryshuar, "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandimi: ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që për projektet me financim të huaj punimet e kryera të likuidohen pasi të jenë realizuar në përputhje me specifikimet teknike duke siguruar jetëgjatësinë e investimit dhe ulen e koston së mirëmbajtjes.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në amendimin nr.3 është ndryshuar klauzola 12.1 ku shtohet se nënkontraktimi mund ta kalojë vlerën 40% të kontratës vetëm në rastet kur është pjesë e JV ku bashkimi i operatorëve ekonomik ka hyrë në tender me përqindje të caktuara sipas përvojës që kanë në menaxhimin dhe zbatimin e kontratave të bazuar në rezultate me performancë. Ky

ndryshim bën të mundur që të kryhen punime nga ana e kontraktorëve që nuk kanë përvojën e nevojshme për kryerjen e tyre dhe këto punime nuk do të jenë në standardin e kërkuar. Gjithashtu AK do ti lëshojë nën-kontraktorit një certifikatë që konfirmon llojin dhe vlerën e punimeve të kryera prej tij ku në momentin e ndryshimit ka kaluar më shumë se 50% e afatit kohor të zgjatjes së kontratës. Me këtë ndryshim duke lëshuar certifikatë konfirmimi për nën-kontraktorët u jep atyre mundësinë të marrin pjesë, në procedura prokurimi, në kontrata të këtij lloji pa patur përvojën e menaxhimit të tyre pasi ata kryejnë vetëm punime faktike në terren të matura dhe punime të mirëmbajtjes rutinë dhe jo “Self control unit” pasi nuk është e lejuar të nënkontraktohet. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kontratat e punimeve civile, klauzola 12.1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1 Rekomandimi: ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që për projektet me financim të huaj lëshimi i certifikatave për nën-kontraktorët të kryhet sipas punimeve të kryera nga ana e tyre duke shmangur pjesëmarrjen e tyre në financime të tjera pa pasur përvojën e kërkuar.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Në kontratat “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” mirëmbajtja rutinë përcaktohet nga niveli i shërbimit të kërkuar sipas kategorisë dhe kushteve teknike të rrugës. Në amendimin nr.3 janë modifikuar kërkesa e nivelit të shërbimit për seksionet rrugore ku shtresat asfaltike ekzistuese nuk mund të mirëmbahen për shkak se punimet rehabilituese të përfshira në kontratë janë pezulluar ose anuluar nga Punëdhënësi. Ky ndryshim ka ulur nivelin e shërbimit por nuk është i shoqëruar me ulje të kostos së mirëmbajtjes rutinë pasi kontraktori kryen më pak punime nga ato të ofruara. Në DST nuk është kërkuar një analizë kostoje të çmimit/njësi, për zërat e punimeve të mirëmbajtjes rutinë, e cila do të bënte të mundur llogaritjen e uljes së kostos sipas nivelit të shërbimit të ofruar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kontratat e punimeve civile, dokumentet standarde të tenderit, ToR dhe Specifikimet teknike. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandimi: ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që për kontrata të ngjashme niveli i shërbimit të kërkohet sipas kushteve të rrugëve dhe me një kosto të detajuar për punimet që kryhen ku do të bëjë të mundur uljen e kostos së projekteve në tërësi në rastet ku do të kërkohet një nivel shërbimi i reduktuar.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Në kontratat “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” në Amendamentin nr.3 datë 16.10.2019 në pikën F janë ndryshuar specifikimet B.3.6.4 për dëmtimin e aseteve rrugore, ku sipas kontratës fillestare thuhet se humbjet apo dëmtimet të punimeve ose aseteve risku është i kontraktorit në masën 100%. Sipas specifikimeve të rishikuara në amendamentin nr.1, kontraktori mbulon në riskun e tij deri 3,500 Euro për çdo ngjarje dhe maksimumi në total 35,000 Euro në vit. Pra dëmtimi i aseteve nga palët e treta që kalojnë vlerën mbi 3,500 Euro për rast ose mbi 35,000 Euro në vit do të paguhet nga punëdhënësi. Gjithashtu në pikën e mësipërme të këtij amendamenti në specifikimet teknike B.3.4.6 është shtuar që risku të mbahet nga punëdhënësi edhe para datës 16.03.2018 kur është miratuar ndryshimi i specifikimeve teknike duke patur fuqi prapavepruese. Para ndryshimeve të kryer në specifikimet teknike nuk ka pasur nga kontraktori për dëmtime të aseteve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kontratat e punimeve civile, dokumentet standarde të tenderit, ToR dhe Specifikimet teknike. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1 Rekomandimi: ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që për kontrata të ngjashme të mos miratohen ndryshime me veprime prapavepruese të cilat risin koston e projektit mbi punëdhënësin.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Në kontratat “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” është parashikuar që para fillimit dhe në të punimeve rehabilituese dhe përmirësuese duhet të kryheshin testet IRI (Indeksi i Ashpërsisë së Rrugës) dhe FWD (kriteri i fortësisë së rrugës). Në amendamentin nr. 3 datë 16.10.2019 në pikën G seksioni i specifikimeve teknike B.4.6.7 (Vrojtimet dhe Projektimet sipas Shtresave Rrugore) është hequr totalisht, pra testet e IRD dhe FWD të mos kryhen pas përfundimit të punimeve dhe do të paraqiten në Raportin e Inventarit të Aseteve çdo 6 muaj. Kryerja e testeve para fillimit të punimeve është e rëndësishme pasi ato përcaktojnë nevojat e rehabilitimit të shtresave si dhe më jetëgjatësia e tyre nga punimet e kryera. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kontratat e punimeve civile, dokumentet standarde të tenderit, ToR dhe Specifikimet teknike. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1 Rekomandimi: ARRSH, në të ardhmen, të marrë masa që për kontrata të ngjashme për një përcaktim sa më të saktë të nevojave rehabilituese të shtresave rrugore të kryhen testet e kërkuara duke kryer shpenzime efikase dhe ruajtjen e kushteve të rrugëve për ofrimin e shërbimit të kërkuar nga përdoruesit e saj.

Në vijimësi

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga Auditimi: Në kontratën me objekt shërbimi “Monitorim/ Supervizionim i katër Kontratave, Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate” sipas amendimit nr. 7 me Nr.4765Prot. datë 16.05.2019 janë shtuar kontribute për një shofer 31 muaj dhe një përkthyes për 12 muaj. Në ofertën fillestare nuk janë parashikuar shoferë, për makinat e vendosura në dispozicion nga kontraktori, pasi janë marrë parasysh si shpenzime të rimbursueshme me kosto zero, dhe janë të shpërndara në pagesat e stafit. Për përkthimin e dokumenteve sipas kontratës fillestare mbulohen nga sekretare/përkthyes e përcaktuar në përshkrimin e punës si dhe referuar materialeve të përkthyesa të vendosura në dispozicion rezultojnë se janë vetëm disa raporte për të cilat nuk kanë patur nevojë për kohë 12 muaj. Për sa më sipër vlera prej 35,600 Euro pa TVSH (24,800 Euro shoferi + 10,800 Euro përkthyes) është përfituar më tepër nga konsulenti dhe përben dëm ekonomik në buxhetin e projektit. Veprime në kundërshtim me kontratën e shërbimit të konsulencës nr. 9999 prot. datë 05.12.2016, Aneksi III, shtojca IV dhe D. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: ARRSH të marrë masa, për arkëtimin e shumës 35,600 Euro pa TVSH, e cila përben dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga BOE “I..... E.... S.r.l & S..... S.p.a & S.....S.p.a” me të cilin është lidhur kontrata Nr. 9999Prot. datë 05.12.2016, për monitorimin dhe konsulencën e katër kontratave të mirëmbajtjes..

Menjëherë

2. Gjetje nga Auditimi: Në kontratën me objekt shërbimi “Monitorim/ Supervizionim i katër Kontratave, Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate” krahas kontributeve për stafin kryesor dhe jo kryesor është parashikuar dhe një shumë e rimbursueshme prej 100,000 Euro e cila do të përdoret për, raportin iRAP në vlerën 39,960 Euro, dy reflektometra në vlerën 30,000 Euro dhe për teste të pa varura që do të duhen konsulentit në vlerën 30,000 Euro. Sipas faturave të vendosura në dispozicion rezultojnë se 18,678.75 Euro janë shpenzuar për reflektometrat dhe 60,000 Euro për testet iRAP, në total 78,678.75 Euro. Në kontratën fillestare dhe sipas marrëveshjes financiare aktiviteti iRAP do të kryhej tre herë gjatë zbatimit të kontratave, në vitin e parë, të tretë

dhe të pestë përpara 1 Nëntorit të këtyre viteve ku konsulenti ka ofruar shumën 39.960 Euro. Në amendamenti nr.7 datë Nr.4765Prot. datë 16.05.2019 është (pika viii) është dakordësuar që do të kryhen vetëm dy herë, dhe i dyti të kryhet në mesin e viti 2021. Ky ndryshim do të zvogëlojë dhe koston për iRAP të cilën Konsulenti Monitorues duhet ta ndryshojë në përputhje me pikën 30 të kontratës. (viii) *In accordance with the discussions held during the Mid-Term Review of the RRMSP, the number of iRAP surveys to be carried out by the MC through an independent provider is reduced from three to two, with the second survey to be carried out in mid-2021. This shall reduce the overall cost for the iRAP surveys which the MC shall charge in accordance with para. 30 of the Contract.*

Derisa kostoja për tre testet iRAP ishte jo më shumë se 39,960 Euro, për dy duhet të jetë 26,640 Euro. Nga auditimi i dokumentacionit dhe raporteve të vendosura në dispozicion rezultojnë se iRAP është kryer dy herë dhe sipas faturave të paraqitura secili ka një kosto prej 30,000 Euro dhe në total 60,000 Euro, jo vetëm që nuk është zvogëluar por ka kaluar edhe vlerën e parashikuar në kontratë. Për sa më lart vlera e dy testeve iRAP nuk duhet të kalonte vlerën 26,640 Euro e për rrjedhojë konsulenti ka përfituar më tepër vlerën 33,360 Euro pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit. Veprime në kundërshtim me kontratën e shërbimit të konsulencës nr. 9999 prot. datë 05.12.2016, dhe amendimi nr.7 datë 16.05.2019, pika (viii). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: ARRSH të marrë masa, për arkëtimin e shumës 33,360 Euro pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit nga BOE “I..... E..... S.r.l&S.S.p.a & S..... S.p.a” me të cilin është lidhur kontrata Nr. 9999Prot. datë 05.12.02016, për monitorimin dhe konsulencën e katër kontratave të mirëmbajtjes..

Menjëherë

C.MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga Auditimi: Në kontratën me objekt shërbimi “Monitorim/ Supervizionim i katër Kontratave, Mirëmbajtje dhe Siguri Rrugore Bazuar në Rezultate” janë parashikuar, staf jo kryesor, 12 punonjës për kontrollin dhe monitorimin e punimeve rehabilituese dhe përmirësuese në 12 muajt e parë të kontratave të zbatimit. Referuar zbatimit të kontratave të punimeve civile rezultojnë se gjatë 12 muajve të parë deri në nënshkrimin e amendamentit nr.1 datë 16.03.2018, nuk janë realizuar punime rehabilituese dhe përmirësuese. Sipas kontratës çdo 6 muaj nga bërja efektive e kontratës së konsulentit, ARrSh dhe konsulenti duhet të rishikojnë kontributet (input) e stafit për 6 muajt e ardhshëm bazuar në dakortësinë e planifikimit të stafit e cila nuk është realizuar. Nga mosrealizimi i punimeve rehabilituese dhe përmirësuese në 12 muajt e parë të kontratave, kontributet e stafit lokal të parashikuara për kontrollin dhe monitorimin e këtyre punimeve janë përfituar nga konsulenti pa ofruar ndonjë shërbim sipas përshkrimit të punës (scope of work) të parashikuar në kontratë nga ky staf në vlerën prej 432,000 Euro pa TVSH. Gjithashtu nga mosrealizimi i punimeve rehabilituese dhe përmirësuese në vitin e parë janë shtuar dhe kontributet e Deputy Team Leader me 12 muaj në vlerën 162,000 Euro pa TVSH. Për sa më sipër vlera prej 594,000 Euro pa TVSH (432,000 stafi lokal + 162,000 Deputy Team Leader) konsiderohet shpenzim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet i fondeve të projektit. Veprime në kundërshtim me kontratën e shërbimit të konsulencës nr. 9999 prot. datë 05.12.2016, informacion përmbledhës

për stafin, pika b. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: ARRSH të marri masa, për projektet në proces dhe të reja, të monitoroj kontratat e konsulencës dhe shtimi i kontributeve të stafit të jetë sipas situatës në terren duke shmangur kështu rritjen e kostove të kontratave.

Në vijimësi

2. Gjetja nga auditimi: Termat e marrëveshjes në këtë Projekt përcaktojnë se komisioni i angazhimit i pagueshëm nga Huamarrësi për çdo vlerë e cila rezulton e pa tërhequr është i barabartë me një të katërtën e një për qind (0.25%) në vit të shumës së Huas gjendje. Nëse objektivat e Projektit do të ishin realizuar sipas afateve të përcaktuara në marrëveshje komisioni i angazhimit do të paguhej në vlerën 263,518 Euro. Nga auditimi rezulton se vlera e paguar për këtë komision deri në datën 31 dhjetor 2022 është 453,393.82 Euro.

Diferenca midis vlerës të parashikuar dhe asaj të paguar rezulton në vlerën 189,875.77 Euro dhe konsiderohet shpenzim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet për buxhetin e shtetit. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 71, datë 02.07.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” neni 2.5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 26-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Nga Autoriteti Rrugor Shqiptar të merren masa që në Projektet e ardhshme të përmbushen në kohë të gjitha përcaktimet e marrëveshjeve financiare, në mënyrë që të shmangen të gjitha efektet e mundshme financiare që rrjedhin nga këto vonesa në afate.

D. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit që janë identifikuar si përgjegjës në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit, masa administrative e propozuar nga ana jonë do të ishte **“Vërejtje”** deri në **“Largim nga detyra”** por meqenëse Projekti ka përfunduar dhe personat janë larguar nga pozicionet përkatëse masat do të konsiderohen të ezauruara.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT